Rruga e Arbërit

SKËNDERBEUT - 2018 - VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 10 (150) / 2018. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Reportazh

Maqellarë, situatë alarmante nga mbetjet

Nga **SAMI CURRI**



6

Studim

Àrbëri sipas statuteve që u konfirmuan në epokën e Gjergj Kastriotit

Nga prof.dr. **SHABAN SINANI**



10

Kritikë

Psikologji dhe traditë në vëllimin poetik "Udhë në pasqyrë"

Nga dr. **FEJZULLA GJABRI**




19

Mollët e Dibrës

Nga prodhimi te tregu: një kalvar pengesash

- **Mbi 8 mijë ton mollë janë në pritje të tregut. Shumica e tyre rrezikojnë të prishen. Fermerët nuk kanë mundësi ruajtje, kështu që i janë rikthyer stivosjes në kavaletë.**
- **Në Dibër sot numërohen mbi 500 mijë rrënjë të mbjellë me mollë, që e konvertuar në sipërfaqe do të thotë mbi 460 hektarë. Shumica e tyre janë në prodhim.**
- **Një pikë tjetër e dobët e fermerëve, sidomos e atyre dibranë, është të qenit vetëm. Toka e paktë, mekanika disa herë e munguar, e bën shumë të vështirë daljen në treg. Është domosdoshmëri bashkimi i tyre në grupe prodhuese. Imputet, fidanat, plehrat do të merreshin me çmime shumice, teknologjia e zbatuar do të ishte më cilësore dhe marrëveshjet me tregtarët do të lidheshin më lehtë.**

Nga OSMAN XHILI



Ne, dibranët, shpesh e përmendim mollën, si një nga krenaritë e vendlindjes dhe vërtetë e tillë është. Kjo kulturë drufrutore, me vlera aq të mëdha ushqimore, është bërë pjesë organike e tryezës në konsumin familjar. "Një mollë në ditë e mban doktorin larg" është një shprehje që preferojmë ta themi shpesh. Por, pas këtij fruti të bukur e të shijshëm, fshihet një kalvar i gjatë problemesh, që dhe pse shumë kohë ka kaluar e po kalon, nuk ka gjetur një zgjidhje të përshtatshme dhe të qëndrueshme. Ndaj, po po përpiqemi të japim një panoramë të përgjithshme të këtij problemi, hallkat, vështirësitë dhe mundësitë e zgjidhjes.

NJË PASQYRË E SHKURTËR

Që para viteve nëntëdhjetë Dibra ishte e përmendur për rritjen dhe kultivimin e mollës. Blloqe të tillë, si Kastrioti, Sllova, Qenoku,Gjarajca, Pasmari, Ravnat, njiheshin dhe kishin bërë emër kudo. Frutat e Dibrës shkonin dhe në tregjet europiane, duke konkuruar me cilësinë dhe aromën aq të mirë. Pas atij shkatërrimi total, u duk se problemi u vu në rrugën e zgjidhjes. Për momentin tregu ishte goxha i uritur. Mollat, rrushi e një pjesë perimesh merreshin në Resnje të Maqedonisë, apo diku tjetër. Duke u shtuar numri i bimëve dhe hektarët e mbjellë me këtë kulturë, u arrit një balancë e prodhimit me konsumin e ka pak vite që kjo balancë është prishur. Dibra nuk i konsumon dot mollët që prodhon dhe detyrimisht, një pjesë e prodhimit duhet të kërkojë tregje të reja në Tiranë e akoma më mirë, në tregje të huaja.

(Vijon në faqen 2-3)

NË BRENDËSI:

- Marrëzitë e kohës sonë
- Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve bashkiake nga komuniteti
- Shpifja si fjalë e randë që s'e mban kandari
- Peshkopia ndodhet në të dy anët e lumit Drin?!
- Anton Çeta i Dibrës
- Shkolla shqipe në Radomirë
- Ritëm vallje e refren kënge
- Historia e ngritjes së Muzeut "Vendorigjina e Kastriotëve" në Sinë
- Kontributi i Rakip Sinanit rreth betejave të Skënderbeut
- Kalaja e Dodës- vështrim enciklopedik
- Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave
- Dibrani që nuk ngopet me tituj Kampionësh!
- Dëshmori Hamdi Lleshi, tankisti i parë shqiptar, që ra për çlirimin e Dibrës së Madhe
- Në Peshkopi u hap Shtëpia e Kulturës...
- Statuja e bardhë
- Kur vjen një përvjetor…

Bashkëpunimi mes fermerësh, e vetmja zgjidhje për një treg të sigurt

Qindra ton mollë aktualisht janë të destinuara të shiten nën mesataren e çmimit dhe në rastin më të keq të mundshëm të kalben duke detyruar fermerët të braktisin këtë sektor kaq të rëndësishëm për ekonominë e një vendi kaq të varfër siç është edhe zona e Dibrës.

Nga SAMET ZAGRADI - Faqe 4

BËJ NJË ABONIM ONLINE OSE NË PRINT.
Kushton vetëm 600 lekë në vit.
email: rrugaearberit@gmail.com

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Rruga e Arbërit nr. 150

speciale

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 10 (150). Tetor 2018
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit nëntor 2018.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA / BIRN
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI
Grehans UKA
Arsim KOLARI

Kontribuan për këtë numër:
Shaban Sinani
Xhafer MARTINI
Sami Curri
Viron Kona
Selman Mëziu
Halil RAMA
Hajri SHEHU
Fejzulla Gjabri
Mimoza TOLA
Sakip CAMI
Metush SKEJA
Ilmi DERVISHI
Besnik KËBEJ
Mevlud BUCI

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

MOLLËT E DIBRËS

Të prodhosh, është njëra anë e medaljes, tjetra është të shesësh produktin tënd. Nëse nuk realizohet e dyta, e para shumëzohet me zero. Janë disa hallka për të shkuar deri te shitja dhe këputja qoftë dhe e njërës prej tyre e bën të pavlerë gjithë zinxhirin.

Nga OSMAN XHILI



Mollë të vendosura në kavalet në një fermë në Dibër. *Foto: FB/KetuMblidhenDibranet*

Ne, dibranët, shpesh e përmendim mollën, si një nga krenaritë e vendlindjes dhe vërtetë e tillë është. Kjo kulturë drufrutore, me vlera aq të mëdha ushqimore, është bërë pjesë organike e tryezës në konsumin familjar. “Një mollë në ditë e mban doktorin larg” është një shprehje që preferojmë ta themi shpesh. Por, pas këtij fruti të bukur e të shijshëm, fshihet një kalvar i gjatë problemesh, që dhe pse shumë kohë ka kaluar e po kalon, nuk ka gjetur një zgjidhje të përshtatshme dhe të qëndrueshme. Ndaj, po po përpiqemi të japim një panoramë të përgjithshme të këtij problemi, hallkat, vështirësitë dhe mundësitë e zgjidhjes.

NJË PASQYRË E SHKURTËR

Që para viteve nëntëdhjetë Dibra ishte e përmendur për rritjen dhe kultivimin e mollës. Blloqe të tillë, si Kastrioti, Sllova, Qenoku,Gjarajca, Pasmari, Ravnat, njiheshin dhe kishin bërë emër kudo. Frutat e Dibrës shkonin dhe në tregjet europiane, duke konkuruar me cilësinë dhe aromën aq të mirë. Pas atij shkatërrimi total, u duk se problemi u vu në rrugën e zgjidhjes. Për momentin tregu ishte goxha i uritur. Mollat, rrushi e një pjesë perimesh merreshin në Resnje të Maqedonisë, apo diku tjetër. Duke u shtuar numri i bimëve dhe hektarët e mbjellë me këtë kulturë, u arrit një balancë e prodhimit me konsumin e ka pak vite që kjo balancë është prishur. Dibra nuk i konsumon dot mollët që prodhon dhe detyrimisht, një pjesë e prodhimit duhet të kërkojë tregje të reja në Tiranë e akoma më mirë, në tregje të huaja. Falë një pune të palodhur të fermerëve dibranë dhe disa politikave ndihmuese e subvencionuese të qeverive ndër vite, Dibra e ka zgjeruar ndjeshëm hartën e sipërfaqes së mbjellë me këtë kulturë.

Po tu referohemi shifrave në drejtorinë e bujqësisë së rrethit, rezulton se sot kemi rreth 500 mijë rrënjë të mbjellë me këtë kulturë, që e konvertuar në sipërfaqe do të thotë 460 hektarë të mbjellë. Shumica e tyre janë në prodhim, përveç 30 hektarë që janë mbjellje të reja. Prodhimi i përgjithshëm është rreth tetë mijë ton. Nëse i referohemi strukturës varietore, ajo do të na rezultonte e tillë: Dyzetë përqind e sipërfaqes është mbjellë me mollën Starking, tridhjetë përqind i takon varitetit Golden dhe 15 përqind është mbjellë me Grin Smith. Pjesa tjetër janë lloje të ndryshme, që testojnë veten në tregun e prodhimit dhe të konsumit. Vitet e fundit po vihet re një tendencë për të futur varitete të rinj për vendin tonë si Fuxhi, Gala, Pink ledi, që po rezultojnë konkurruese, krahasuar me të tjerët, si ndaj sëmundjeve, ashtu dhe në kërkesat e konsumatorit.

Ne folëm pak më sipër për vitet para nëntëdhjetës,por fatkeqësisht shifrat e atëhershme në disa drejtime janë më pozitive. Vetëm dy blloqe masive, si Pasmari dhe Gjarajca e Brezhdanit i kalonin 350 hektarë, pra diku afër me shifrën totale të sipërfaqes së sotme. Cilësia e asaj kohe ishte super duke pasur një eksport të sigurtë në Gjermani, Çekosllavaki, apo diku tjetër. Po të llogarisësh faktin që këto dy masive të dikurshme, që sot janë të shkreta dhe për pasojë erozioni bën kërdinë, humbja bëhet dyfish më e madhe. Por nuk do qajmë shumë mbi qumështin e derdhur, por të shohim problemet dhe rrisqet e reja që i dalin sot përpara frutikulturës, mollës dhe fermerëve dibranë, në kushtet e ekonomisë së tregut.

Një pikë tjetër e dobët e fermerëve, sidomos e atyre dibranë, është të qenit vetëm. Toka e paktë, mekanika disa herë e munguar, e bën shumë të vështirë daljen në treg. Është domosdoshmëri bashkimi i tyre në grupe prodhuese. Imputet, fidanat, plehrat, do të merreshin me çmime shumice, teknologjia e zbatuar do të ishte më cilësore dhe marrëveshjet me tregtarët do të lidheshin më lehtë.

HISTORI FERMERËSH

PREMTIM AGOLLI, djali i një familje të madhe dhe me emër, nga Kërçishti i Maqëllarës, qe vendosur në Vlorë me familjen e tij. Një zë i brendshëm i thërriste për në vendlind-



Nga prodhimi te tregu: një kalvar pengesash

Mbi 8 mijë ton mollë janë në pritje të tregut. Shumica e tyre rrezikojnë të prishen. Fermerët nuk kanë mundësi ruajtje, kështu që i janë rikthyer stivosjes në kavaletë.

Në Dibër sot numërohen mbi 500 mijë rrënjë të mbjellë me mollë, që e konvertuar në sipërfaqe do të thotë mbi 460 hektarë. Shumica e tyre janë në prodhim

40% e sipërfaqes është mbjellë me mollën Starking, 30% me Golden dhe 15% është mbjellë me Grin Smith. Pjesa tjetër janë lloje të ndryshme, që testojnë veten në tregun e prodhimit dhe të konsumit.



je, ku kishte tokën dhe pasurinë, që i qenë mohuar dhe shfrytëzuar për dekada të tëra nga sistemi i mëparshëm. Po frynte një fllad i lehtë dhe frymëzues, si për shumë gjëra dhe për bujqësinë. Premtimi, bashkë me babain e tij, Agimin, filluan të mbjellin fidanët e parë të pemëve frutore. Falë dhe ndihmës nga disa skema subvencioni në bujqësi, arritën të mbjellin jo pak, por dhjetë hektarë pemtore, ku katër prej tyre ishin me mollë. Pas shumë vitesh hyrje në prodhim, apo dëmtimi nga kroma, para dy vitesh arriti të marrë një prodhim prej njëmijë kunjtalë mollë, të një cilësie mjaft të mirë. Një tregtar nga Fushë Kruja, e mori prodhimin direkt nga parcela. Kjo pati një ndikim shumë pozitiv në xhepin dhe shpirtin e fermerit, që aq shumë kishte investuar në pemtoren e tij.

Viti i kaluar dukej sërish shumë i mbarë dhe Premtimi shpresonte një sukses të ri. Por nuk thonë kot, se bujqësia është industri pa çati dhe ngricat e 21 dhe 22 prillit të vitit ta kaluar e zhbënë gjithë atë panoramë të bukur të prodhimit, sikur të mos kishte qenë fare. U dëmtua pemtaria në Dibër, Korçë, Kukës e pak më gjerë. Patëm shkruar atëherë se vetëm Dibra mund të kishte pësuar një dëm prej dhjetë milion eurosh. U hodhën sytë nga qeveria, por që aty asgjë nuk erdhi, megjithë ca gjysma premtimesh të dhëna. Të paktën një kompesim për shërbimet e kryera, do të kishte qenë një ndihmesë e madhe për fermerët halleshumë. Premtim Agolli, si dhe shumë të tjerë,ndodhej në kufinjtë e mbijetesës. Ky vit dukej mjaft i mbarë, në gjitha kulturat drufrutore. Të paktën kjo do ta harronte katastrofën e vitit të kaluar, duke hapur një faqe të re. Por nuk qenka e thënë, që gjërat të shkojnë ashtu siç i mendon njeriu. Një tjetër armik, breshëri, godet tre herë, si rrallë vit tjetër, prodhimin e mbarë. Më pas pati dhe një stuhi në fillim të shtatorit, pak para vjeljes, që hodhi në tokë 300 kuintalë, apo gati një të tretën e prodhimit. Megjithë këto dëme, kishte vend për besim, për shpresë, ishin dhe 600 kuintalë të tjerë, që gjithsesi do ta shpërblenin disi mundin e fermerit. Por më pas erdhi një tjetër pengesë, gjetja e tregut. Sa kollaj ta shkruash me dy tre rreshta, me mendjen e qetë dhe xhepin të padëmtuar dhe sa vështirë ta përjetosh këtë moment në rolin e prodhuesit, gati si një tragjedi. Ta shohësh para teje prodhimin që po kalon fazën e pjekjes dhe ti je në dilemë se çdo të bësh me të. Ta lesh aty në pemë dhe të mos merresh më kurrë me të, apo ta vjelësh, duke shtuar dhe goxha para të tjera në listën e gjatë të shpenzimeve të deritanishme. Ditë e netë pa gjumë në kërkim të një zgjidhje, që të ishte më e mira e mundshme. Ai nuk kishte një frigorifer të tijin dhe pse e pat dëshiruar aq shumë. Kërkoi të gjejë një të tillë, duke i paguar qiranë. Më së fundi bëri një marrëveshje, për të marrë dy dhoma me kapacitet 30 ton secila, dhe një qira totale 900 mijë lekë në muaj. Premtimi nuk shpreson të gjejë treg për ta para pesë muajsh, që do të thotë se pesë milionë lekë do të shkojnë vetëm për qiranë dhe transportin. Ja kështu vazhdon të endet fermeri ynë në pritje, në një pritje me pak shpresë, i lodhur fizikisht dhe shpirtërisht, me shumë pak forca, moral dhe para në xhep, për tëfilluar një vit të ri bujqësor.

QERIM KADRIU është një agronom me eksperiencë në qarkun e Dibrës, me pak vite për të dalë në pension. Ai kishte këshilluar gjithë jetën fermerët, për eksperienca dhe teknologji të reja, por dhe vetë ishte përpjekur të bëjë diçka konkrete. I fortë fizikisht, me njohuri të mira teorike, ai merr me një qira simbolike, nga disa miq të tij, një ngastër prej tre dynymësh, të mbjellë me mollë. Pas dështimit nga bryma dhe ngricat e vitit të kaluar, këtë vit Qerimi i kreu të gjitha shërbimet, që nga plehërimi, krasitja, spërkatjet, rrallimi. Prodhimi qe i kënaqshëm dhe i një cilësie mjaft të mirë. Qerimi shiti vetëm njëzetë kuintalë mollë, kurse pjesën tjetër e ka kavaletuar në parcelë. Të shtrira në kashtë thekri dhe të mbuluara po me kashtë. Pak dhe sipër dhe një plasmas mbi të. Kaq mund të bënte Qerimi për prodhimin e mbetur. Ai nuk kishte as arka, as frigorifer dhe aq më pak treg. U shfaqën kavaletat e dikurshme, që i kishim harruar. Qerimi shpreson të gjejë dikë, qoftë dhe me një çmim të vogël, sa për ti shpëtuar mollët nga kalbëzimi e dëmtimi dhe për ti hedhur xhepit të tij ca para të tjera, në këmbim të asaj lodhje të madhe që provoi këtë vit.

Pati dhe ndonjë fermer fatlum që mbijetoi në tregun e hallakatur të mollës. **FESTIM TEMA** nga Dovalani është njëri prej tyre. Festimi është serioz dhe me disiplinë të lartë pune. Në shtatë dynymë mollë që kultivon, ai prodhoi mbi treqind kuintalë mollë. Falë një cilësie shumë të mirë, ai arriti ta bindë Visin, tregtarin e Fushë Krujës, t'ja marrë prodhimin që në parcelë, me një çmim mjaft të leverdisshëm. Festimi dëshiron të mbjellë dhe tre dynymë me mollë të tipit Fuxhi, por ajo ka një kosto goxha të lartë, pasi i duhen jo pak por 15 milionë lekë, për të realizuar një projekt të tillë.

Janë dhe disa fermerë të tjerë nga Melani, si Zamir Mehmeti, Arsen Tifeku, Zehni Sula e ndonje tjetër, që me pak vështirësi e kanë shitur prodhimin e tyre dhe bëhen gati për sezonin e ri.

TREG I ÇORODITUR

Të prodhosh, është njëra anë e medaljes, tjetra, po kaq e rëndësishme, është të shesësh produktin tënd. Nëse nuk realizohet e dyta, e para shumëzohet me zero. Janë disa hallka për të shkuar deri te shitja dhe këputja qoftë dhe e njërës prej tyre e bën të pavlerë gjithë zinxhirin. Kam asistuar në disa trajnime për të përcaktuar markën e prodhimit në qarkun e Dibrës, qoftë kjo për djathin, jufkat, apo dhe për mollën. Për të arritur në finale, për të lidhur kontratën, patjetër duhet të garantosh dy tregues: sasinë dhe cilësinë. Kjo do të thotë që një prodhues i një produkti të caktuar duhet të prodhojë për aq kohë dhe në atë cilësi, siç është përcaktuar në kushtet e kontratës.

Por, a është në gjendje fermeri ynë, prodhues i mollëve të lidhë një kontratë? Jo e pamundur, por disi e vështirë, për disa arsye. Kur thamë që bujqësia është "industri pa çati", kemi parasysh dhe vite të vështirë, siç qe ai i vitit të kaluar, kur u prish gati i gjithë prodhimi. Me se do ta garantonte fermeri kontratën e lidhur? Në këtë rast, veç humbjes së prodhimit, do të duhej të paguante dhe për moszbatim kontrate. Po këtë vit që breshëri e dëmtoi cilësinë e mollës në disa rajone? Sërish pasojat do të ishin të njëjta. Në kushtet kur mungojnë shoqëritë e sigurimit për vitet që dëmtohet prodhimi, në kushtet kur fermeri nuk ka kapacitete financuese për të vënë rrjeta antibreshër, gjërat do të ngelen në mëshirë të fatit. Njerëzit do të hapin sytë nga qielli, me shpresën se nuk do të ketë faktorë të dëmshëm atmosferikë.

Një pikë tjetër e dobët e fermerëve, sidomos e atyre dibranë, është të qenit vetëm. Toka e paktë, mekanika disa herë e munguar, e bën shumë të vështirë daljen në treg. Është domosdoshmëri bashkimi i tyre në grupe prodhuese. Imputet, fidanat, plehrat, do të merreshin me çmime shumice, teknologjia e zbatuar do të ishte më cilësore dhe marrëveshjet me tregtarët do të lidheshin më lehtë.

Ka disa vite që Visi, tregtari nga Fushë Kruja, ka marrë sasi të konsiderueshme molle te disa fermerë. Por dhe këtu nuk ka kontrata të rregullta paraprake, por biseda me fjalë vetëm një javë para tërheqjes së mallit. Këtë vit, erdhi në Dibër, me ndërhyrjen e kryetarit të bashkisë, një kompani kosovare, "Doni Frut". U bënë disa përçapje që në verë me qershinë, për të vazhduar më pas me mollën. Bile punët shkuan dhe më tej, duke caktuar një person kontakti dhe duke dhënë një vend, që do të shërbente si pikë grumbullimi. Në të dy rastet, qoftë me qershinë, qoftë me mollën, punët dështuan, duke lënë një shije jo të mirë. Në rastin e parë u kthye nga kish ardhur një makinë me qershi nga ferma Doda dhe në rastin e dytë një makinë me mollë, nga ferma Zebi. Gabimet qenë të dy palëve. Së pari, duhej nënshkruar një kontratë, që duhej respektuar nga dy palët dhe së dyti malli duhej të merrej në vend nga një përfaqësues i kompanisë, procedura këto që i përmendëm dhe më sipër.

Po mbyllet dhe ky vit bujqësor. Fermeri dibran, sa vjen e pështjellohet më shumë. Mendimet i vijnë të turbullta. Ta mbajë apo ta heqë qershinë? Ta mbajë apo ta heqë mollën? Të mbjellë arrore apo jo? Kush mund ti japë një mendim, një zgjidhje, një ndihmë, le t'ja japë sa më parë, pasi më tej do të jetë tepër vonë. Njerëzit do të kenë ikur nga sytë këmbët në dhera të huaj, duke lënë pas Dibrën e dashur, megjithë pemtoret e ngritura me aq mund e gjak.

Rruga e Arbërit nr. 150

aktualitet

Qindra ton mollë aktualisht janë të destinuara të shiten nën mesataren e çmimit dhe në rastin më të keq të mundshëm të kalben duke detyruar fermerët të braktisin këtë sektor kaq të rëndësishëm për ekonominë e një vendi kaq të varfër siç është edhe zona e Dibrës.

Salkurti: Bashkëpunimi mes fermerësh, e vetmja zgjidhje për një treg të sigurtë

ILJAZ GJAPI:
"Mundi dhe puna jonë nuk llogaritet fare kur shteti nuk merr masa për këtë situatë duke qenë që ne kemi një mollë me cilësi tepër të lartë. Aktualisht kam rreth 40-50 kuintal mollë të varieteteve të ndryshme me një cilësi shumë të mirë janë të destinuara të kalben pasi me atë çmim nuk nxjerr as lekët e pesticideve dhe ujit që janë vaditur. Unë si person por jam i bindur që të gjithë fermerët po kishim lehtësi në transport do iknim vetë për ti shitur ato drejt Tiranës"



Nga **SAMET ZAGRADI**

Nëse do të përmendim disa gjëra që do të identifikojnë denjësisht Dibrën, padyshim që një nga dhjetëra gjëra do të ishte molla e saj. Klima e kësaj zone ka bërë që të rriten një shumëllojshmëri mollësh me një kualitet dhe më një shije të pakrahasueshme. Njerëzit punëtorë dhe besnik të vendit të tyre çdo ditë e më shumë po investojnë në mënyra nga më të ndryshmet. Dibranët duket se janë rikthyer traditave të kultivimit të pemëve frutorë pasi për një kohë të gjatë nga prishja e sistemit komunist kjo kulturë dukej se po pësonte tkurrje. Fermerët dibranë, punëtor dhe të zellshëm kanë nxituar të sjellin varietete të reja dhe me shumë produktivitet duke pasur më shumë prodhime të "mollës se famshme të Dibrës"

Vjeshta e këtij viti duket se ka ardhur e mbarë dhe ashtu si qershitë edhe mollët kanë një superprodhim duke rritur gjithnjë e më shumë rrezikun për tu ulur çmimi ose në rastin më të keq mos ngelur stok në magazinat e fermerëve dibranë.

Iljaz Gjapi është një fermer i ri që vendosi të investonte në vendin e tij duke lënë Greqinë dhe duke ju dedikuar familjarisht ndërmarrjes së frutikulturës duke mbjellë një sasi të konsiderueshme mollësh, qershish, kumbulle dhe rrushi. Përvoja që ai kishte kaluar në shtetin Grek e bëri atë optimist ti përkushtohej frutikulturës me idenë që të marrë të ardhura nga vendi që prej brezash e kanë të trashëguar, por me sa duket vendi jonë nuk arrin të përmbushë pritshmëritë e tij.

"Këtë vit, tregon ai, në të gjithë zonën e Dibrës vjeshta ka qenë më bujare dhe prodhimet kanë qenë më të bollshme duke na rrezikuar uljen e ndjeshëm të çmimit apo në rastin më të keq kalbjen dhe hedhjen e e të gjithë mallit. Çmimi i mollës në krahasim me vitet e tjera ka rënë ndjeshëm për shkak të prodhimit vendas ndërsa grumbulluesit kryesisht nga Tirana kanë vënë një çmim aspak të leverdishëm për ne si fermer".

Molla dhe qershia kanë nevojë për një përkujdesje intensive me spërkatjet, ujitjen, krasitjen apo me shërbime të tjera të detyrueshme dhe çmimi që ofrohet nga pikat grumbulluese të mollës të cilësisë së parë 30 lekë për Kg është shumë larg kërkesave tona si fermer të Dibrës. Për një vit kam harxhuar rreth 400 mijë lekë për pesticidet kundër kalbjes dhe ajo shumë as nuk pretendo të marr as gjysmën e tyre. Po e njëjta situatë ishte me qershitë ku një pjesë të madhe vendosa ti pres, e nëse e njëjta gjë ndodh edhe me mollët po e njëjta situatë do të ndodhë. Mundi dhe puna jonë nuk llogaritet fare kur shteti nuk merr masa për këtë situatë duke qenë që ne kemi një mollë me cilësi tepër të lartë. Aktualisht kam rreth 40-50 kuintal mollë të varieteteve të ndryshme me një cilësi shumë të mirë janë të destinuara të kalben pasi me atë çmim nuk nxjerr as lekët e pesticideve dhe ujit që janë vaditur. Unë si person por jam i bindur që të gjithë fermerët po kishim lehtësi në transport do iknim vetë për ti shitur ato drejt Tiranës", shton ai, duke u ankuar dhe shfaqur pakënaqësi të dukshme në këtë situatë të cilën pothuajse të gjithë fermerët dibranë ndodhen.

Të njëjtin fat si Iljazi kanë shumica e fermerëve, të cilët po vuajnë çdo ditë kur përpara tyre shfaqet dëmi që dita ditës po shfaqet. Mungesa e infrastrukturës dhe krijimit të tregut për çdo produkt që fermeri dibran me djersë mundohet të prodhojë. Shumë fermer kanë filluar që mollët dhe qershitë ti zëvendësojnë me rrënjë lajthie, arre apo ndonjë produkti tjetër që mund të rezistojë ndaj kalbjes apo të ketë një treg më të sigurt për shitje. Mungesa e subvensioneve nga qeveria shqiptare ka bërë që fermerët herë here të ngrihen të revoltuar në protesta duke hedhur produktet apo duke i falur ato. Ky shqetësim sipas tyre nuk po merr zgjidhje duke detyruar që ti braktisin totalisht frutikulturën.

VEIP SALKURTI:
"Problemi qëndron tek vetja jonë, sepse ne si fermerë duhet me patjetër të bashkëpunojmë që të operojmë mes vetes dhe shohim si destinacion eksportin. Skemat mbështetëse i vendosin më shumë prioritet kooperativave se sa individit dhe nëse fermët janë të bashkuar, mund të kenë sukses në treg. Fermerët duhet të prodhojnë mallin për në bazë të kërkesave që konsumatori i kërkon dhe shteti ka për detyrë të hartojë politika të veçanta nxitëse për grumbullimin dhe eksportimin dhe të shmang mbetjen stok të prodhimeve cilësore.

Veip Salkurti i njohur nga të gjithë si fermer i suksesshëm i prodhimit dhe përpunimit të mollëve në Dibër thotë se ka ardhur koha që të krijohen ferma të mëdha apo kooperativa, siç i quan ai.

"Problemi qëndron tek vetja jonë, thotë Salkurti, sepse ne si fermerë duhet me patjetër të bashkëpunojmë që të operojmë mes vetes dhe shohim si destinacion eksportin. Skemat mbështetëse i vendosin më shumë prioritet kooperativave se sa individit dhe nëse fermët janë të bashkuar, mund të kenë sukses në treg. Fermerët duhet të prodhojnë mallin për në bazë të kërkesave që konsumatori i kërkon dhe shteti ka për detyrë të hartojë politika të veçanta nxitëse për grumbullimin dhe eksportimin dhe të shmang mbetjen stok të prodhimeve cilësore, gjë e cila dëmton rëndë ekonominë e kësaj zone".

Problemi sigurimit të tregut për fermerët dibranë nuk është i ri dhe vazhdimisht ato janë munduar të ngrenë zërin që instancat përkatëse shtetërore të sigurojnë të paktën shitjen për të mos llogaritur subvensionet. Qindra ton mollë aktualisht janë të destinuara të shiten nën mesataren e çmimit dhe në rastin më të keq të mundshëm të kalben duke detyruar fermerët të braktisin këtë sektor kaq të rëndësishëm për ekonominë e një vendi kaq të varfër siç është edhe zona e Dibrës.

Në një intervistë për mediat lokale të qarkut të Dibrës vetë drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Norvrus Jashari, tregon se sipas statistikave Dibra mban vendin e dytë pas qarkut të Korçës për tregun masiv të mollëve për të cilën mungon tregu i shitjes. Ai thotë se edhe vitet e tjera kanë qenë problematikë për sa i përket mollëve, por këtë vit problemi është më i madh për shkak të prodhimit në sasi më të mëdha. Sipas tij dhe institucionit që drejton është informuar Ministria e Bujqësisë për problematikën dhe është premtuar që do të mblidhet një tryezë rajonale për të gjetur një zgjidhje dhe për të bërë të mundur lidhjen e fermerëve dibranë me grumbulluesit e mëdhenj në mënyrë që me çmimin mesatar prej 50 lekësh të reja të shitet sasia e mollëve. Sigurisht që nuk është një çmim që justifikon cilësinë e pakonkurrueshme të mollës së Dibrës por kjo mund të jetë një zgjidhje për të eliminuar kalbjen dhe hedhjen që për banorët do ishte një humbje e madhe.

Rruga e Arbrit mbetet një faktor negative i rëndësishëm në zhvillimin e tregut dhe ndikon shumë në situatat e ngjashme me rastin e mollëve. Çdo prodhim që në treg është shumë i kërkuar është e vështirë të transportohet drejt Tiranës. Kujtojmë patatet, qershitë, mishi, bulmeti aq i kërkuar pengohet duke mos i sjellë fshatarit dibran fitimet qe me djersë mundohet të jetojë. Dhjetra ton qershi u kalben në pemë këtë vit, qindra ton mollë po rrezikojnë të kalben kavaletave dhe mijëra ton patate hidhen në përrua, duke marrë me vete kështu mundin dhe djersën e prodhuesve dibranë.

Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve bashkiake nga komuniteti

Si të ndihmojmë në zhvillimin e ekonomisë në zonat e rurale të Dibrës në të gjitha fushat si në bujqësi, blegtori, mjedis, pyje, bimë medicinale.



Misioni i Agro Eko Dibrës: Të ndihmojë në zhvillimin e ekonomisë në zonat e varfëra rurale të Dibrës në të gjitha fushat si në bujqësi, blegtori, mjedis, pyje, bimë medicinale. Nuk është hera e parë që kjo organizatë ndeshet me sfida të tilla që duan angazhim dhe seriozitet. Vetëm para dy vitesh është realizuar një bashkëpunim me vlerë me projektin Sared, për zhvillimin e fermave blektorale në njësitë administrative Maqëllarë dhe Melan. Po kaq vlera ka patur realizimi i projektit "Rritja e vigjilencës mjedisore" në bashkinë Klos, mbështetur nga ALCDF-Ekonord. Një tjetër rezultat pozitiv për organizatën ka qenë bashkëpunimi me projektin "Natyra 2000", në përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit rural.

Ky është një projekt i financuar nga Bashkimi Europian, i fituar nga bashkia e Dibrës dhe që zbatohet nga organizata Agro Eko Dibra.

Projekti ka si qëllim:

-Përmirësimin e situatës pyjore dhe faunës në territorin e vargmaleve të Kërcinit, duke zbritur poshtë lumit Drin, me qëllim rritjen e vizitueshmërisë nga turistët vendës dhe të huaj.

- Rritjen e kujdesit ndaj pyjeve me një proces të integruar, ku të gjithë aktorët të jenë pjesëmarrës dhe të zbatohen rreptësisht reformat dhe ligjet në fuqi.

- Mbrojtjen e florës dhe faunës së Dibrës, duke shtuar masat për ndërgjegjsimin e komunitetit dhe përfshirjen e institucioneve në përpjekjet për zbatimin e reformave dhe ligjeve që rregullojnë biodiversitetin.

Organizata Agro Eko Dibra dhe drejtori ekzekutiv i saj, Maksim Hajrullai, si hap të parë të punës së tyre menduan se ishte njohja e gjendjes reale, jo nga zyrat, apo raportet, por duke shkelur cep më cep terrenin ku do të zbatohej projekti në fjalë. Problemet ishin goxha të vështira dhe të natyrave të ndryshme, por stafi i punës piketoi disa si më kryesore: prerja e drurëve pa leje dhe vendosja e zjarreve në pyje; gjuetija e paligjshme dhe vjelja pa kriter e bimëve mjekësore, duke prishur situatën mjedisore; zhdukja e shumë bimëve dhe kafshëve të egra; shkatërrim i peisazhit dhe humbje e vlerave turistike; rritja e erozionit dhe krijimi i situatave degraduese të mjedisit.

Të gjitha këto probleme e vështirësonin mjaft zbatimin e projektit, por jo për ta bërë të pamundur. Stafi i organizatës do të gjente plot aktorë mjaft të interesuar për të bashkpunuar ngushtë, në një synim të tillë madhor.

Meqë projekti shtrihej në tre zona, Maqëllarë, Melan dhe Kala të Dodës, bashkëpunimi me pushtetin lokal, bashkinë dhe njësitë administrative respektive, ishte i domosdoshëm.

Një tjetër fushë bashkëpunimi do të ishte me inspektoriatin pyjor, me agjensinë e zonave të mbrojtura dhe policinë e rendit, me shoqatat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave, me inspektorët e ndërtimit dhe urbanistikës, me sektorin e emergjencës civile, prefekturën dhe bashkinë.

Organizata Agro Eko Dibra e ka të qartë se rruga është e vështirë, se rezultatet pozitive për vetë karakterin e problemit, vijnë ngadalë, pasi dhe vetë rritja e pyjeve është e tillë. Ajo që shkatërrohet në pak muaj, do vite dhe dekada për tu riparuar. Sfidat janë të hapura, duhen gjetur shtigje e mënyra për të realizuar idetë dhe projektin. Synohet që: të bëhet rehabilitimi i zonave të dëmtuara, pyllëzimi i sipërfaqeve të dëmtuara me llojet autoktone, harmonizimi i nevojave të popullatës me mundësitë që ofrojnë pyjet, krijimi i parqeve të vogla për komunitetin, shtimi dhe mbrojtja e faunës së egër.

Misioni i Agro Eko Dibrës tashmë është i qartë: Të ndihmojë në zhvillimin e ekonomisë në zonat e varfëra rurale të Dibrës në të gjitha fushat si në bujqësi, blegtori, mjedis, pyje, bimë medicinale. Nuk është hera e parë që kjo organizatë ndeshet me sfida të tilla që duan angazhim dhe seriozitet. Vetëm para dy vitesh është realizuar një bashkëpunim me vlerë me projektin Sared, për zhvillimin e fermave blektorale në njësitë administrative Maqëllarë dhe Melan. Po kaq vlera ka patur realizimi i projektit "Rritja e vigjilencës mjedisore" në bashkinë Klos, mbështetur nga ALCDF-Ekonord. Një tjetër rezultat pozitiv për organizatën ka qenë bashkëpunimi me projektin "Natyra 2000", në përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit rural.

Në ditët e fundit të tetorit u zhvillua një takim i gjërë për menaxhimin e pyjeve në Maqëllarë, me drejtues organizatën Agro – Eko Dibra. Merrnin pjesë specialistë të inspektoriatit pyjor, të bashkisë, punonjës të njësisë administrative, kryetarë të fshatrave, dashamirës të pyjeve dhe të mjedisit, si dhe një grup gjimnazistesh, që i dhanë akoma më shumë gjallëri takimit. Diskutime, pyetje dhe probleme të ngritura. U vlerësua puna e mirë me pyjet e ulëta, në pronësi të fshatrave, forcimi i legjislacionit, krijimi i zonave të mbrojtura dhe u hodhën ide për të ecur më tej akoma. Kishte një dëshirë tek të gjithë për tu ringritur, për tu ndërgjegjsuar dhe për të punuar më shumë.

Mbrojtja e pyjeve është një domosdoshmëri dhe imperativ i kohës. Ajo kërkon një koalicion të madh njerëzish, njerëz me ide, njerëz me dëshirë për ta parë mjedisin e tyre të pastër, të gjelbërt dhe atraktiv, të bukur për vete dhe për fëmijët tanë.

Ky botim u mundësua nga AgroEko Dibra në kuadër të Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor, i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

printime dixhitale

DUKE FILLUAR NGA 1 KOPJE E VETME

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme

libra | broshura | revista | fletëpalosje

katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Maqellarë, situatë alarmante nga mbetjet

Nga **SAMI CURRI**

Pirgjet me plehra të urojnë mirë se ardhjen në Maqellarë. Kjo panoramë e shëmtuar të ofrohet që në qendër, aty ku kalon edhe rruga nacionale Peshkopi – Tiranë. Njësia administrative Maqellarë pas reformës administrative të 2015-s është pjesë e bashkisë së Dibrës. Ka afro 13, 900 banorë të regjistruar pranë zyrës së gjendjes civile pranë kësaj njësie në përbërje të së cilës janë 22 fshatra (Maqellarë, Bllatë e Poshtme, Bllatë e Sipërme, Burim, Çernen, Fushë e Vogël, Katund i Vogël, Kërçisht i Sipërm, Kërçisht i Poshtëm, Kllobçisht, Kovashicë, Majtarë, Pocest, Pesjak, Podgorc, Vojnik, Dovolan, Erebarë, Grezhdan, Herbel, Popinar, Gradec.)

Rrethuar nga fëmijët, kazanët e mbetjeve në hyrje të oborrit të shkollës 9-vjeçare Maqellarë, duket sikur janë po kaq të "lumtur dhe të buzëqeshur" si fëmijët e kësaj shkolle. Të mbushur plot e për plot, mbeturinat janë shpërhapur edhe përqark kontenierëve, duke krijuar një imazh shumë të keq dhe një burim infeksionesh dhe sëmundjesh për fëmijët që kalojnë një pjesë të madhe të ditës në këtë ambient. Kazant e mbetjeve të vendosur në hyrje të shkollës janë kthyer në një problem shumë shqetësues edhe për prindërit dhe drejtorinë e shkollës. Me anë të një shkresë drejtuar bashkisë Dibër dhe njësisë administrative Maqellarë, që ne disponojmë, drejtuesit e shkollës kërkojnë që këto kontenier të mbetjeve të largohen nga hyrja.

"Kazanë të hapur, pastrimi rrallë i tyre dhe shpërndarja e tyre nga qentë e rrugës, ato shërbejnë si burim infeksionesh e sëmundjesh të rënda për nxënësit, mësuesit dhe të gjithë komunitetin. Prandaj ne si institucion dhe qendër komunitare kërkojmë largimin e kësaj pike grumbullimi mbeturinash në një vend tjetër", shkruhet në shkresën që mban firmën e drejtuesit të shkollës Gëzim Qoku. Por edhe pse shkresa është dërguar pak ditë përpara fillimit të vitit shkollor 2018 – 2019, ende bashkia Dibër nuk ka marrë asnjë masë për zgjidhjen e këtij problemi.

Përparim Allçiu, specialist i bujqësisë pranë njësisë administrative Maqellarë shprehet se në eksperiencën e tij disavjeçare si punonjës administrate, më parë si komunë e sot si njësi administrative, menaxhimi dhe trajtimi i mbetjeve historikisht ka qenë problem. Sipas Allçiut, aktualisht bëhet tërheqja e mbetjeve nga bashkia e Dibrës vetëm përgjatë aksit nacional, në qendër të Maqellarës dhe në disa fshatra ku janë vendosur kontenierët. "Është realisht shumë problem kjo pjesë. Era e rëndë, djegia e mbetjeve që krijojnë një imazh shumë të keq për Maqellarën. Ky problem është mbartur me vite. Edhe në ato fshatra, ku komuniteti është angazhuar vetë në mbledhjen e mbetjeve, ato sërish ose hidhen në tokë të përbashkët ose në shumicën e rasteve pranë përrenjëve", shprehet Allçiu.



kazan plehrash para shkollës 9-vjeçare, Maqellare.

FSHATRAT E MAQELLARËS, SITUATA E MENAXHIMIT TË MBETJEVE EDHE MË E RËNDË

Në vëzhgimin tonë në disa prej fshatrave me numrin më të madhë të banorëve në Maqellarë, mbetjet janë shoqëruesit në tërë rrugën që përshkrojmë, ku bukuria e natyrës dhe njerëzit shumë miqësor dhe mikpritës - nuk e fshehin dot një problem të tillë. Banorët e disa fshatrave kanë zgjedhur një mënyrë vetë si komunitet për menaxhimin e mbetjeve, duke punësuar banorë të zonës që me traktorë të bëjnë grumbullimin dhe depozitimin e tyre pranë tokave djerrë, por në shumicën dërrmuesë pranë përrenjëve.

Në afërsi të shkollës fillore të fshatit Bllatë e Poshtme digjen dhe hidhen mbeturinat. Jo vetëm mbeturinat që krijohen nga nxënësit e kësaj shkolle por edhe banorë të zonës që i hedhin mbetjet në hyrje të oborrit të shkollës. Një mësuese që po merrej me grumbullimin dhe me djegien e mbeturinave shprehet se djegia e mbeturinave bëhet pasi nuk kanë se ku ti depozitojnë "Ose do ti mbajmë kapic këtu ose do ti djegim dhe më pas ti mbulojmë me rërë se rrugë tjetër nuk ka. Këto janë mbeturinat e shkollës, por edhe banorët në disa raste këtu i hedhin. Kjo është situata, nuk kemi se çfarë bëjmë", shprehet ajo, identiteti i së cilës nuk dëshiron që ti bëhet publik.

Vetëm pak metra nga shkolla fillore e fshatit Bllatë e Poshtme, në një rrugë fshati, rrethuar nga pemët, ngjan tamam si e shtruar me mbeturina, pasi syri të shikon vetëm qese të mbushura me mbetje dhe dy mace që po "inspektojnë" ato se çfarë mbajnë këto qese në brendësi. Përgjatë segmenti të rrugës kryesore që të dërgon në doganën e Bllatës, pika lidhëse me Maqedoninë dhe deri në fundin e fshatit syri nuk të shikon asnjë kontenier për hedhjene mbeturinave.

Ato pak biznese që gjenden në këtë fshat, kryesisht pika tregtimi ushqimesh dhe tek-tuk ndonjë kafene; pronarët e tyre, në kushtet e anonimatit shprehen se problemi në menaxhimin e mbetjeve në fshatin e tyre, por edhe në tërë Maqellarën është me vite dhe asnjëherë, pushteti vendor dikur komunë dhe sot si pjesë e bashkisë së Dibrës nuk i kanë dhënë zgjidhje këtij problemi. Edhe banorët e pyetur shprehen shumë të shqetësuar për një problem të tillë. "Nëse dikë e ke inat në Maqellarë, apo do që të bësh sherr me të nuk ke nevojë të bësh llafe, hidhja mbeturinat në oborr dhe i ke hapur shumë punë. Na ka ardhur laku në fyt. Madje një pjesë, mbeturinat i hedhin edhe në afërsi të oborrit të shkollës, aty ku lozin fëmijët." shprehet një zonjnë, që sa me ironi dhe sa me seriozitet mundohet ta përshkruaj situatën përsa i përket menaxhimit të mbetjeve në fshatin e saj.

"Ne pagesën e taksës për pastrimin dhe gjelbërimin ja japim bashkisë. Kjo taksë mbahet edhe tek personat që trajtohen me ndihmë ekonomike çdo muaj, pra, që bashkia të bëj pastrimin e mbetjeve. Këtu po ta vësh re me kujdes, nga Maqellara e deri në qendër të fshatit nuk të zë syri një kosh mbeturinash, pra ne paguajmë një shërbim që nuk e marrim", këto janë fjalët e Ulsi Qokut, banorë i fshatit Kllobçisht në një njësinë administrative Maqellarë. Kllobçishti është një fshat vetëm 7 minuta larg nga qendra e Maqellarës, njëri nga fshatrat më të mëdha të kësaj njësie administrative.

Banorët e zonës janë organizuar vetë, duke paguar një banorë të fshatit që ka një traktor që të bëj pastrimin e mbetjeve, të cilat depozitohen buzë një përroit. Kjo situatë e krijuar nga menaxhimi i mbetjeve është prej vitesh. "Ne paguajmë nga 100 lekë për çdo shtëpi, afro 200 ekonomi familjare dhe vjen çdo të dielë traktori dhe i hedh diku këtu afër, në përrua", na tregon Qoku. Por situatës së rënduar me mbetjet nuk i ka shpëtuar as edhe shkolla 9-vjeçare e këtij fshati. Në hyrje të shkollës na pret një grumbull mbetjesh i djegur, tymi kancerogjen që çlirohet nga djegia e mbetjeve deporton edhe në klasat e kësaj shkolle. Mësuesit na tregojnë se sanitarja e shkollës, që paguhet me lekët e nxënësve, paguan një shumë prej 100 lekësh, ashtu si edhe banorët e zonës që mbetjet të merren nga traktori, por që në shumë raste digjen në hyrje të shkollës.

Në afërsi të një tabele prej druri që do të duhej të shërbente për vendosjen e posterave dhe njoftimeve apo edhe si një kënd informimi për turistët e huaj, përbri, mes erës së rëndë qëndron një grumbull



Fshati Pocest

Banorët e zonës janë organizuar vetë, duke paguar një banorë të fshatit që ka një traktor që të bëj pastrimin e mbetjeve, të cilat depozitohen buzë një përroit. "Ne paguajmë nga 100 lekë për çdo shtëpi, afro 200 ekonomi familjare dhe vjen çdo të dielë traktori dhe i hedh diku këtu afër, në përrua", na tregon Qoku. Por situatës së rënduar me mbetjet nuk i ka shpëtuar as edhe shkolla 9-vjeçare e këtij fshati. Në hyrje të shkollës na pret një grumbull mbetjesh i djegur, tymi kancerogjen që çlirohet nga djegia e mbetjeve deporton edhe në klasat e kësaj shkolle. Mësuesit na tregojnë se sanitarja e shkollës, që paguhet me lekët e nxënësve, paguan një shumë prej 100 lekësh, ashtu si edhe banorët e zonës që mbetjet të merren nga traktori, por që në shumë raste digjen në hyrje të shkollës.

“Mungesë në mjete transporti dhe gjendje e amortizuar e mjeteve ne dispozicion, fuqi punëtore e pa mjaftueshme dhe shpenzime të tjera financiare të pa përballueshme”, shkruan bashkia Dibër në përgjigjen e saj.



Maqellare, qender



Vend depozitimi i mbetjeve ne fshatin Popinar

me plehra, jo shumë larg banesave të fshatit dhe përroit. Ramadan Hamzai, banor i fshatit Popinar na tregon se mbetjet dhe menaxhimi i tyre ka qenë problem prej shumë vitesh, por që asnjëherë nuk mori zgjidhje. Hamzai na tregon se kanë pasur edhe përplasje mes lagjeve të fshatit, sepse askush nuk pranon që ta ketë grumbullin e mbetjeve afër banesës së tij. “Kemi pasur disa vend-hedhje të mbetjeve, por gjithmonë i kemi hedhur ose buzë përrenjëve ose në një tokë djerrë. Ere e keqe boll, shpërhapur mbeturinat gjithëandej qese – qese. Me këtë projektin që po zbatohet nga Behari sikur jemi vënë pak në lëvizje, është mirë që komuniteti të bëjë shumë më shumë në lidhje me menaxhimin e mbetjeve. Që pushteti vendor të bëjë punën që i takon dhe për të cilën paguhet” shprehet Ramadani.

Në fshatin Popinar dhe Pocest, situata muajt e fundit është bërë edhe më e rëndë, kjo për faktin se një banorë i zonës që më parë kundrejt një pagese prej 100 lekësh për familje, me traktor bënte grumbullimin e mbetjeve, nuk e bën më. Mbetjet hidhen grumbuj – grumbuj nëpër fshat dhe ju vendosin flakën, duke shkaktuar tymra dhe helme që përhapen në atmosferë.

Banorët e fshatit Fusha e Vogël në njësinë administrative Maqellarë të Dibrës, prej më shumë se 5 vitesh e bënin vetë administrimin e mbetjeve. Një veprim i tillë kryhej nga banorët e këtij fshati që numëron afro 50 familje, por që prej disa javësh nuk kryhet më një gjë e tillë, pasi banori i fshatit të tyre që bënte pastrimin me traktor është larguar në emigrim, duke krijuar një situatë shumë alarmante lidhur me mbledhjen e mbetjeve.

PUSHTETI VENDOR “NGRE DUART LART” PËRBALLË NJË SITUATE TË TILLË

Duke ju përgjigjur një kërkese për informacion depozituar pranë bashkisë Dibër, lidhur me këtë problem; bashkia e pranon faktin se në fshatrat e njësisë administrative Maqellarë nuk ofrohet një shërbim i pastrimit të mbetjeve. Bashkia në përgjigjen e saj shkruan se shërbimi i pastrimit të mbetjeve, kryhet vetëm përgjatë rrugës nacionale dhe në disa fshatra afër rrugës ku janë vendosur kontenierë dhe bën tërheqjen e tyre me makinë tekonologjike. “Mungesë në mjete transporti dhe gjendje e amortizuar e mjeteve ne dispozicion, fuqi punëtore e pa mjaftueshme dhe shpenzime të tjera financiare të pa përballueshme”, shkruan bashkia Dibër në përgjigjen e saj.

Në fshatin Popinar dhe Pocest, situata muajt e fundit është bërë edhe më e rëndë, kjo për faktin se një banorë i zonës që më parë kundrejt një pagese prej 100 lekësh për familje, me traktor bënte grumbullimin e mbetjeve, nuk e bën më. Mbetjet hidhen grumbuj – grumbuj nëpër fshat dhe ju vendosin flakën, duke shkaktuar tymra dhe helme që përhapen në atmosferë.

Shumica e njësive administrative të bashkisë Dibër nuk e ofrojnë shërbimin e pastrimit të territorit. Fusha e depozitimit të mbetjeve në Peshkopi është ndërtuar në vitin 2003, ndodhet 2 kilometra larg nga qyteti dhe është planifikuar të jetë funksionale për një periudhë 25-vjeçare, me një kapacitet deri në 1000 ton mbetje në muaj.



STUDIME MBI MBETJET NË DIBËR

Sipas një studimi kryer nga ALCDF (Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale) në vitin 2015-të qarku i Dibrës gjeneronte rreth 17,136 ton në vit. Pjesa më e madhe e mbetjeve në këtë qark gjeneroheshin nga bashkia e Dibrës (qyteti) me rreth 8,300 ton mbetje urbane dhe inerte në vit, ose 49% e gjithë sasisë dhe në Maqellarë me afro 2000 ton në vit.

Po sipas këtij studimi çdo banor në qarkun e Dibrës gjeneron afërsisht 0,6 kg mbeturina në ditë ose 215 kg mbeturina në vit. Kjo shifër në qytetin e Peshkopisë është më e lartë, ajo varion rreth 415 kg mbeturina në vit për çdo banor.

NDIKIMI NË SHËNDETIN E NJERIUT NGA DJEGIA E MBETJEVE

Nga shumë studime në fushën e mjekësisë dhe nga specialistë të fushës, shprehen se procesi i djegies së mbetjeve është shumë i dëmshëm për shkak se liron substanca nga më të rrezikshmet që janë dioksinat, që shfaqin probleme si në sëmundjet respiratore e deri në sëmundjet kanceroze.

Për Prof. Asoc. Dr. Arjan KORPA, nga departamenti i Kimisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, në një artikull të gjatë botuar në gazetën “Sot” lidhur me mbetjet, liston një sërë dëmesh që i vijnë organizmit të njeriut nga djegia e mbetjeve dhe mos trajtimi si duhet i tyre.“Nuk ka dyshim që, në varësi të llojit të materialit të pranishëm në mbetje, ekziston një potencial i konsiderueshëm për ndodhjen e ekspozimit të dëmshëm, veçanërisht të individëve që merren me menaxhimin e mbetjeve dhe të komuniteteve që jetojnë në afërsi të zonave të trajtimit të mbetjeve. Një individ mund të ekspozohet ndaj një substance me anë të një ose disa rrugëve, p.sh. nëpërmjet frymëmarrjes, ujit, konsumimit të ushqimeve që e përmbajnë substancën dhe kontaktit të substancës me lëkurën.”, shkruan Prof. Korpa.

Me një Vendim të Këshillit të Ministrave, njësitë e qeverisjes vendore, duke filluar që prej fillimit të vitit 2016-të duhet të kishin filluar diferencimin e mbetjeve që në burim. Por në Dibër një gjë e tillë nuk ka filluar të ndodhë dhe nuk duket dritë në fund të tunelit, se në të ardhmen mund të fillojë një proces i tillë.

Shumica e njësive administrative të bashkisë Dibër nuk e ofrojnë shërbimin e pastrimit të territorit. Fusha e depozitimit të mbetjeve në Peshkopi është ndërtuar në vitin 2003, ndodhet 2 kilometra larg nga qyteti dhe është planifikuar të jetë funksionale për një periudhë 25-vjeçare, me një kapacitet deri në 1000 ton mbetje në muaj.

Lidhur me këtë problem, njëri nga banorët e Maqellarës, Behar Dema aplikoi si individ në thirrjen e pestë të Lëviz Albania për zbatimin e projektit për monitorimin e menaxhimit të mbetjeve urbane në “Njësinë Administrative Maqellarë”. Dema shprehet se një lëvizje e tillë vjen, për të advokuar tek pushteti vendor, në këtë rast bashkia Dibër që të bëj punën për të cilën paguhet nga taksapaguesit, që është menaxhimi i mbetjeve urbane.

(Shënim: Fotot ilustruese janë të autorit)

Rruga e Arbërit nr. 150
vëzhgim

Mendim

Shpifja si fjalë e randë që s'e mban kandari

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Shpifja asht nji veprim i ulët; burri me dy gishta nder në ballë nuk shpif kurrë. Me vra dikush shpifësin, gjakun ja ka, po të gjithë i thonë: "Të lumtë pushka" (Kanuni i Dibrës 2512)

Populli e ka mat kurdoherë fjalën që ajo të mos vrasë. Në popull has rëndom, në biseda të përditshme e në kanune shumë shprehje të mençura që lidhen me fjalën e dalë nga gjuha që siç thotë Ezopi, "është gjëja më e mirë në botë sepse me gjuhë mund të flasësh për dashurinë, për lumturinë, për natyrën e bukur, për shoqërinë e mirë... por njëkohësisht gjuha është gjëja më e keqe në botë. Gjuha shpall luftërat, gjuha ndan njerëzit. Me ndihmën e saj shumë njerëz gjithë kohën flasin veç marrëzira. Këta njerëz të bardhën e bëjnë të zezë, të drejtën të shtrembër, të mirën të keqe..." E para po bëhet gjithnjë e më e rrallë në shoqërinë e kohës që jetojmë, kurse e dyta ka pushtuar kuvendin, median, llapën politike majtas e djathtas. Ajo ka hedhë rrënjë në foltoren e kuvendit, në gazeta, portale, në rubrika televizive "opinion"... duke vrarë pa mëshirë njeriun pa mburojë. Populli, më shumë se për gjithçka në kulturën e tij historike, për fjalën e rëndë, shpifjen, ka vendosë kanune që e kanë mbajtur në këmbë në rrjedhën e historisë duke mos u asimiluar... Ai thotë:

Fjalën mate shtatë herë, dhe preje njëherë...

Mos shti kurrë pa e vu për syri...

Bëje rob fjalën mos me të bë rob ajo ty...

Kafshatën e madhe haje, fjalën e madhe mos e fol...

Nëna e çdo belaje, është fjala...

Fjala është si bleta: ka mjaltin, por ka edhe zeherin...

Pushka vret një, fjala vret njëmijë...

Plaga e pushkës shërohet, plaga e fjalës nuk shërohet kurrë...

Fjalën e keqe edhe me e mbyllë në dyzet dryna, del...

Fjalën e keqe nuk e mbyt deti, nuk e vret rrufeja, e nuk e djeg zjarri...

* * *

Kryeministri Rama doli në publik me idenë e një projektligji për të dënuar penalisht të gjithë ata që shpifin. Reagimet menjëherë mbinë siç mbinë grami e talla në arë për ta marrë e tharë misrin.

Të djathtët si gjithnjë dolën menjëherë ta kundërshtojnë. Doli edhe një aktor në një rol që të bënte të tundje kokën e të kujtoje italianin Malombra në romanin "Qyteti i fundit" të Petro Markos tek përsëriste pa pushim: "povero noi!" Doli edhe një shkrimtar, ish ministër, diplomat "pa portofol" e tha: (citoj) ***"Është një përpjekje e kryeministrit për të larguar vëmendjen e medias, opinionit publik, ndërkombëtarëve nga skandali i madh. Nuk mund ta përfshijë në kodin penal shpifjen. Është e qartë dhe e padiskutueshme...."***

Tjerrja mbi furkë pa bashkë vazhdon...

Pyes: A duhet të ketë një ligj që të dënojë penalisht të gjithë ata që shpifin, të gjithë

Shpifja asht nji veprim i ulët; burri me dy gishta nder në ballë nuk shpif kurrë. Me vra dikush shpifësin, gjakun ja ka, po të gjithë i thonë: "Të lumtë pushka" "Për shpifje të randa që bajnë me fjalë krejt katundin, shpifësi ndahet "Për mort e për dasëm". "Në kuvend fjala e randë nuk falet kurrë. Kuvendi të shamit i ve nderin në vend: fjalërandit i mba armën e e përzë prej kuvendit: Në ndonjë rast i djeg edhe shpinë".

ata që e hedhin fjalën e rëndë, pa mend në kokë?

Thuhet që Gjermania e ka një ligj të tillë, ligj që të dënon deri në tre vjet privim lirie po qe se shpif, po qe se nuk e mban llapën brenda zgavrës së gojës dhe nuk e nxjerr "pa e matur shtatë herë". Përgjigjen gjykoj që të mos e kërkojmë tek fjalët "pa kandar" të politikanëve shati i të cilëve tërheq gjithnjë nga vetja, as median e shkruar e televizive me lopatë për të varros gjithçka.

Ta kërkojmë në urtësinë që i ka dhënë në shekuj e mijëravjeçarë populli, me fjalën monument. Shtjefën Gjeçovi në mbledhjen dhe kodifikimin e Kanunit të Lekë Dukagjinit duke folur për nderin ku "secili e ka për vedi e nuk mund të përzihet kush" thotë: "Dy gisht nderë ka seicili në lule të ballit. Seicili mbahet i mirë dhe i thotë vedit "Jam burrë" e i thonë "A je burrë". "Ndera, vijon Gjeçovi, i merret burrit me i thanë kush se rrenë faqe burrave të mbledhun në kuvend. Me e pshty, me iu matë (E matmja si e ramja, e ramja si e vramja)... (E drejta zakonore shqiptare f. 105)

Në Kanunin e Dibrës (Xhafer Martini) "Fjalë e randë" (faqe 555) nuk quhet vetëm ajo që thuhet syndërsy, por edhe ajo pas shpine". "Shpifja është një veprim i ulët: burri me dy gisht nder në ballë nuk shpif kurrë. Me vra dikush shpifësin, gjakun ja ka po të gjithë i thonë "të lumtë pushka" "Për shpifje të randa që bajnë me fjalë krejt katundin, shpifësi ndahet "Për mort e për dasëm". "Në kuvend fjala e randë nuk falet kurrë. Kuvendi të shamit i ve nderin në vend: fjalërandit i mba armën e e përzë prej kuvendit: Në ndonjë rast i djeg edhe shpinë".

Me shembujt e mësipërm, shembuj që i gjen në të gjithë kanunet (Kanuni i Dukagjinit, i Dibrës, i Skënderbeut, i Labërisë...) populli me mënyrat e veta i ka vënë fre fjalës së rëndë, llapës së nxjerrë një pashë, shpifjes deri në përzënie nga fshati e djegie shtëpie. E quaj me vlerë që para se të hartojmë ligje (çfarëdo ligji), të lexojmë dhe reflektojnë me fjalën shekullore të popullit, fjalë që e ka mbajt në këmbë duke i dhënë krah e mend në betejën për mbijetesë. Një ligj për t'i thënë ndal shpifjes, ndal fjalës së rëndë në Kuvendin e Shqipërisë, në gazeta e televizione e quaj të domosdoshëm ashtu siç quaj të domosdoshëm një nen për gjakmarrjen me dënim kapital çka do të hapte dyert e shtëpive ku ngujohen fëmijë e vajza të reja. Evropa është shekuj para nesh (vetëm 61 vjet universitet kemi) e rruga drejt saj duhet matur me hapin tonë e jo me hapin e saj.

Athinë, 5 tetor 2018

Peshkopia ndodhet në të dy anët e lumit Drin?!

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Çudi të çuditshmish në internet!

Thonë pa kandar në brez:

- Peshkopia e paska marrë emrin nga greqishtja!?

- Peshkopia u ndodhka në të dy anët e lumit Drin!?

Një mik i viteve të emigracionit, lexues i pasionuar i gjuhës shqipe, megjithëse ka gjashtëdhjetë vjet larguar, më thoshte se në qoftë se donë të vlerësosh një enciklopedi apo një libër, kërko atë që njeh më shumë.

Më është bërë zakon një gjë e tillë sa herë hap faqet e ndonjë enciklopedie apo futem në internet. Kështu më ndodhi edhe kur një ditë u futa në faqen e www.shqipëria.com. Pashë që në adresën e qyteteve të Shqipërisë ishte edhe qyteti i Peshkopisë. E shtypa "miun" dhe para meje u shfaq:

...Një fotografi që e sheh Peshkopinë pas pemëve të një blloku të vjetër frutorë...

Një tjetër që sheh malet në lindje të ngarkuara me borë me Valivarin e bjeshkët e bardha të Hynoskës...

Një tjetër me një hurdhë uji dhe një mal të panjohur me plloça bore...

Dhe një shënim:

Peshkopia ndodhet në pjesën verilindore të Shqipërisë. Fjala Peshkopi rrjedh nga greqishtja e vjetër "episcopi", që do të thotë residence e peshkopit. Për here të parë është përmendur në një dokument të shekullit të XV. Qyteti është një bazë për të vizituar parkun kombëtar të Lurës si dhe është i njohur për Llixhat (ujërat termale te tij).

Më poshtë...

Peshkopia është qytet në Shqipërinë verilindore. Peshkopia ndodhet në të dy anët e Lumit Drin. Lugina e Drinit është pjesa më e ulët e rrethit.

Në afërsi të Peshkopisë ndodhet dhe mali më i lartë i Shqipërisë , Mali i Korabit (2751m)

U befasova. Emrin Peshkopia e paska marrë nga greqishtja e vjetër, nga fjala "episkopi" !?

Gjatë këtyre viteve emigrimi në shtetin Helen di që shumë e shumë shqiptarë (madje edhe prej Dibre, Shkodre apo Tropoje), me falsifikime dokumentesh (duke i ardhur për shtat qarqeve ekstreme vendase) janë bërë "vorioepirotë", kanë ndërruar emër e atësi, janë kunguar në kazanin e priftit dhe janë bërë "ortodoksë". Nuk i akuzoj e gjykoj. E kanë bërë dhe e bëjnë për të mbijetuar ashtu siç e ka bërë në shekuj shqiptari duke e ndërruar fenë nga katolik në ortodoks e më pas në mysliman, madje duke qenë dy vëllezër të një nëne e babai, njeri katolik dhe tjetri mysliman, siç ka ndodhur në Lurë.

Por ajo që më çudit është pse ndonjë shkrues i vendit tim, i dashuruar pas fjalëve të huaja e nxjerr Peshkopinë "episkopi", e nxjerr sikur ajo është krijuar nga kisha greke, e shtrinë "vorioepiritizmin" në rrëzë të Korabit?

Nuk e di pse gjuhëtarët tanë nuk e kërkojnë fjalën Peshkopi tek dialekti vendas, ai i fushës dhe i maleve të Dibrës, tek shqiptimi Peshpaj apo Peshpoj që një gjuhëtar dhe historian dibran e lidh me fjalën e drejt shkruar sot: - Pesë-shtëpi, Peshkëpi, Peshkopi...

Shumë fjalë të të folmes dibrane ka ndodhë që të "përkthehen" jo vetëm nga sllavishtja apo nga ndonjë ndikim turk por edhe nga shqipja e thjeshtë. Gjuricasit i thërrasin katundit të tyre Gjuricë në kuptim të gurëve që sjellin Drini i Zi dhe Zalli. Ne, në regjistrat zyrtarë i themi Gjoricë...

Nuk do të vazhdoj më tej, po ia lejë vendin Hajri Shehut të hulumtojë... Tjetër gjë përsëri më mërzit...

Peshkopia ndodhet në të dy anët e Lumit Drin. Lugina e Drinit është pjesa më e ulët e rrethit...

Që Peshkopia nuk ndodhet në të dy anët e Lumit Drin, (por në të dy anët e përroit që në rrjedhën e tij merr emrat e fshatrave nga rrjedh e kalon-Përroi i Bellovës, Përroi i Llixhave, Përroi i Peshkopisë, Përroi i Dohoshishtit, Përroi i Selanes...) këtë e dinë jo vetëm vendasit por edhe ndonjë udhëtar i rastit që kalimthi ka kaluar nëpër këtë qytet.

...Kështu ndodh kur historia, gjuhësia dhe gjeografia shkruhen me këmbë...

Që Peshkopia nuk ndodhet në të dy anët e Lumit Drin, (por në të dy anët e përroit që në rrjedhën e tij merr emrat e fshatrave nga rrjedh e kalon-Përroi i Bellovës, Përroi i Llixhave, Përroi i Peshkopisë, Përroi i Dohoshishtit, Përroi i Selanes...) këtë e dinë jo vetëm vendasit por edhe ndonjë udhëtar i rastit që kalimthi ka kaluar nëpër këtë qytet.



Rruga e Arbërit nr. 150

reportazh

Marrëzitë e kohës sonë



Nga dr. **Selman MEZIU**

Në vlagën e jetës futem me dëshirë, për të ndjerë freskinë e saj, për të zbuluar atë në të gjitha kapilarët e saj. Edhe pse takova mjaft miq, shokë koleg etj., rastësisht apo me vendosje oraresh takimesh, gjeta tek secili njeri i thjeshtë, gazetar, intelektual, fshatar, grimca ngjarjesh që mbushin kapilarët e jetës tonë edhe pse dëgjojmë, ndjejmë, shohim e lexojmë marrëzi djajsh përqark.

TURIZMI I ZEMËRUARNË HINOSK

Mora frymë lirshëm. Sytë livadhisnin në paanësi. Gjelbërimi i barërave me plotë lule dhe aromë përzier me copëra shkëmbinjsh të murrmë, sikur ndizte shpirtin. Paksa poshtë majës së Hinoskës (2062 m.) në rresht si një kurorë e shkujdesur gjurmë qendrash zjarri. Të shkatrrueme barbarisht. Shufrat e hekurit iu ngjanin dhëmbëve të një kafshe të ngordhur prej vitesh. Coprat e betonit të coptuaeme, dukeshin aty këtu ose kishin zbritur tëposhtë. Kushedi se ku ishin ndalur.

Unë e lash dibran Hysen Uka të fliste. Ai u bë më serioz në fytyrë dhe më tha: "Po pse të prishen ato atje. Sepse mund të shërbenin si bujtina për turistët. Netët e pranverës e të verës në ato lartësi janë të shëndetshme. Po edhe nga fshati i Rabdishtit mund t'iu sillnin dhe me ngranë ose me tregtu prodhime e gatime fshati. Duke u thelluar më tej, sikur të bëje mbi ato edhe një pistë të thjeshtë biçikletash..."

"Kush i shkatërroi vallë?", - ndërhyra unë, - mirë se në bregdetin e Rushkullit në Durrës e dimë se i fundosën dallgët e tërbuara të detit, po në maje të Hinoskës?

Ideja e Hysenit ishte origjinale. Se si çdo ndërtim, çdo burim natyrorë, mund t'i shërbej njeriut të malësive, familjeve, turizmit. Të dyve na ngriu në buzë mendimi: Pse vallë akoma duhet të shkatrrojmë?

QEVERIA APO VIÇAT E HUTUAR?

Kush mund ta besoi një marrëzi të tillë? Askush! Po pse kaq e pa përfytyrueshme është kjo? Viçat po na bëhen pa dashur lopë e mëzetër. Sepse nuk mund të theren në Dibrën e poshtme dhe Mat se leja e therjes na u marrka në një zyre veterinerësh në Lezhë. Pra, fshatari i brengosur. Fshatari halleshumë. Fshatari i bërë qull nga djersa. Fshatari me fytyrën të nxirë nga dielli përvëlues. Fshatari me brengën e vuajtjeve në thellësi të shpirtit. Fshatari që fëmijët shpesh i çon të flenë pa darkuar. E se i vetmi burim leku është shitja e viçave, lopëve etj. Por ja që pa një sorollatje të kushtueshme e të lodhshme nuk mundet.

Përball tyre shpirt brengosur e zemër mjerueme qëndrojnë. qeveritarët e dhjamosur. Qeveritaret kokë bosha. Qeveritaret indiferentë. Qeveritaret që i shohin hallet e popullit nga piramidat kufitare të skamjes e bollëkut të shfrenuar. Qeveritarët e hardallosur. Ato dhe vetëm ato nuk e shërojnë popullin, por, i shtojnë vuajtjet. Kush paska para të udhëtoi dyqind kilometra e të marre një leje të firmosur e vulosur për të ther një viç?

Oh marrëzi e djajëve të kohës! Oh, kajmekanë të rinj! Oh tru shkulurit qeveritar, ktheni kokën nga populli përherë! Nuk thotë kot urtia e tij që "barkëngopuri nuk pyet për barkboshin".

SKLLEVËRIT NËN TORTURA

I mblodhi në një kand të udhës. Pluhuri ishte më se një pëllambë. Vapa e korrikut digjte si prush. Ishin të rinj, ose njomëzak, nuk kishin vënë brisk në faqe. Kur pas një gjysëm ore pritje u dëgjuan zërat: Ja erdhi, ky është fugoni që do të udhëtojmë. Vërtet sakaq doli një mjekrosh dhe me një zë inatçor thirri: Shpejt, shpejt, ngjituni!

Rrinin në kam, si fishekët në vesme. Filluam të djersitemi. Një erë e rënde, hundë shpuese u ndje. Nuk kishte dritare furgoni. Sigurisht, edhe ato mallra ishin. Por të gjallë, që mezi merrnin frymë. Në dysheme dukesh ndonjë rreze drite.

Unë i thashë nanës, babait dhe motrës, mos u mërzitni. Do ta provoj dhe unë fatin. Kaluan orë të tëra. Pastaj, për një çast u ndalëm. Ishte natë. Një pyll i dendur, ku u futëm të pushojmë e kryejmë nevojën.

Iknim nga vendi ynë se s'ka punë. Politikanët janë kthyer në shushunja. Paga është e ulët. Taksat po rriten çdo ditë. Familja u ndodh në vështirësi të madhe. Por, jo vetëm unë por me mijëra. Shikoni të rinjtë fytyrë skuqur e sy frymën. Hipëm në furgon, te dera na vunë një mushama të zezë. Në mes derës dhe asaj dëgjonim fështfërimën e kashtës së grurit që për dhjetë minuta nuk pushoi. Njëri nga skllevërit tha: "Vihet kjo, që po e hapi policia, i thonë: Ja, more vëlla, kemi kashtë gruri!

Njëri nga të rinjtë tha se tani jemi në doganën franceze, hyrja në ngushticën e Lamanshit. Këtu varet fati ynë. Sapo u ndal mikrobuzi, askush nuk merrte frymë. Nuk kuptonim as edhe një fjalë. Veçse po hap dera e lamanshit jemi khyer në Anglez.

Por, një zhurmë e madhe dhe sakaq u hoq plasmasi. Një dritë elektrike sa nuk na qërroi sytë, ku ishim kthyer në lakuriq nate. Prej tre ditësh e netësh udhëtonim në errësirë. Të djersitur. Të uritur. Fytyrë zvedhur. Sytë mezi i hapnim. Drita e zakonshme na detyronte t'i mbyllnim. Një erë pështirë kundërmonte.

Me shpejtësi mbyllën dyert e furgonit. Dhe të shoqëruar nga dy makina policie para e mbrapa po ktheheshim drejt varrit tonë të hapur. Po, kështu na ishte bërë atdheu ynë, Shqiperia.

TË LUTEM BLIJE, TË LUTEM...

Në dy anët e rrugës të kësaj bregorja, një peizazh i trishtueshëm. Shkëmbinj gri e të zi, thepa-thepa me pak barëra të thara e ndonjë dëllinj me kokrra të rrudhosura. Poshtë shtrihej një luginë me disa arëza kuadrate apo drejtkëndeshe të çrregullta. Mezi dukeshin disa shtëpi përdhese. Një fshat pothuajse i braktisur, i zymtë i pajetë. Disa me çatia të prishura pjesërisht, apo mure gjysmë të shqyeme. Aty këtu dukeshin kurora të ndonjë peme frutore me gjethe në vyshkje e sipër.

Ndërsa maknia bëri një kthesë, anash saj një djalë me një tuf çaji mali në dore duke thirrur: Blijeni çajin ju lutem, blijeni që të blejë edhe unë një copë bukë! Këlthitja vinte e dallgëzuar. E trupëzuar prej dhimbjes. Ai po na ndiqte. Ndalëm makinën. Nuk mund të kapërcehesh kjo xhenaze. Nuk mund të gjendet njeri që të mos ndaloi para lutjeve e dy pika lotëve të dhimbsur që iu rrokullisën fytyrës së skuqur, njomështake të vocërrakut nga Planbardha.

Flokët të shkurtër ngjyrë gështenjë, me një ballë të rrafshët, vetulla të zeza të pluhurosura, me dy sy të mbytur nga lot vuajtjesh. Piskama të vinte sertshëm e dhimshurueshëm nga skutat e shpirtit. Vështrova pantallonat, në të dy gjunjët ku dukshin gjurmë të njollosura nga balta e ngjitur si dyll qershie. Këpucët prej llastiku ku njërës i ishte shqitur një fletë e shollës e kur vraponte me duart zgjatur drejt nesh, ajo hapesh e mbyllesh duke ngritur pluhurin e zi të asfaltit të masakruem.

Nuk kisha rrugë tjetër zgjidhje, hapa portofolin dhe i dhashë pesëqind lekë të reja. Ndërkohë vocërraku zgjati dorën dhe e mori dhe me tjetrën më afroi tek fytyra tufën e çaji, ku ndjeva aromën e saj të kandshme. Ndërkohë ai futi dorën në xhep dhe nxori disa monedha: Merrni kusurin ju lutem. - Më erdhi një zë i trupëzuar në mes thatinës së shpirtit dhe buzëve të thara që mezi u hapën për të shqiptuar fjalët.

- Nuk është nevoja për kusurin, tu bëfshin gjak e dhjam, – i thash duke i shtyrë dorën me monedhat e atë që mbante çajin. Vocërraku mjeran me një buzëqeshje të çiltër e sytë të shkëndjuar u nis drejt turrës me tufa çaji anës rrugës.

Makina mori vrull duke bëre një zhurmë gërvishtëse nga asfalti i gropëzuem. Përpara mu hap zgafella e një tuneli që kishte shëmtuar peisazhin e hapur një gojë të shkyeme sikur do të më përpinte mua me makinë, familjen e vocërrakun.

TELAT ME GJËMBA

Uji është burim i pazëvendësueshëm jete gjallesash. Lumi lag shtratin e vet, bleron brigjet anash e mundëson të rriten bimë, kafshë e shpend. Por kujdes, kur egërsohet, përlan e merr me vete gjithçka. Mjafton një pengese natyrore apo e ndërtuar nga njeriu dhe ai humb drejtimin. Përplaset në tokën e butë dhe e han me oreks lubish. E vërtet ndodh që zhduk sipërfaqe të tana.

Dikur ishte një brryl rrase që devijonte rrjedhjen e tij. E uji kur vinte më furi në vjeshtat me shi të vrullshëm, gllabëronte tokën. I mbillnin, verri, shenje plepa anash shtratit. Rrënjët e tyre e mbronin tokën se ato e shtrëngonin fort, nuk e lëshonin për qamet, njëkohësisht edhe ushqehesin e rrisnin shtatin. Por ja që i zoti i kësaj toke që i rrëmbehej, mori një llokum dinamiti, kapsolle dhe ia vuni brrylit. Plasi. Një pjesë u shkërmoq. Një natë tjetër u nis drejt saj për të kryer të njëjtin veprim. Por kësaj radhe gjeti të zotin e brrylit dhe të shpatit të ulur mbi rras. U afrua duke bërë llafe të këqija, me sharje, kërcënime. Por, u shua sherri dhe azgjë me tej. Ai u largua.

Tani, më të rinjt e tokës që e përpiu lumi ujëshumtë si një lubi, morën një tel me gjëmba e vunë në mes të udhëkalimit. Pra e thanun ashikqare, këtu nuk do të kaloni. As fëmijët në shkollë, as për të bluar e as të banin pazarin. Por, tjetrit që banonte në anën tjetër, pra te brryli, udha i duhej. Prandaj mori telin dhe e hoqi. Shamata nuk ngjau. Ca ulurima, bërtitje, kërcënime. Ajo u shua fatmirësisht. Psikologji plangëprishëse. Apo sherrgji të lindur. Por toka e zhdukur, frika e forcës gllabëruese të egërsisë së lumit, kishin mbjellur frikë në krahun e majt. Prandaj ato zgjodhen padinë në gjykatë. Të presim përgjigjen.

KËRKESË MËKËMBËSIT TË BASHKISË

Skavatori i ishte afruar shkamit të kuq. Por aty ishte ndalur duke gulçuar një zhurmë shurdhuese. Poshtë saj nëpër shkëmbenj, madhësi ndryshëm, gurgullonte ujët e Murrës. I riu nuk e dinte se çfarë fshihej këtu nën masivin shkëmbor i mbuluar me dhe e gjur.

Kishte ardhur koha që faktet të dilnin në shesh. Se këto do t'iu shëbenin sadopak familjeve që jetonin përreth. Prandaj i prezantova me kujdes mëkëmbësit të bashkisë idetë e mia.

Që hemoragjia e bashkëfshatarëve tonë të filloi të ndalohet na duhet punë. Jo vetëm të prodhojmë grurë, misër, jonxhë por edhe të njohim peizazhet historike. Këto do të afrojnë pranë nesh turistët. Do t'iu mësojmë fëmijëve se kush kemi qenë në udhëtimin e tejzgjatur të shekujve. Kjo, sepse një e dy dhe rinia e ka syrin e mendjen jashtë. Pa ditur se si mund të jetohet këtu buzë brigjeve piktoreske të Murrës e Drinit. Kjo ishte pjesa e parë e bisedës me atë.

Kodra e Shëne Diellit ishte e zhveshur. Ajo ngrihej si një trung koni i prerë në kryqëzimin e dy lumenjve. Por, e zhveshur pjesërisht. Këtu duhen njëqind metra tub dhe të ujitet nëpërmjet një bilbili. Mbi të gjitha tre muajt e verës. E më pas bimësia do të jeshiloi kodrën e shejtë. Një obelisk i vogël me shenjën e diellit, do ta zbukuronte e kthente atë në simbolin e flamurit të krahinës.

Në krahun jugperëndimor një kodër tjetër e veshur. E këtu kanë patur banuar njerëzit e neolitit, në mbi katër mijë vjet më parë banues në kasolle me gardhe e baltë. Këtë e vërteton çekiçi prej guri. Gjetur në vitin 1972.

Në drejtimin perëndimor një rrafshnaltë e mbuluar me fier e rrethuar me një kurorëgjelbërimi të përbërë nga dushqe. Po pikërisht aty kanë jetuar dinastia e mazrekasve. Gjithçka e mbuluar me pluhurin e harresës e shtresëzimet e dherave dhe të kohërave. E neve duhet ti zgjojmë.

Ai skavatori që punon për të mbushur makinat me gur për ndërtime duhet të bëjë dy gërvishtje rrëzë këtij masivi shkëmbi. Dhe do të dalë grykëhyrja e një shpelle me histori të lashte dhe bukuri mahnitëse me qindra stalaktide me nga dy metra gjatësi. Quhet shpella Zgjorgj.

Këtu e mbylla unë bisedën: "Janë margaritarët historiko - gjeografike që me shkëlqimin e tyre ushqejnë të sotmen dhe të ardhmen".

IDEJA E NJË KOMISIONI KONTROLLUES.

Ishte zvarritur mjaft hapja e asaj rruge. Siç thuhet, "veshët na ishin zgjatur sa të magjerit". Emri i saj e fillesa kishin rrënjë të thella. Ndërsa politikanët luanin me fatin e saj e të disa krahinave me tradita bujqësore, ndërtimore, luftarake.

Shpresa ishte venitur. Njerëzit ishin të revoltuar. Por vjen një dite dhe u dha urdhëri i rifillimit. Fshatra të tanë ishin rrudhosur. Disa ishin zhdukur krejtësisht. Vetëm gjurmë shtëpish gjysmë të shembura dukeshin. Por, thuhesh se kjo arterie ishte jetë- dhënse. Njerëzia mund ti kthehej rritjes së domates, grurit, shumimit të deleve, prodhimit të bulmetrave. Shteti e politika ishin kalbëzuar nga brenda. Shkëlqimi ishte i rremë. Edhe atë pjesë rruge të bërë, e kanë bërë gjithë kthesa të panevojshme. Pra, si një gjarpër.

Ishin këto, që gazetari të cilin unë takova një mëngjez ku piva kafenë më propozoi: pse të mos krijojmë një komision me specialistë, profesorë kemi, e të kontrollojmë ecurinë e cilësinë e punimeve. Qe më vonë të mos qahemi e ankohemi. Kjo është t'i dalësh të keqes përpara".

U përtypa pak dhe shpreha mendimin tim. Ashtu është, njeriu duhet t'a shërojë vetë vetëveten, duke e mbajtur pastërtinë, duke u sjellë me kulturë e edukatë me njerëzit. Pra, për të kontrolluar veprimet e të folmen. U ndamë duke u përqafuar e dhënë të drejtë njëri-tjetrit. Më shumë rëndësi ka konkretizimi, mendova unë në ecje e sipër.

HISTORIANI I OBELISKËVE

Trupëshkurtër, me ballin pak të ngritur, me dy sy të zesë që lëviznin gjallnueshëm. I squet sa mban mend shumë, punëtor i qanun, se lexon e shkruan libra. Në një takim, pasi kishte shpëtuar nga një aksident, ai nisi bisedën:

"I shkova në zyrë një ditë kryetarit të bashkisë dhe i thashë për ca fonde për të ngritur disa obelisqe. U përpoqa t'i shpjegoja arsyet. Vendngjarjet ishin të shumta të lyera me gjak, me shpirtin patriotik, me atdhedashurinë. Unë përpiqesha t'i ndaja sipas peshës e forcës së ngjarjeve.

Pasi i shënoi mendimet e mia, më përcolli me plotë buzëqeshje. Prita muaj, por as një përgjigje. Ndërsa mua nuk me flihej. Desha që të realizoi qëllimin tim. Për hir të popullit fshatit krahinës që më lindi. E prandaj i shkova përsëri në zyre. Por kësaj radhe nuk me futi brenda por më tha: Nuk kam asnjë qindarkë, shumë familje nuk kanë bukë thatë, t'iu japim fëmijëve.

E kuptova, ai kishte ndryshuar mendje. U largova me kokë ulur. Nuk vonoi, veçse disa ditë më pas më thirri në zyrë kryetari i prefekturës. Kam gjetur ca fonde, përdori aty ku keni menduar. E lexova letrën e grupit të punës, mund të filloni nga puna. I shtrëngova dorën miqësisht sikur të m'i kishte falur mua.

U ndërtuan obelisqe në formë tre ose katër bedena kalash. Projektuesi dhe ustallarët punuan me kujdese mjeshtërisht. Edhe unë ndiqja punimet nga afër. Pastaj do të vendosnim edhe pllakat me shkrimin përkushtimor. Diçka e re me fytyre heroizmi e tregues historie.

Shpresoi në të ardhmen se do të ngrihen, ndërtohen apo skaliten të reja pllaka e obelisqe. U gëzova se diçka materializova nga ato libra që kisha shkruar.

* * *

Bashkëbisedova me njerëz real, jo shëmbëlltyra të asaj bote që quhet e përtejme. Nuk u vura emra se ato mund t'i takojmë në malësinë e Tropojës, në Dropullin e Gjirokastrës, në Kolonjë e Kaçinar të Mirditës, në Koplik të Shkodrës, apo Shpat të Elbasanit e Dardh të Korçës, kudo nëpër atdheun që përpëlitet për të gjetur pak dritë si udhë shpëtimi për t'iu larguar terrorit psikologjik të djajve të kohës.

Rruga e Arbërit nr. 150
ligjëratë

Ligjëratë e mbajtur në Konferencën Ndërkombëtare Albanologjike kushtuar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut



Àrbëri sipas statuteve që u konfirmuan në epokën e Gjergj Kastriotit

Nga ***prof. dr.*** **Shaban SINANI**

Pse zgjodha të parashtroj disa argumente dhe mendime rreth pyetjes për *Àrbërin në shekujt e humanizmit europian sipas statuteve që u konfirmuan në epokën e Gjergj Kastriotit*?

1. Për statutet dhe rregulloret e ndorimit urban të qyteteve të Arbërit në shekujt e humanizmit europian në vijën bregdetare të viseve shqiptare dhe deri-diku edhe në *hinterland* gjatë dy dekadave të fundme ka pasur disa studime që meritojnë të nderohen, nga dijetarë vendës e të huaj, si Lucia Nadin, Oliver Jens-Schmitt, Gherardo Ortalli, Pëllumb Xhufi, Luan Malltezi, Aurel Plasari, Ardian Klosi, Ismet Elezi, Ermal Baze dhe ndonjë tjetër. Mirëpo kjo trashëgimi, me përjashtime të rralla, *nuk është vështruar në anën e saj antropojuridike e etnojuridike*.

2. Në historiografinë tradicionale shqiptare me të drejtë është propozuar teza se *Arbëri i shekujve paraosmanë zhvillohej me të njëjtat ritme dhe me të njëjtën shkallë si gjithë vendet e pellgut të Adriatikut*. E shqiptuar prej *dekanit të mesjetaristëve shqiptarë* Aleks Buda, kjo tezë lejonte të supozohej se idioma *pellgu i Adriatikut* ishte një metonimi e *kontinentit europian*. Kjo tezë u verifikua përmes të dhënash të tjera, por jo prej rendit juridik që dëshmohet në *corpus iuris statuendi*, në koleksionin e statuteve të qyteteve arbërore, duke iu referuar me këtë term *kodikëve statutorë*, që u përkasin shekujve XIII-XVII.

3. Në traditën e studimeve shqiptare, statutet, rregulloret dhe ligjet e ndërtimit të rendit urban, për një kohë të gjatë kanë qenë një objekt i përjashtuar, për dy arsye kryesore: 1. Për shkak *të një qendrimi thellësisht puritan, deri në kufij përjashtues*, shprehur në mendimin se këto akte janë krejt të huaja për traditën shqiptare, janë rregullore të *të vasalitetit ndaj të Sinjorisë Serenissima*; 2. Për shkak se statutet dhe rregulloret e ndërtimit të jetës qytetare në Arbërin e shekujve të humanizmit janë konsideruar prurje *të një kulture kishtare*. Këto dy arsye shpjegojnë pse në të gjitha historitë e Shqipërisë, prej fillimeve deri më sot, statutet dhe rregulloret, *nuk zënë më shumë se një fletë*. Sa u takon rezultateve të antropologjisë etnojuridike, *statutet kanë qenë dhe mbeten të përjashtuar* edhe për një arsye teknike: *sepse statutet janë kulturë e shkruar kurse e drejta kanunore është e drejtë parashkrimore*.

4. Nuk kanë munguar studimet për shtetin e epokës së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, deri në shkallën e monografive. Mirëpo edhe në këto raste rendi juridik i shtetit të Skënderbeut është gjykuar *përmes kredencialeve të legatëve, aleancave dhe traktateve, akteve të kancelarive, por jo edhe prej statuteve*. Këtu mund të ketë luajtur rol pengues edhe fakti që *statutet ishin dukuri e fasadës bregdetare*, kurse Kastriotët me zotërimet e tyre gjendeshin në thellësi. Mirëpo rendin e organizimit parashtetëror, më shumë se aleancat dhe besëlidhjet, më shumë se traktatet dhe armëpushimet me kushte, e dëshmojnë statutet.

5. Në radhët e dijetarëve europianë që i janë kushtuar asaj trashëgimie që njihet me emrin *studia humanitatis* ka pasur dhe ka një diskutim shkencor me shtrirje në gjithë kontinentin për kufijtë e shtrirjes së frymës së Renesancës, që përbën themelet e europeizmit të sotëm. Ky diskutim është zhvilluar *në formën e dy pyetjeve, me karakter ndërplotësues*: 1. *Cili është kontributi pasurues i popullit pretendues për t'u përfshirë në këtë zonë dhe në këta shekuj të ndriçimit epokal*? 2. *Cila ishte shkalla e rregullimit ligjor të zhvillimit urban në vendin pretendues*? Përgjigjet që i janë dhënë pyetjes së parë kanë pasur prirjen për ta rrudhur Europën e shekujve të humanizmit brenda për brenda Perëndimit të sotëm. Italia i dha Europës pikturën, skulpturën dhe epopenë e famshme *Komedia hyjnore*. Spanja i dhuroi eurokulturës humaniste romanin e parë në histori, *Don Kishotin*. Anglia e pasuroi këtë trashëgimi me tragjeditë moderne të Shekspirit. Bota gjermanike lindi Reformën e Martin Lutherit dhe lindjen e gjuhëve popullore të liturgjisë; Guntenbergun dhe shtypshkrimin. Polakët me të drejtë pretendojnë se i dhanë Europës *atë që ndali diellin dhe lëvizi tokën*, Kopernikun. Lundërtarët e mëdhenj portugezë e spanjollë; zbuluesit e botëve të reja; universitetet franceze dhe vlera të tjera, janë konsideruar *certifikata të vetëmjaftueshme për përfshirjen brenda Renesancës dhe themeleve të eurokulturës*. Me letërsinë e heronjve, që nisi prej Marin Barletit, Arbërit e asaj epoke kërkuan vendin e tyre të merituar, duke shpallur solemnisht se i kishin dhënë kontinentit një kryevlerë që i mungonte: strategun mbrojtës të qytetërimit të vjetër, Gjergj Kastriotin - Skënderbeun. Nëse përgjigjen do ta kërkonim duke iu referuar pyetjes së dytë, në dritë të zbulimeve të fundme dokumentare, përgjigjja do të kishte qenë e papërgënjeshtrueshme: Arbëri i shekujve të Mesjetës ishte një hapësirë historike që e kishte rregulluar jetën e brendshme me statute dhe rregullore, njësoj si e gjithë Europa, dhe ky ishte rendi që kishte prodhuar klima sunduese e Renesancës, e cila, me devizën *të kthehemi tek burimi*, kishte idealizuar modelet antike të qyteteve-republika, me këshilla dhe senat, me *agorà* dhe *foro romanorum*.

6. Çështja më e rëndësishme në pikëpamjen shkencore mbetet ajo që *ka të bëjë me domosdoshmërinë e themelimit të disiplinës së së drejtës së krahasuar*, e cila ende mund të konsiderohet një dije e munguar. Duke qenë se antropologjia etnojuridike për shqiptarët ka qenë një shkencë e lindur prej premisash romantike e kolonialiste, në të shumtën e rasteve me frymëzim ekzotik, prej më se dy shekujsh identiteti i shqiptarëve është promovuar si identitet i një popull kanunor, i vetëqeverisur me ligje të pashkruara. Kjo dhe për faktin se shkenca shqiptare ka mbajtur një qendrim heshtës ndaj së drejtës së shkruar. Dhe këtu nuk është fjala vetëm për *corpus iuris statuendi*, por së paku edhe për dy korpuse të tjerë: 1. *Nomokanonet* e rendit kishtar-laik të arealit që e ndërtonte jetën sipas parimeve dhe rregullave të kishës lindore; 2. *Corporativo corpus iuris*, ose *e drejta e korporatave, e drejta e rüfet-eve, e drejta e esnafeve*, që lulëzoi në shekujt XVII-XVIII, sidomos në Voskopojë, ku kishte jo pak por 14 rregullore të mjeshtërive të qytetit. Këto tri tradita asnjëherë nuk janë vështruar në pikëpamjen krahasuese, megjithëse si statutet, ashtu dhe nomokanonet dhe rregulloret e mjeshtërive kanë prerje të përbashkëta që diktohen jo nga ndonjë doktrinë, por nga shkalla e zhvillimit të njësojtë, duke përfshirë rendin familjar, rendin gjenealogjik, raportin me kishën dhe pushtetet. Disiplina themelore që mungon në albanologjinë e sotme është ajo e së drejtës krahasimtare kanonike kishtare me të drejtën laike, shprehur kjo me shkrim apo në formë parashkrimore.

7. Këtu është rasti të kujtojmë se *corpus iuris statuendi* nuk përmban vetëm *Statutet e Shkodrës* dhe *Statutet e Drishtit*, por dhe *Statutet e Durrësit*, *Statutet e Ulqinit*, *Statutet e Danjës*, *Statutet e Tivarit*, për t'u shtuar këtyre edhe statute të tjera, që i përmendin dijetarë autoritarë, si Alain Ducellier, i cili beson në ekzistencën e *Statuteve të Vlorës*, apo Vikenti Makušev, që është i sigurt për ekzistencën e *Statuteve të Lezhës* që nga viti 1443. Sa i takon një trashëgimie tjetër, që më së shpeshti shfaqet me emrin *corporativo corpus iuris*, por dhe e *drejtë shoqologjike, e drejtë e korporacjoneve*, referuar rendeve të mjeshtërive, të quajtura *fratalia* (rum.), *fraternitas* e *confraternitas* (lat.), studimet janë pak më të plota. Ndërsa *nomokanonet*, gjashtë kodikë që përmbajnë rregullore kishtare të qyteteve të Beratit, Gjirokastrës, Korçës dhe Elbasanit, këto njihen vetëm në shkallën e përshkrimit kodikografik nga Theofan Popa. Këto tri trashëgimi *mbeten ishuj krejtësisht të vetëveçuar për njëri-tjetrin*. Zef Valentini, Injac Zamputi dhe Ilo Mitkë Qafëzezi, që hapën ndonjë dritare që këto korpuse të shiheshin në pasqyrë të njëri-tjetrit, nuk patën pasues.

Statutet, *notariati* dhe *katastikoni* janë dukuri tipike të kalimit prej shkrimit kanonik në atë dëshmues. Për herë të parë statusi i scribe-it ndryshoi nga kopjues në tejshkrues. Kultura e shkrimit njihet si një prej shenjave më të rëndësishme të klimës së Renesancës. Vetëm qyteti i Beratit kishte gjashtë shkolla *ars scribensi* dhe bukurshkrimi. Në Shkodër kishte tri vëllazëri: njëra me emrin e *Shën Barbarës*, tjetra me emrin e *Shën Mërisë* dhe një e tretë me emrin *Kryqi i Shenjtë*. Ndërsa në Drisht kishte dy vëllazëri të tjera. Në vitin 1349, në Ulqin, Tivar, Pult e Shkodër kishte 18 shkrues noterialë shqiptarë, dy të tretat e numrit të përgjithshëm të shkruesve. Durrësi ishte qyteti ku *notariati* njohu lulëzimin e të dy shkollave: në greqisht dhe latinisht.

Faqja perëndimore e gadishullit të Ballkanit kishte arritur pjekurinë e rregullimit të jetës së bashkësive urbane me statutnë gjithë shtrirjen e vet. Statute kishin Kotorri, Budva e Raguza, Zara, Kapodistria, Pirani e Trieste. Të gjithë këto statute, pa përjashtim, janë botuar tashmë në origjinal dhe në përkthim në kroatisht.

Në vijim nuk do të merremi me as me *Statutet e Shkodrës*, as me *Statutet e Drishtit*, përveç rasteve të pashmangshme, duke qenë se tashmë ato përbëjnë të njohurën për studimet shqiptare.

Koleksionit të statuteve të qyteteve të Arbërit në fund të Mesjetës, pjesa më e madhe e të cilëve konfirmuar për herë të fundit gjatë epokës së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, i shtohen:

1. *Statutet e Danjës*, me 597 nene, më shumë se dyfishi i *Statuteve të Shkodrës*. Ky dokument ruhet në *Arkivin e Kroacisë* dhe konsiderohet statuti më analitik i epokës së Rilindjes Europiane për hapësirën historike shqiptare. Gjenden në koleksionet e dokumenteve që kishte përzgjedhur Milan Šufflay në funksion të hartimit të një historie të Shqipërisë. Këto statute janë konfirmuar në vitin 1319 dhe më pas janë redaktuar, amenduar e rikonfirmuar disa herë, duke përfshirë epokën e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Tri fletë nga ky kodik statutor i janë dhuruar Arkivit Qendror Shtetëror në vitin 2002.

2. *Statutet e Tivarit* (*statuta et leges Antibarensis*), të cilët janë rindërtuar mbi bazën e sistemit të referimit në vendimmarrjet gjyqësore prej studiuesve të mirënjohur kroatë Lovorka Čoralić dhe Savo Marković gjatë tri dekadave të fundme. Ekzistenca e këtyre statuteve është përmendur për herë të parë në vitin 1929, në një botim enciklopedik italian. Mbështetur në aktet e notariatit, në përshkrimet katastike dhe sidomos në regestët e dhënies së të drejtës, mund të konsiderohet se, prej të dhënash të tërthorta, këto statute tashmë janë bërë të njohur.

3. Nga dorëshkrimi i *Statuteve të Ulqinit* (*Statuta et leges Dulcinji*) ekzistojnë dy fletë, që janë të ekspozuara pa ndonjë përshkrim dhe pa datifikim në Muzeun *Gjergj Kastrioti* të Krujës. Edhe këto statute janë bërë të njohur gjerësisht prej dy studiuesve kroatë, sidomos nga Lovorka Čoralić, me të njëjtën metodë restaurimi. *Statutet e Ulqinit* përmenden gjithashtu që nga viti 1907, në të njëjtin katalog të italianit Leone Fontana, që u shërbeu si udhërrëfyes zbuluesve të *Statuteve të Shkodrës* me përshkrimet e veta.

4. Për *Statutet e Durrësit* njoftimet më të hershme janë shërbyer nga Konstantin Jireček. Në një studim të pabotuar, kopja e të cilit gjendet në Arkivin Qendror Shtetëror, Milan Šufflay, në studimin e tij *Statuta, episcopis et civitas Durazzo*, që ruhet në dorëshkrim në Zagreb, duhet të ketë të dhëna shtesë për këto statute. Sipas Alain Ducellier-së, Durrësi *ishte qeverisur me statutet e veta* së paku që nga viti 1272. Të dhëna të tërthorta dhe jo fort të verifikueshme lejojnë të mendohet se statute duhet të kenë pasur edhe Lezha, Kruja, Shasi dhe Vlora.

Me shumë rëndësi janë disa burime arkivistike që njoftojnë për statute dhe rregullore që morën me vete arbëreshët në Itali. Këto statute ata i përdorën si referenca e mbështetje ligjore për të stabilizuar gjendjen e tyre në mjedisin e ri. I pari që ka njoftuar për marrëveshje midis vendësve dhe të ardhurve mbi bazën e statuteve që kishin trashëguar këta të fundit është italiani Giuseppe la Mantia, i cili, në veprën e tij *I capitoli delle colonie greco-albanesi di Sicilia dei secoli XV e XVI*, qysh më 1904 përmend marrëveshjet e domestikimit të arbëreshëve, në të cilat u përfillën edhe statutet që ata kishin marrë me vete. Një tjetër dokument, që njihet me emrin *Codice capitulazioni Frassinetto*, në të cilin bëhet fjalë për rregullimin e statusit të arbëreshëve të Frasnitës sipas kapitujve dhe rregulloreve të pranuara, nënshkruar më 1440, e kemi botuar dhjetë vjet më parë.

Duke iu përmbajtur asaj që quhet *ius cesarianis*, duhet pohuar se interesimi për statutet dhe rregulloret e qyteteve arbëre të shekujve të Mesjetës kronologjikisht ka lindur prej dijetarësh italianë, para më se një shekulli. Katalogu *Bibliografia degli statuti dei comuni dell'Italia superiore*, vëllimi III (1907) mbetet gjithnjë një burim i rëndësisë parësore. Në një fazë të mëvonshme, koleksionimi, botimi dhe studimi i statuteve të qyteteve mesjetare shqiptare i takon në mënyrë sovrane albanologut kroat Milan Šufflay dhe

Duke qenë se antropologjia etnojuridike për shqiptarët ka qenë një shkencë e lindur prej premisash romantike e kolonialiste, në të shumtën e rasteve me frymëzim ekzotik, prej më se dy shekujsh identiteti i shqiptarëve është promovuar si identitet i një populli kanunor, i vetëqeverisur me ligje të pashkruara. Kjo dhe për faktin se shkenca shqiptare ka mbajtur një qëndrim heshtës ndaj së drejtës së shkruar.

bashkëpunëtorit të tij Viktor Novak, të cilët botuan për herë të parë *Statuta et ordinationes ecclesiae civitas Drivasti* në vitin 1927, në *Arhiv za arbansku starinu, jezik i etnologiju* (Beograd 1927). Si koleksionues e studiues i statuteve të qyteteve shqiptare Milan Šufflay nuk ka të dytë.

Duke qenë se statutet dhe rregulloret e kishës së qytetit të Drishtit janë botuar e ribotuar disa herë, duke përfshirë atë të Prishtinës, në periodikun *Gjurmime albanologjike* më 1971 (1972), më pas edhe nga medioevisti Luan Malltezi dhe së fundmi të tejshkruara e të përkthyera nga Etleva Lala e Musa Ahmeti, nuk do të ndalem në përmbajtjen e tyre, por është me dobi të sillet në kujtesë historia gati e pabesueshme se si Šufflay arriti të sigurojë kopjen e dorëshkrimit.

Ky dorëshkrim për herë të parë përmendet në *Katalogun 438* dhe më pas në *Katalogun 477* të bukinistit gjerman Karl Wilhelm Hiersemann, në qershor të vitit 1915. Hiersemann e pati nxjerrë në ankand, por dorëshkrimi nuk u shit. Milan Šufflay, i njoftuar për vendndodhjen dhe përmbajtjen e dorëshkrimit nga Ivan Bojničić në vitin 1916, nuk kishte mundësi ta blinte vetë dorëshkrimin, për shkak të çmimit shumë të lartë që kishte caktuar pronari për fillimin e ankandit. Prandaj iu drejtua për ndihmë një pasaniku kroat, duke i bërë thirrje që *ta blinte për Bibliotekën Universitare të Zagrebit*. Të njëjtën lutje për ndihmë ai ia pati drejtuar albanologut të mirënjohur Holger Pedersen. Meqë kjo thirrje e tij nuk pati përgjigje, Šufflay provoi sërish ta shtinte në dorë përmes mikut të tij L. Thalòczy, duke i rekomanduar që ta blinte për llogari të *Akademia Vindobonensis*, por pa sukses. Në të njëjtën kohë ai i ishte drejtuar për ndihmë edhe Akademisë Serbe të Shkencave. Në vitin 1920 Šufflay u njoftua se dorëshkrimi tashmë ishte shitur, me një çmim marramendës jo vetëm për atë kohë: 2000 marka! Ai u shqetësua shumë nga kjo blerje, sidomos ngaqë emri i blerësit nuk ishte bërë i njohur. M. Šufflay, megjithatë, nuk u dorëzua. Përmes mikut të tij albanolog Henri Barić, në vitin 1924, ai arriti të identifikojë emrin e blerësit, danezit Sir Thomas Philipps. Në bashkëpunim me këtë albanolog dhe me mikun tjetër të tij Victor Novak, Šufflay i drejtohet sërish me një lutje albanologut danez H. Pedersen që të ndërmjetësonte tek Sir Thomas Phillipps për të siguruar një kopje të fotografuar të dorëshkrimit. Në vitin 1925, kur arriti të kishte një kopje të dorëshkrimit, së bashku me V. Novak-un, në një kohë rekord, ai përgatiti botimin e njohur të vitit 1927, në *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju*.

Historia e stabilizimit të *Statuta et ordinations ecclesiae civitas Drivasti* është e njohur. Këtu do të përmendim vetëm një fakt. Për redaktimin e fundmë ishte Papa Piu II ai që u dha përgjigje pozitive autoriteteve të katedrales së Drishtit për të validuar juridikisht statutet. Më 1463, sikurse na dëshmohet nga të dhënat e botimit *Hierarchia catholica*, Papa kishte ngarkuar pikërisht Pal Engjëllin dhe një ndihmës të tij për të vërtetuar nëse reformimi i statuteve të mëparshëm të Drishtit ishte i nevojshëm. Njohja zyrtare e vlefshmërisë juridike të tyre, në trajtën e reformuar, u bë më 21 nëntor 1464, në një manastir benediktin, me praninë e Pal Engjëllit, të kryegjakonit të Shkodrës Manuel, të fisnikut Gjergj Topia dhe të bujarëve e klerikëve të tjerë të krahinës.

Për herë të parë ekzistenca e disa fragmenteve të *Statuteve të Durrësit* përmendet sërish nga Milan Sufflay dhe dy bashkëpunëtorët e tij C. Jireček e Lajos Thalóczi, në veprën e tyre të përbashkët *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*. Të dhënat e këtyre autorëve mbeten të vetmet njoftime që përsëriten në tekstet e historisë së Shqipërisë. Për këto statute dhe historinë e ruajtjes së tyre në vitet 1930 pati shkruar me fjalë të kursyera Marin Sirdani.

A ishin Statutet e Durrësit, Shkodrës, Drishtit, Danjës, Tivarit, Ulqinit, Kotorrit dhe të tjera statute ende të paidentifikuar, si ato të Vlorës, Lezhës dhe Krujës, kopjime të Statuteve të Venedikut?

Disa mendime të shprehura, që statutet janë kulturë e huaj dhe nuk kanë të bëjnë me traditën shqiptare njësoj si kanunet nuk i qendrojnë arsyetimit, për shkakun e thjeshtë se vetë autoritetet e republikës së Shën Markut, siç dëshmohet katërcipërisht në dokumentacionin e kohës, u bëjnë të ditur misionarëve të vet, legatëve, tregtarëve, se në qytetet shqiptare ka statute, por ato *nuk janë si tonat*, sepse mbështeten në *loro usanze*. Mendimi se *Kanuni i Lekë Dukagjinit* nuk është vetëm *tërësia e normave të së drejtës zakonore*, por vepër që përmban *palcën etnike të kombit shqiptar dhe të kulturës së tij*; ka vend për t'u diskutuar. Ka qenë Àt Gjergj Fishta i pari që, në *Parathânjen* e *Kanunit të Lekë Dukagjinit*, ka pohuar karakterin aristokratik dhe qytetar *të ligjëve të vjetra, të quejtuna statute*, duke iu referuar *Statuteve të Drishtit*, që sapo i kishin botuar Šufflay dhe Novak.

Sa i takon dallimit midis karakterit aristokratik të statuteve dhe karakterit patriarkal-fisnor të kanuneve, mjafton një prej neneve më të cituar të *Kanunit të Lekë Dukagjinit*: *Çmimi i jetës së nierit asht nji, si për të mirin si për të keqin. Sejcilli mbahet i mirë dhe i thotë vedit: "Jam burrë" e i thonë: "A je burrë ... Prandej gjaqet i la Leka si njanja: del i miri prej të keqit e i keqi prej të mirit. Shpirt për shpirt, se dukën e falë Zoti*. Ky nen është gozhda e fundme mbi arkëmortin e aristokracisë së vjetër. Një aristokraci e re, e mbështetur mbi titulaturën ushtarake të ish-perandorisë otomane, me bazë meritën e shpatës dhe të shërbimit, do t'ua zinte vendin familjeve të mëdha patronimike të dikurshme, me tituj europianë: *capitaneus, kont, dukë* etj. Për të përmbyllur krahasimin midis statuteve dhe kanuneve, së drejtës urbane dhe së drejtës së maleve, së drejtës së shkruar dhe së drejtës së pashkruar, po citojmë në vijim në mënyrë paralele vetëm statusin e gruas në familje:

Gruaja në *Statutet* e *Shkodrës*:

Neni 166: *Gjithçka që fitojnë burrë e grua së bashku konsiderohet e barabartë, domethënë gjysma i takon burrit e gjysma gruas*;

Neni 186: *Vajza dhe femra në përgjithësi ka të drejtë të lëshojë testament, duke filluar nga 12 vjeç e lart*;

Neni 196: *Gruaja që ka fëmijë ka të drejtë të bëjë testament dhe të heqë mënjanë për lutje të shpirtit të saj një të pestën e prikës, nëse këtë prikë nuk ia ka kaluar ndërkohë vajzës së saj. Përndryshe, të caktojë për përshpirtjen e vet pjesën që ka mbetur pasi u ka shpërndarë djemve pjesën e tyre*.

Gruaja në *Kanunin* e *Lekë Dukagjinit*:

Nyje 20, kreu III: *Grueja shqyptare farë trashigimit s'ka te prindja, as në plang as në shpi. Kanuja e xen gruen si nji tepricë në shpi. Prindja s'mendon për pajë as për kurrnji send për vajzë të vet: ai qi e xen do t'i-a bajë kujdesin*.

Skicë

S tatuja e bardhe

Nga Viron Kona

"Lirinë nuk ua solla unë,
por e gjeta në mesin tuaj."
Gjergj Kastrioti Skënderbeu



Per Kettisen, drejtor i shkollës "Fjardingskolan" të qytetit të Borasit, Suedi dhe statuja e Skënderbeut pranë tij.

Në maj të vitit 2011, ndodhesha i ftuar në qytetin Boras të Suedisë, në një ceremoni përuruese të libri tim për fëmijë "Eh, more Bubulino!" (Men *kära* Bubulino!) të përkthyer në gjuhën suedeze. Në kujdesin e poetit, gazetarit dhe përkthyesit të njohur Sokol Demaku dhe të drejtorit të shkollës "Fjardingskolan" Per Kettisen, u zhvilluan disa takime dhe veprimtari emocionuese, veçanërisht në shkolla të cikleve të ndryshme me mësues, me lexues të vegjël e të rinj, me prindër dhe intelektualë, të cilat i ruaj në kujtesë si gjëra të shtrenjta e, mes tyre, edhe këtë emocion, që e përjetova dhe që erdhi rasti për ta rrëfyer:

Në shkollën 6-vjeçare "Fjardingskolan", pas prezantimit që iu bë librit të përkthyer, lexuesit e vegjël, krahas ngjarjeve dhe personazheve të librit, nisën të më bënin pyetje edhe për atdheun tim, Shqipërinë, por donin të dinin edhe për ndonjë hero dhe histori të tij. Natyrshëm, nisa të flasë për Gjergj Kastriotin Skënderbeun. Ata po më dëgjonin me vëmendje e kureshtje, por dhe duke përfytyruar me fantazinë e tyre fëmijërore sesi pushtuesit turq e kishin marrë peng Gjergjin e vogël dhe vëllezërit e tij, duke i shkëputur dhunshëm nga prindërit, pastaj, sesi Gjergjin e kishin futur në shkollat ushtarake osmane, ku ai ishte dalluar dhe, me kohë, kishte treguar zotësi të shkëlqyera, ndërkohë që atdheun nuk e kishte harruar por e mbante gjithnjë në zemër...Më tej nisa t`u tregojë për kthimin e Gjergj Kastriotit në atdhe, organizimin dhe udhëheqjen nga ana e tij të luftërave të popullit shqiptar për liri...

Sapo mbarova, njëri nga fëmijët shqiptarë të Kosovës, kërkoi lejë dhe tha:

-Unë di një vjershë për Skënderbeun, ta recitoj?

-Po, do ta dëgjojmë me kënaqësi, - i thashë.

Me çiltërsinë e moshës, ai nisi të recitojë vargjet e njohur të Naim Frashërit:

"Kruj`, o qytet i bekuar!/Prite, prite Skënderbenë,/Po vjen si pëllump i shkruar, / Të shpëtonjë mëmëdhenë...."

Fëmijët duartrokitën recitimin e shokut dhe atmosfera në sallë u gjallërua më shumë. Kërkoi të fliste një fëmijë suedez. Ai tha:

-Unë e kam parë statujën e Skënderbeut, me shpatë dhe me kalë...

-Ashtu, po ku e ke parë? - pyeta me kureshtje dhe ndjeva gjakun të më vërshonte.

-E kam parë në zyrën e drejtorit të shkollës.[1)]

-E kam parë edhe unë, edhe unë..., - thanë disa nxënës të tjerë.

-Po më gëzoni shumë me këto fjalë, - u thashë dhe u ktheva me shikim pyetës nga drejtori Per Kettisen dhe nga miku im Sokol Demaku, që më shoqëronin në atë takim.

-Po, në përfundim, mund ta shohim statujën, - tha drejtori me dashamirësi.

Pasi mbaruam bisedën, u shpërndava lexuesve të vegjël libra me autograf, ndërkohë që dola edhe në fotografi me ta, edhe veç e veç, edhe në grup. Ishin fëmijë me origjinë nga shumë vende të botës. Drejtori më kishte thënë se aty fliteshin rreth 32 gjuhë të huaja dhe të gjithë ata fëmijë, krahas gjuhës suedeze, mësonin me shkrim e lexim edhe gjuhën e vendit nga vinin...

U ndava me lexuesit e mi të vegjël dhe pas pak çastesh u ndodha në zyrën e drejtorit. Sytë më shkuan menjëherë te statuja e Gjergj Kastriotit, që ndodhej në tavolinë, në krah të kompjuterit, ashtu siç ma kishin përshkruar nxënësit në takim. Një statujë, e tëra e bardhë, tërheqëse dhe e bukur, madje, teksa e shihja në atë zyrë plot dritë dhe aq larg vendit tim, ajo statujë e vogël, m`u duk nga më të bukura që kisha parë ndonjëherë për Skënderbeun.

-Po si ndodhet tek ju kjo statujë? - e pyeta drejtorin.

Ai bëri buzën në gaz.

-Ka disa vjet që e kam në zyrë, që kur në shkollën tonë erdhën një grup mësuesish nga shkolla "Demokracia" e qytetit të Durrësit. Kemi krijuar një binjakëzim me atë shkollë dhe, që nga viti 2007, vemi dhe vijmë te njëri-tjetri, këmbejmë përvoja, bëjmë vizita të ndërsjella... Kur ata erdhën për herë të parë, sollën libra për rreth 60 fëmijët shqiptarë, që janë nxënës këtu, por edhe për bibliotekën e shkollës sonë. Sollën edhe këtë statujë. Unë deri atëherë nuk kisha njohje për figurën e Skënderbeut, por, shpejt mësova për jetën dhe historinë e Tij dhe vendosa ta mbaj këtu statujën.

Janë të shumtë ata që vijnë në zyrën time dhe bëhen kureshtarë e më pyesin se çfarë përfaqëson ky luftëtar me shpatë dhe me kalë? Me shumë dëshirë u tregoj se kush është Skënderbeu, u flas për veprën e tij të madhe heroike për çlirimin e Shqipërisë, por dhe për mbrojtjen e Europës nga pushtimi osman... Kam vënë re veçanërisht gëzimin e prindërve të nxënësve nga Kosova e Shqipëria, por dhe të vetë nxënësve kur shohin në zyrën time këtë statujë. Gjatë kohës që ndodhen këtu, ata thuajse nuk e heqin vështrimin prej saj, fëmijët e prekin lehtë me duart e tyre të vogla dhe e ledhatojnë. Pastaj më shprehin dëshirën të dalin në fotografi, kërkojnë që të dalë dhe unë bashkë me ta, duke mbajtur statujën sa më pranë. Ato çaste shoh gëzim dhe krenari në sytë e tyre, duket sikur duan të më thonë: "E shikon, ky është heroi ynë...!"

E dëgjoja drejtorin Per Kettisen dhe një lëmsh emocioni më ishte mbledhur në grykë. S`mund të flisja, s`mund të thosha asgjë, veçse ndjeja se si vërshonin brenda meje ndjenja të bukura dashurie dhe krenarie për atdheun tim. E kisha atdheun fare pranë, i dëgjoja rrahjet e zemrës, frymëmarrjen, përfytyroja bukuritë magjepse të natyrës dhe ngrohtësinë e njerëzve; ndjeja erërat e freskëta të pranverës që rrëshqisnin mbi kështjellat dhe sheshet e betejave, mbi faqet e maleve, liqenet dhe fushat me lulëkuqe dhe me grurë; më bëhej se përpara meje lartësohej shtiza dhe flamuri me shqipen dykrenore, që valëvitej lirshëm në qiellin e kaltër... Ajo statujë e bardhë e Gjergj Kastriotit, Skënderbeut, si me magji ma solli Shqipërinë fare pranë, ndonëse ndodhesha mijëra e mijëra kilometra larg, në Veriun e ftohtë të Europës, por mes suedezëve të mirë, të ditur dhe me zemra të ngrohta valë...

---

1). Për këtë fakt ka shkruar ish drejtori i shkollës "Demokracia" të Durrësit Abdyl Buçpapaj; gazetari, poeti dhe përkthyesi i njohur Sokol Demaku, që aktualisht është mësues në shkollën "Fjardingskolan", iniciator i krijimit të Shoqatës Kulturore Shqiptare "Migjeni" të qytetit suedez të *Borasit, botues i revistës "Dituria, si dhe drejtues i radios dhe televizionit "Dituria"* të atij qyteti.

Kanë shkruar edhe të tjerë...

**Siç dihet, Gjergj Kastrioti Skënderbeu është i njohur në vende të ndryshme të botës. Krahas qindra librave të shkruar, pikturave, afreskeve, kompozimeve muzikore etj, shumë sheshe qytetesh e kryeqytetesh të botës mbajnë emrin e Tij, kurse në mjedise të veçanta ndodhen buste dhe shtatore, numri i të cilave vjen duke u shtuar...*

Rruga e Arbërit nr. 150


BOTIMET M&B


Na vizitoni në Panairin e Librit në Pallatin e Kongreseve nga data 14-20 Nëntor 2018








































































Më shumë botime me çmime të ulura nga 20-30%

Skënderbeu i parë nga Haki Stërmilli

Të gjithë historianët, bashkë me Fan Nolin janë gabue dhe s'kanë dijtë se ku gjendet katundi Kastriot ku e ka origjinë fisi i tij.

Është viti i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, deklaruar solemnisht në mbledhje qeverie e në tubime të mëdha e të vogla. Më se gjysma e vitit kaloi, Kaloi në heshtje, kaloi me zë "të ngjirur" në janar 2018, në 550 vjetorin e ikjes duke lënë pas një histori për të cilën krenohet çdo shqiptar.

Kaloi edhe ditëlindja e tij, 6 maji, ditë dhe datë që në truallin e të parëve të tij është shndërruar në një festë të madhe.

Kërkova në një shkrim që Skënderbeu të vinte me një shesh dhe monument në Athinë ashtu siç është në sheshe në Itali, Francë, Amerikë... Shoqatat që duhet të ngrinin zërin, të hapnin biseda me autoritetet, për pak më linçuan.

E dërgova në portalin "Shqipëria që duam". Mora heshtjen.

Kam në dorë një "libër", dispensë prej 150 faqesh, përcjellë në disa dhjetëra kopje nga Hajri Hoxha, ish drejtor i përgjithshëm i Kombinatit Poligrafik në Tiranë.

Librin "Dibra në prak të historisë"...

Koha e dorëshkrimit shënon vitin 1940.

Nuk u botua kurrë.

As në atë kohë.

As në këtë kohë.

Autori HakiStërmilli (1895-1953) dëshmitar i tre luftërave të mëdha historike për ekzistencën e kombit shqiptar(Kundër pushtimit osman, serb e nazifasht) është lënë në harresë, ndonëse kërkimet e tij në terren, në udhëtime në këmbë Dibrës, mbarë janë një thesar, një referim me vlerë të madhe.

"Dibra, në kohën e Skënderbeut, përmendet mjaft në histori... Shumica e luftërave, thotë shkrimtari HakiStërmilli, kundër invadorëve turq, u zhvilluan në qarkun e Dibrës... Dibranët muerën pjesë në të gjitha luftat që u banë asokohe për të mbrojt lirinë e Atdheut. Prandaj më duket e tepërt me i përsëritë këtu.

Po mjaftoj vetëm me i shënue datat e tyne; Çlirimi i qarkut të Dibrës dhe i Sfetigradit më 1443, lufta e Torviollit më 1444, beteja e Mokrenës më 1445, luftaeOtonetës më 1446, beteja e Uronikut më 1448, rrethimi i Sfetigraditmë 1449, beteja e Modrisës dhe e Meçadit më 1452, lufta e Mokrenës më 1459.... (Dibra në prak të historisë, dorëshkrim 1940 f. 6)

Po kush është Gjergj Kastrioti?


"Mbi origjinën e fisit të Skënderbeut, shkruan Stërmilli, flet vetë fjala "Kastriot" që asht emni i familjes së tij. Të gjithë historianët, bashkë me Fan Nolin,, janë gabue dhe s'kanë dijtë se ku gjendet katundi Kastriot ku e ka origjinë fisi i tij.

Ky katund asht në Dibër të Vogël, nja 8 kilometra në veri të Peshkopisë. Në verilindje të Katundit, mbas nji kodrine asht kisha dhe afër saj gjendet "Pusi i Gjonit" dhe "Kopshti i Gjonit".

Sod Kastrioti s'ka veçse nja 20 shtëpi dhe asht ndërtue mbi një kodrinë. Në këtë kodrinë sipas gojëdhanës, paska qenë fortesa, kurse qyteti shtrihesh deri në Dritue përfshi katundet e sotshëm Kukaj, Brest i Epër dhe Brest i Poshtëm. Afër Brestit të Poshtëm paska qenë tregu, i cili paska qenë i famshëm për rrobaqepsat e shumtë dhe për këtë shkak lisi i madh që asht edhe sot, quhet "Lisi i Terzishtës".

Në katundin e vogël "Shëngjergj" që asht në veri të internatit të Kastriotit, thotë populli ka qenë një "Tempull i Kastriotit". E Kastrioti dikur qytet i madh prej 8000 (tetëmijë)shtëpijash qenka rrënue e zvogëlue nga luftat e rrepta që u zhvilluan midis Shqipnisë e Turqis dhe tash s'kanë mbete tjetër veçse shenjat e themeleve. Populli herë pas here gjen tulla, tjegulla e tjera që dëshmojnë mbi të.

Tue lanë me nji anë gojëdhënën na duhet të vëmë në dukë se origjina e familjes "Kastrioti" rrjedh nga katundi Kastriot i Dibrës. Kjo e vërtetë provohet nga fakti se:



1) N'asndonji vend tjetër të Shqipnisë nuk ka ndonji katund që të ketë emrin "Kastriot".

2) Gjyshi i Skënder Beut, Pal Kastrioti,kishte nën zotnimin e vet katundet Sinë e Gardh i Poshtëm. Sina gjendet në të majtë të Drinit të Zi, rranxë bjeshkës që mban emrin Pllajë. Sina ndahet në dy lagje; Sina e Epër dhe Sina e Poshtme. Këtu asht edhe Gardhi. Kujtojmë se ky katund do të jetë Gardhi i Muhurrit. Kuptohet vetiut pra se gjyshi i Skënder Beut nuk mund të kishte në zotnim katunde që s'ishin afër Kastriotit. E Sina e Gardhi janë afër Kastriotit.

3) Tashmë asht fakt historik se kur ukthye Skënder Beu n'Atdhe, erdh në Dibër dhe, pa u nis për Krue deshi të provonte besnikninë e Dibranëve. Gëzimi i Dibranëve kur e panë princin e tyre, thonë historianët qe jashtëzakonisht i madh dhe jo vetëm që i dhanë besën se kanë me sakrifikuegjithshka për çështjen e shenjtë, por e përcuellën në Krujë me300 vetë që kërkoi.

4) Dibra, sikur vërtetohet nga dokumente të ndryshme, ka qenë principata e Kastriotëve dhe Dibranët subjektet ma besnikë dhe ushtarët efektivë të familjes Kastrioti.

5) Gojëdhana mbi Derën e Kastriotit e sidomos mbi Skënder Beun, asht aq e pasun në Dibër sa n'asndonjë krahinë tjetër...

* * *

Tri dekada pas dorëshkrimit të lënë në heshtje të HakiStërmillit, dy studjues dibranë të historisë e të vlerave të trevës së Dibrës, HazisNdreu dhe AliHoxha në shkrimin botuar në gazetën "Mësuesi": "Toponimia në ndihmë të Kastriotëve", duke shkelur në të njëjtat rrugë që kishte shkelur HakiStërmilli, dokumentuan se Gjergji i Gjon Dibranit nuk i kishte rrënjët as nga Hasi, as nga Mati apo Kruja por nga Dibra.

Atyre rrugëve do të udhëtonte edhe historiani i njohur KristoFrashëri duke shkelur, parë me sy e dëgjuar me veshë vendet që përkonin me njoftimet e Barletit dhe të tjerëve, toponime që i dhanë emër vendlindjes së Kastriotit të Madh, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu...

Në vijim do të përcjellim "Gojëdhënat popullore për vende të Dibrës që lidhen në një nyje të fortë me rrënjët e Kastriotëve si dhe një shikim mbi romanin e vetëm kalorësiak, skenar i gatshëm për një film hollivudian, "Kalorësi i Skënderbeut"...

ABDURAHIM ASHIKU

SKICË

Letër vëllait për datëlindje

Jam i ulur në zyrë, në këtë hapsirë që të çon në mendje së pari vetëm luksin, me gjithatë po të testosh vërtetësitë nuk të cojnë kund, edhe kjo si shumë të tjera ka lukset dhe vështirësitë veta. Sigurisht unë nuk jam në një furrë që piqem dhe kulloj djersë, as nuk rri në këmbë 13-14 orë. Jam pra në këtë hapsirë, që më krijon së pari luksin për të shkruar, anipse sipas meje shkrimi është nevojë, kështu që le të themi se i kam të dy këto komponentë dhe po i përdor ashtu siç dua.

Krrakëllijnë gishtat e mi mbi tastierë, ndërkohë që në një skaj të Dublinit, krrakëllijnë gishtat e tu në lopata furrash tek fusin e nxjerrin pica. Sa për picat, prej kur ti u bëre picier, kam filluar t'i dua dhe t'i konsmuoj, si me thënë më nxjerrin njëfar malli.

Fillimisht mendova të të shkruaj një letër për ditëlindje, por se di pse përfundova në këtë far prologu. Megjithatë këto janë anët mistike të proçesit të shkrimit, dhe unë i pranoj për aq kohë sa nuk na prishin kurrfar pune. Prandaj në mungesë herë të kohës, herë të vëmendjes, herë të qetësisë, dhe komplet panatyrshmërisë që më del në procese komunikimi të drejtëpërdrejta, pra për të shmangur ato që ne zanatçinjtë e komunikimit i quajmë "Zhurma", zgjodha bash këtë mënyrë të vjetër dhe të ëmbël komunikimi: letrën- për të të uruar vite dhe jetë të mbushur me ngjarje.

Të tjerët të kanë uruaj një javë para, sepse si kudo, rrjeti social i futi hundët edhe tek ditëlindjet dhe jua shtoi mediokritetin të gjitha gjërave.

E di fare mirë, ndoshta sepse jam ndër të rrallët që e kam menduar së këto pesë vite larg nesh për ty kanë qenë pa ngjarje. E them këtë për dy arsye:

1- Sepse në këto pesë vjet, jeta ime ka qenë plot ngjarje, veç mendo pak se isha në fshat, dhe sot jam në një zyrë. Këtu sigurisht ka plot ngjarje ku në to ke qenë jo rrallë herë ti, shkaku dhe nxitja, dhe,

2- Shumë njerë kanë lindur, si shumë kanë vdekur, dhe për ty kanë kaluar si lajme, asi që ndodhin rëndom kudo.

Kur shoh jetën time me ngjarje dhe tënden pa ngjarje, ndjehem me të drejtë ose jo, shumë në faj. Prandaj të uroj pafund një jetë me ngjarje, sepse kështu jeta merr kuptim, me lotë, gëzim, zhgënjim, e me tërësej çka ndjen njeriu.

Tash hedh rrotull sytë dhe shoh çka më rrethon, dhe më duket shpesh sikur të kam marrë vendin, sepse duhej të kujdesesha unë për ty e jo ti për mua. I madhi duhet të kujdeset për të voglin dhe jo anasjelltas, por edhe këtu e gjej ngushëllimin: kështu qe shkruar. Ti e doje shkollën madje shumë më fort se unë, por më shumë se shkollën deshte familjen, prandaj more peshën mbi shpatulla dhe shkove gjetkë: pikërisht për të përmirësuar gjërat. Sigurisht që ia dole dhe për këtë duhet të jesh krenar deri sa të kesh jetën.

Tashti që të jem i sinqertë, ideja për të shkruar një letër më erdh kur lexova, "Letër vëllait", nga poeti polak Çezllav Millosh, edhe ata kishin një histori ndarjeje, por jo dashurinë. Atë e kishin hekur. Dhe direkt, mora vetë pozicionin e Çezllavit.

* * *

Zyrën e lash që ndrekë, dhe jam mu në mes të fshatit ku ne lindëm dhe kaluam bashkë 18 vjet. Nuk mu ndave asnjë ditë nëpër këto rrugica me gurë që ka gjasa të më rrëshqasin këmbët e ta lënë kë shkrim në mes. Rrekem të shoh nëpër rrugë ndonjë nga shokët e tu, por më kot, të gjithë kanë ikur, dhe këtë fshat e mbështjell zymtësia. Kështuqë hajt të ngushëllohemi të dy për mos prezencën tënde. T'i s'do kishe asnjë shok këtu, edhe po të vije nuk do e shtyje dot javën. Nuk është më si përpara, gjithçka po vjen e zbrazet, dhe pas disa kohësh nuk do ketë më asgjë, sepse ja, si unë dhe ti, askush nuk kthehet më. Madje edhe disa plepa pas shtëpisë tonë nuk qenkat, as ca pemë lajthie. Nuk janë as gjyshërit, as njerzillëku: kanë mbetur tashmë vetëm melankolia dhe kujtimet të cilat i ndjellim ne që vijmë.

E di që do thash se po ia fus kot, madje do thuash që t'i fjalën e ke zanat dhe di ta sistemosh, por përtej çdo poetike a estetike, kjo është e vërteta. Këtu gjërat vetëm ikin, siç po ikën kjo gjethja e zverdhur e manit mbi kanalin që kalon pas shtëpisë tonë.

Ynë atë ka rritur një këlysh. Kur isha herën e kaluar sapo kishte çelë sytë, i butë, i ëmbël, ndërsa kësaj herë qenka rritur, dhe më çirret e mi nxjerr çatajtë herë më sheh. E mua më bëhet sikur më thot:

-Ik tutje o i huaj!

Pasha Zotin, ma jep në tru ti fus një shqelm e ti them, ik se i huaj je ti. Pastaj ndalem dhe i them vetes:

-Mos vallë u bëmë të huaj për vendin ku lindëm.

Jo. Nuk jemi, as nuk duhet të jemi, deri atëherë që toka dhe qielli të bëhen një.

Prandaj uroj që datëlindjet tjera t'i festojmë mu këtu, në këtë hije qershie ku u rritëm, duke u kaçavjerrë e çjerrë nëpër dega.

ALBAN TUFA



Të lartësojmë çdo ndjenjë pozitive për moshën e tretë!

I shoh çdo ditë, të lodhur, të rrudhur, të kërrusur nga mosha dhe hallet e jetës! Dikush edhe i qeshur dhe i fortë, dikush duke çaluar a duke kollitur! Janë prindërit tanë, ata që u robtuan një jetë të tërë duke punuar, duke na rritur, duke na edukuar e mësuar për jetën. I shoh çdo ditë stolave ulur, kafeneve, trotuareve, lulishteve dhe mendoj se dikur dhe ata patën një rini, një rini të tyren herë me re, herë me shi, herë me dimër e herë me pranverë e tani në perëndim të stinëve të jetës them se meritojnë diçka që ëndërruan; lumturinë që të jep produkti që ata ndërtuan!

Janë kohëra të vështira, kohëra të turbullta politike, ekonomike, financiare, sociale, ama në çdo kohë sado të zymtë të ketë qenë shqiptari, ka ditur të pasqyrojë sensibilitetet pozitive të shpirtit të tij human! E kështu, me sytë e mendjes shikoj të respektuarën moshë të tretë të jetë më pranë nesh, falë dashurisë dhe respektit tonë, përkthyer në institucione e qendra relaksuese për njerëzit e kësaj moshe!

Por, a mjafton fantazia dhe dëshira ime, pasqyruar në këto rreshta si thirrje sensibël, si thirrje humane drejt pushtetit vendor e qendror, si leva të rëndësishme vendimarrëse për lehtësimin dhe zbukurimin sado pak të kësaj kategorie moshe të nderuar? Natyrisht, një bashkëkoordinim punësh mes shoqatash, individësh, mediash me pushtetin do të prodhojë patjetër gjëra pozitive që lartësojnë vërtet çdo ndjenjë pozitive tonën për moshën e tretë! Ka shpresë, natyrisht, përderisa jemi Njerëz!

Ky botim u mundësua nga Lëviz Albania. Ato që shkruhen jo domosdoshmërisht përkojnë me idetë e Lëviz Albania.

Peshkopi, hapet qendra e të moshuarve

GLV Integrimi nëpërmjet një projekti të financuar nga Lëviz Albania ndërhyri në hapjen dhe rigjenerimin e qendrës së moshës së tretë



Të moshuarit janë shtresa më vulnerabël në Shqipëri, duke qenë se atyre ju ofrohet vetëm pensioni. Pasi mbushin vitet e punës ato krejt papritur bëhen të padobishëm, ngrihen në mëngjes dhe nuk kanë një destinacion për të shkuar, një punë për të përfunduar, fuqitë sa vijnë e shterojnë, sëmundjet sa vijnë e shtohen, të afërmit dhe bashkëmoshatarët shpesh ndërrojnë jetë. Të ardhurat financiare zvogëlohen. Pensionet e vogla nuk të mundësojnë gjë tjetër veçse ushqime bazë dhe ilaçe, të cilat në shumicën e rasteve nuk rimbursohen. Stresi sa vjen dhe shtohet. Kanë ndonjë nip apo mbesë të vogël dhe duan ti bëjnë qejfin për ta qerasur dhe s'kanë mundësi.

Fëmijët kanë marrë rrugët e kurbetit dhe në rastin më të mirë vijnë dhe i vizitojnë në festat e fundvitit. Shteti nuk ofron asnjë shërbim shtesë për këtë shtresë vulnerabël. Në të vërtetë, një qeverisje e mirë duket në mënyrën se si trajton ato, më të dobëtit, dhe në këtë rast më të brishtët e shoqërisë tonë janë të moshuarit dhe fëmijët.

GLV Integrimi nëpërmjet një projekti të financuar nga Lëviz Albania ndërhyri në hapjen dhe rigjenerimin e qendrës së moshës së tretë, pasi janë të moshuarit ato që kanë më pak kohë për të pritur ndihmën tonë. Koha për ta ecën shumë shpejt, dhe sigurisht që e meritojnë që ditët e mbetura ti kalojnë të trajtuar me respekt dhe dinjitet nga pasardhësit e tyre.

U lobua me Këshillin Bashkiak, i cili miratoi një vendim për sigurimin e druve për ngohjen në këtë qendër si dhe një sanitare në mënyrë që mjediset të mbahen të pastra. Nga ana tjetër, Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Dibër, ofron kafe dhe çaj falas për to, duke bërë që këto të moshuar të kalojnë ditën në mënyrë aktive në këtë qendër.

GLV Integrimi loboi me Këshillin Bashkiak, i cili miratoi një vendim për sigurimin e druve për ngohjen në këtë qendër si dhe një sanitare në mënyrë që mjediset të mbahen të pastra. Nga ana tjetër, Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Dibër, ofron kafe dhe çaj falas për to, duke bërë që këto të moshuar të kalojnë ditën në mënyrë aktive në këtë qendër.



Ky botim u mundësua nga Lëviz Albania. Ato që shkruhen jo domosdoshmërisht përkojnë me idetë e Lëviz Albania.

Bajram Sojku ishte nga pajtimtarët më të mëdhenj dhe më të rrallë në Dibër, tamam Anton Çeta, por për të cilën nuk shkruan gazetat dhe nuk dhanë asgjë televizionet. Ai ka punuar në heshtje, ashtu kokë më kokë me njerëzit , duke përçuar tek secili të drejtën dhe të vërtetën, ato mësime që na vinë nga historia dhe tradita.

profil

ANTON ÇETA I DIBRËS

Nga **Xhafer MARTINI**

Nuk më kujtohet mirë viti, por duhet të kenë kaluar nja shtatë-tetë vjetë që kur në Muzeun Historik Kombëtar, Aqif Ademi, nga Maqellara, promovoi një libër për vendlindjen e tij, emri i të cilit nuk më kujtohet. Salla ishte mbushur plot se maqellarasit e duan njeri-tjetrin; nga ana tjetër, njerëzit i bren kurioziteti se mos e kanë emrin në libër. Të lënë në anonimitet për një kohë të gjatë, tani duan të jenë në qendër të vëmendjes. Këtë dibranët e kanë të theksuar. Nuk kishte ardhur Demir Osmani, një intelektual i njohur dhe jo vetëm për Maqellarën. Prandaj mungesa e tij u ndje dhe u justifikua. Dikush tha që "Ka shkuar në Lurë për të pajtuar do gjaqe." Kjo më bëri përshtypje se pajtimtarët, përveç se janë figura popullore të autoritetshme, kanë edhe përvojë urtësie që buron nga njohja e kanunit. Intelektuali në fjalë ishte i ri për t'i pasur këto vlera. Po më vonë mora vesh se edhe ai "nuk i hynte detit më këmbë", siç thuhet për një njeri që i niset një pune që nuk mund ta bëjë.

Por të shkojmë tek promovimi i librit. Natyrisht, kishte edhe një diskutant kryesor dhe ai doli që të fliste me letër. Ishte intelektual nga Maqellara, por nuk do t'ja them emrin. Si njeri është shumë i mirë dhe kjo mirësia më bën që njerëzve t'ua fali të gjitha të tjerat. Mbasi tha një pesë fjalë, shumë shkurt, në fund e përfundoi me fjalinë: "Tani Aqifi e bani punën, nuk di nëse do të dalë cucë apo voc".

Në këto promovime shkoj vetëm për të takuar ndonjë shok, ndonjë prej atyre që na ka ndarë jeta, por më ka marrë malli. Kur njerëzit vërshojnë nga koktejli, unë dal te hyrja e sallës mos më kap syri ndonjë fytyrë të dashur. Jam shumë përzgjedhës. Midis këtyre fytyrave pashë edhe Bajram Stojkun, njeri i nderuar dhe me dinjitet. Sa herë jemi takuar te Klubi i Sportit dhe kemi biseduar për tema të ndryshme. Me Bajramin mund të flisje për çdo temë dhe kuptoheshe drejt. E pashë edhe këtë radhë dhe e takova. E prisnin ca të tjerë me të cilët mua nuk më shkonte fjala, prandaj nxitova dhe i thashë:

- E kuptoj që të presin, po të ndal sa për të të përshëndetur.

- Le të presin, pa t'i thënë ty ato që kam për të thënë, nuk shkoj tek ata. Më vjen keq që nuk kemi kohë të ulemi në kafe dhe të bisedojmë si duhet.

- Nejse, sipas rrethanave, - thashë unë.

- Të falenderoj nga zemra për shërbimin e madh që më ke bërë, - më tha Bajrami.

- Të shkuara të harruara, - thashë unë. - Fundja, kam bërë vetëm detyrën, - shtova unë një fjali klishe nga përdorimi i shpeshtë në socializëm.

Me Bajramin kam qenë njohur tridhjetë e ca vite më parë kur isha mësues në shkollën tetëvjeçare "Demir Gashi". Kisha në kujdestari një klasë të tetë, të cilës i jepja edhe gjuhë shqipe. Midis nxënësve ishte edhe djali i Bajramit, Edmondi, që sot është bërë mjek dhe kuadër me rëndësi, se e kam parë nja dy-tri herë edhe në televizor. Por, sidoqë të jetë, nuk është fjala për këtë Edmondin sot, por atë djaloshin e atëherëshm që ishte bërë problem për disiplinë. Binte vërdallë klasën dhe mësuesen kujdestare. Me të shkuar unë mësues kujdestar, fillova t'ia mbledh rripat, siç thuhet, por me takt dhe dashuri. Edmondi nga kjo anë merrte vesh dhe bindej. U bë një nga nxënësit më të rregullt dhe më të mirë. Bajrami vinte e interesohej shpesh për të dhe më falenderonte me gjithë zemër. Kuintesenca e fjalëve të tij ishte kjo: "Po të mos kishe qenë ti dhe t'i bëje djalit atë

U ndamë atë ditë. Por qe takimi ynë i fundit... Më vonë mësova edhe nga të tjerët se Bajram Sojku ishte nga pajtimtarët më të mëdhenj dhe më të rrallë në Dibër, tamam Anton Çeta, por për të cilën nuk shkruan gazetat dhe nuk dhanë asgjë televizionet.

trajtim që i bëre, më kishte dalë nga dora". Në klasën tjetër i jepja mësim edhe vajzës së Bajramit, Monikës, që ishte ëngjëll dhe jo njeri, mësonte shumë mirë dhe sillej si aristokrate me rrënjë historike. Nuk kishte nga të dilte i keq Edmondi, por ai nuk e duronte harbutërinë, se nuk ishte mësuar me të. E pra, që të mos e zgjatim, kujtova që Bajram Stojku atë ditë më falenderonte për të kaluarën e hershme.

- Falenderimi që po të bëj është i ri, - më tha ai kur e pa se unë po lajthitesha. – E kam fjalën për "Kanunin e Dibrës". Me të në dorë, kam pajtuar disa familje në Lurë dhe në gjithë Dibrën. Ke bërë një punë që duhet të të falenderojë gjithë Dibra e gjithë shqiptarët, por, të paktën, unë po e bëj.

U ndjeva shumë mirë, si prindi kur i lavdërojnë fëmijën. Nuk kisha marrë kurrë një sadisfaksion të kësaj natyre.Unë e dija se "Kanuni i Dibrës" ka vlera origjinale historike, kulturore, juridike, të mënyrës së jetesës dhe plot vlera të tjera të traditës sonë, por nuk e dija se ai kishte edhe vlera aktuale, siç është pajtimi i gjaqeve sot.

- Qenke bërë si Anton Çeta, - i thashë Bajramit, se ashtu gajtan nga trupi dhe i gjatë, flokëbardhë, i ngjan shumë Anton Çetës.- Faleminderit shumë. Më gëzove me këtë lajm, por njerëzit nuk i pajton as Kanuni i Dibrës, as Kanuni i Lekë Dukagjinit, madje nuk i pajton as Kurani e as Bibla, por njeriu që u flet me zemër në dorë si di të flasësh ti. Më bëhet shumë qejfi që i je futur një pune aq të rëndësishme siç është pajtimi njerëzve.

- Njeriu që duhesh falenderuar je ti. Në luftë nuk shkohet pa armë. Dhe pajtimi është më i vështirë se lufta. Unë e kisha armën, kisha me se luftoja, dhe ky ishte Kanuni i Dibrës, - vepra jote. Me këtë libër në dorë ka shkuar për pajtim edhe Demir Osmani. Me Kanunin e Dibrës në dorë, pajtimtari, edhe në mos diftë shumë dhe nuk e ka përvojën e nevojshme, nuk e ndjen veten ngushtë se flasin shembujt, gjithë ato zgjidhje të mrekullueshme shekullore, që populli ynë i ka vënë në zbatim për të mos u shuar. Në atë libër e kaluara projektohet dhe hedh dritë në të mardhmen. Ka kaq gjera të bukura dhe të mençura, që, po t'i përcjellish si duhet tek njerëzit, nuk mund të mos u bëjnë përshtypje. Kam shumë me të thënë, por do të takohemi dhe do të bisedojmë prapë, do të ta tregoj me hollësi dhe me konkretësi si kam vepruar... U ndamë atë ditë. Por qe takimi ynë i fundit. Jam interesuar për të dhe më kanë thënë që është sëmurë rëndë, në shtrat. Mendjen e ka top, por i është prerë gjuha, fjala, pikërisht ajo për të cilën unë kisha shumë nevojë kur dilte nga goja e Bajram Stojkut. Më vonë mësova edhe nga të tjerët se Bajram Sojku ishte nga pajtimtarët më të mëdhenj dhe më të rrallë në Dibër, tamam Anton Çeta, por për të cilën nuk shkruan gazetat dhe nuk dhanë asgjë televizionet. Ai ka punuar në heshtje, ashtu kokë më kokë me njerëzit , duke përçuar tek secili të drejtën dhe të vërtetën, ato mësime që na vinë nga historia dhe tradita.

Shkolla shqipe në Radomirë

Nga **Metush SKEJA**

Shkolla e parë shqipe në Radomirë është hapur në shtator 1940. Ajo është hapur në lagjen Rade. Lokali ka qenë në të majtë të rrugës këmbësore duke u ngjitur lartë nga mullinjtë e Dërbaçit për në Rade, në fund të arës së Cen Canes. Ndërtesa ka qenë një katëshe me dy dhoma. Ka pasur një burim ujë përpara dhe një kumbull. Mësuesi i parë ka qenë Alush Abazi nga fshati Vleshë. Nxënësit e kësaj shkolle janë Lutfi Selmani, Islam Selmani, Ramadan Ahmati, Zeqir Ahmati, Isuf Çaveçja, Madana etj. Jeton sot vetem Lutfi Selmani, i cili ruan kujtesë të mirë dhe ka mbresa të bukura nga shkolla duke i treguar me deklamacion. Unë e kam intervistuar disa herë. Vajzat nuk kanë shkuar në shkollë. Programi e financimi i mësuesit ka qenë shtetror dhe i unifikuar. Shkolla shqipe në Rade ka vijuar mësimet për një vit e gjysmë. Më pas është mbyllur, për shkak të rrethanave të kohës.

Shkolla e Rade ka qenë me drekë. Nxënësve u jepej një racion bukë gruri, një copë marmalatë dhe dy copa djath në formë trekëndëshi. Ushqimi merrej çdo ditë në Peshkopi. Ka qenë vendosur radhë për çdo fshatar, me detyrim, për të shkuar në Peshkopi e për të tërhequr ushqimin. Dreka e fëmijëve ka vijuar një vit. Financimi i drekës bëhej nga shteti. Më pas aksh njeri, për motive të mbrapshta, u ka thënë fëmijëve se djathi bëhet nga derri dhe fëmijët nuk e kanë ngrënë.

Shkolla e parë shqipe në Radomirë lidhet me emrin e Rrahim Dakut. Banorët e zonës e kanë quajtur shkolla "Rrahim Daku". Ai ka qenë kryeplak si në kohën e mbretërisë dhe në kohën e pushtimit Italian. Në pranverë të vitit 1940 Rrahim Daku në marrëveshje më qeverinë e kohës ka marrë leje për të hapur shkollën shqipe në Radomirë. Me kontribut vullnetar e pak me detyrim, banorët e Radomirës kanë ndërtuar lokalin për afro 4-5 muaj. Në shtator 1940 shkolla ka qenë gati

Shkolla e parë shqipe në Radomirë lidhet me emrin e Rrahim Dakut. Banorët e zonës e kanë quajtur shkolla "Rrahim Daku". Ai ka qenë kryeplak si në kohën e mbretërisë dhe në kohën e pushtimit Italian.

me programe shtetërore, me mësues, banga e gjithçka i duhet një objekti mësimor. Viti mësimor ka qenë me 32 javë. Kryeplaku Rrahim Daku niste fshatarët për të marrë ushqimin e nxënësive. Sa do të dëshiroja sot që komuniteti i Kalasë Dodës të marrë përgjegjësi për edukimin e fëmijëve të vet!

Shkolla e parë shqipe në Kala të Dodës është hapur në Ploshtan, shtator 1922. Përpjekjet e para janë bërë në vitin 1918. Nismëtar ka qenë Shefki Manallari nga Radet. Ai kishte pasur një biznes të vogël në Selanik. Nga Selaniku shkon në Itali ku qëndron disa vjet. Si në Selanik e në Itali kishte rënë në kontakt me idetë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Në vitin 1918 kthehet nga Italia dhe hapën një klasë mësimi në shtëpinë e tij me fëmijët e fshatit. Kjo përpjekje nuk ka qenë e suksesshme, ashtu si përpjekja e Jemin Lalisë po nga Radet për tu mësuar djemve shkrim e lexim në gjuhën shqipe. Ai që e bëri realitet shkollën shqipe në Radomirë është Rrahim Daku horizonti, vullneti e aftësia për të marrë vendime e për ti realizuar është për tu pasur zili.

Shkolla "Rrahim Daku" është mbyllur për tu rihapur në tetor 1944, në fshatin Dërbaç të mejtepi. Në vitin 1944 me detyrim kanë mësuar edhe vajzat. Por shkolla shtatëvjeçare e tetëvjeçare është hapur shumë vonë në Radomirë , vetëm në vitin 1966, plot 26-vjet pas hapjes së shkollës shqipe të fshatit. Kjo rëndon mbi ndërgjegjen e autoriteteve drejtues arsimore të rrethit Dibër. Kur Han më 1863 ka vizituar Radomirën, thotë se ka gjetur qytetërim.

Ritëm vallje e refren kënge

Promovohet libri "Xhelal Çerpja, diamant i kulturës dibrane", me autor Shaqir Çerpja


Nga **Ilmi DERVISHI**

Në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë në pranin e miqve, dashamirësve të kulturës, shkrimtarë e artistë, u promovua libri kushtuar Xhelal Çerpës, një artist shumë dimensional, në fushën e kulturës jo vetëm në Dardhë, por edhe më gjerë. Nën moderimin e aktorit Llesh Nikolla folën për librin dhe sollën kujtime për Xhelal Çerpën, aktorin, humoristin, valltarin, autorin e teksteve e muzikë të disa këngëve, organizatorin e shumë aktiviteteve kulturore artistike për 40 vite me radhë si drejtues kulture në Zall Dardh por edhe në Maqellarë, Guri i Zi , Shkodër, në HC Fierz etj.

Xhelal Çerpja, me punën e pasionin e tij, e ngriti dhe e njohu grupin artistik të Zall Dardhës, jo vetëm në Dibër, por në të gjithë Shqipërinë e jashtë kufijve shtetërorë.

Gjatë takimit folën dr. Hajri Mandri, redaktor i librit, kantautori Esat Ruka - Mjeshtër i Madh, ku këndoj dhe këngë, Avni Ndreu solli kujtime të bukura gjatë punës, foli dhe këndoj një këngë dhe rapsodi Viktor Paloka, ashtu si dhe në libër kanë shkruar kujtimet e tyre publicisti i njohur Abdurrahim Ashiku, drejtori i Qendrës Kulturore Veli Vraniçi, regjizori dhe aktori Skënder Cala,, Liri Rasha, artiste e Meritua - Mjeshtër i Madh, këngëtari Shaban Mziu, Femie Kaziu, muzikanti Përparim Tomçini, ish mësuesi për disa vite në ZallDardhë, gjirokastriti Petro Mejdi e të tjerë.

Libri është një përmendore e shkruar me dashuri e përkushtim, me një kronologji ngjarjesh, me episode interesante për Xhelalin. Libri shoqërohet me shume fotografi, jo vetëm familjare, por më njerëz të artit, në role dhe aktivitete kulturore



Shkrimtari Shaqir Çerpja e mbyll librin e tij me një thënie shumë të bukur, duke e quajtur jo vetëm diamant i kulturës dibrane, por vetë Xhelali ishte ritëm vallje e refren kënge.

Historia e ngritjes së Muzeut **"Vend-origjina e Kastriotëve"** në Sinë

Nga **Besnik KËBEJ**

ETAPA E PARË

Në gushtin e vitit 1978 fillova punën drejtor në shkollën 8-vjeçare "Nimete Progonati" në Sinë. Në ditën e parë të prezantimit si drejtor, shtrova detyrat që kishim marrë nga partia dhe pushteti në rreth. Krahas punës mësimore dhe edukative me nxënësit e prindër, duhet të punonim për ngritjen e terreneve sportive, të ndihmonim me nxënës dhe kooperativën bujqësore, të lexonim shtypin në brigadë etj. Veç sa shënuam më lart, ishte detyrë që të punonim për ngritjen e një muzeumi në qendër të Sektorit në Sinë të Poshtme.

Në Sinë rashë në kontakt me gojëdhëna e emra vendesh për Skënderbeun, njëlloj si në Muhur. Në Muhur, që në fëmijëri kur shkonim me bagëti, plaku askohe 96-vjeçar, Rushit Kaleshi, që kishte qenë nizam në Turqi, krahas luftërave, tradhtive, urimeve e mallkimeve për fise e vende (toponime), na theksonte se "Skënderbeu ka lindur në Gjerdh (Gardh të Poshtëm).... Pleqtë e Sinës flisnin me pasion për Skënderbeun, si ata të Muhurit, ashtu edhe të Sinës, me të vetmin ndryshim: Skënderbeu ka lindë në Sinë".

Atëhere ndamë detyrat me mësuesit, që me forcat tona do ngrinim muzeun, në kuadër të 35-vjetorit të Çlirimit Atdheut. Unë mbajta toponiminë dhe intervistat me të moshuarit për Skënderbeun, për luftërat më serbët, për luftën Nac-çlirimtare, për hapjen e shkollës shqipe etj. Mësuesit sipas detyrave të ndara punuan me përkushtimm si në punën mësimore-edukative, në ngritjen e terrenit sportive dhe në përgatitjen e muzeut. Kryetari i këshillit të bashkuar Fushë-Çidhën, Sel Bulku, një kuadër më cilësi dhe vyrtyte shumë të larta, në bashkëpunim me përgjegjësin e sektorit të kooperativës bujqësore Shpëtim Salillari nga Manza e Durrësit, na siguruan një dhomë aty pranë zyrave të Sektorit.

Muzeu qe gati më 28 Nëntor 1979. Ky muze u krijua me gjetjet arkeologjike të rastit dhe me ato pak dokumenta, duke u mbështetur në shkrimet e mësuesit të apasionuar Ali Hoxha, në qendër të sektorit të kooperativës bujqësore, Sinë. Mund të thuash se ishte muzeu i Kasrtiotëve, pasi pjesa e luftës Nac-çlirimtare ishte shumë e varfër. Mungesa e dokumentave justifikohej me 'partizanët kanë hy në luftë në Sinë të Epër'.

Detyra për të vazhduar me nxënës gjetje të rastit arkeologjike vazhdonte, ashtu si dhe problemet mësimore-edukative. Deri në vitin 1982 organizuam dy sesione shkencore për Skënderbeun, duke bërë pasurimin e materialeve dhe shtimin e njohurive për Heroin. Më 29 maj 1982 kooperativisti Isa Kadriu solli në drejtorinë e shkollës një medalion prej bronxi me portretin e Skënderbeut, gjë që na gëzoi shumë dhe e morëm në dorëzim me procesverbal. Në konsultë me mësuesit, vendosëm që t'i bëjmë një telegram Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, duke e njoftuar për medalionin dhe ashtu bëmë.

Ky objekt (medalioni) bëri që të vinin me radhë nga rrethi studiues e drejtues, si Haziz Ndreu, Hysen Lala – drejtor i Muzeut të Rrethit Dibër, shefi i seksionit të Arsimit Beqir Shehu etj. Ata panë medalionin, vizituan dhe muzeun dhe na përgëzuan për punën e bërë dhe lanë porosi që puna të vazhdojë.

Pra, medalioni, telegrami dhe muzeu i ngritur më mjete të thjeshta dhe me pak material, e justifikonin punën e bërë nga kolektivi pedagogjik i shkollës, ku një kontribut dhanë mësuesit Gani Zoku, Xhelal Pashnjari, Haki Përnezha, Tofik Kurti, Shaban Shehu, Naim Berisha, Gëzim Kaba dhe Nexhmi Osmani me shkrimet në shkollë dhe në muze. Kontribut dhanë dhe Mustafa Reska dhe mësuesi Xhelal Meta, që krahas terrenit sportive, merreshin edhe me problemet e muzeut. Detyrat plotësoheshin paralel dhe ecnin mirë.

ETAPA E DYTË

(Kur shkelën Çidhnën historianët, Prof.Stefanaq Pollo e Prof.Kristo Frashëri)

Më 11 shtator 1982 mora njoftimin nga sekretari i byrosë së partisë së kooperativës Alush Stojku, se *'do vijnë disa historianë, prandaj dil*



"Gjithë jetën time më ka munduar pyetja , se si mund të lindë një Hero Kombëtar në një vend bosh! Tani kam marrë përgjigjen dhe them se 'po'. Këtu mund të ketë lindur Gjergj Kastrioti – Skënderbeu. Zgjuarsia natyrale e këtyre njerëzve është e jashtëzakonshme".

e priti!' Ishte porosi në telefon, rreth orës 10. Arritën rreth orës 13 të datës së mësipërme. Gjithashtu, nga Peshkopia, me makinë në mëngjes ishjin nisur në drejtim të Sinës Haziz Ndreu, Hysen Lala, Alush Stojku dhe së bashku me ta, ishte dhe bashkëshortje e Stefanaq Pollos. Rreth orës 18, hipur mbi kuaj, erdhën në Sinë nga Çidhna profesorët Stefanaq Pollo e Kristo Frashëri, të shoqëruar nga Ali Hoxha dhe Mustafa Tola (Ky i fundit nuk qëndroi me grupin, por iku në Çidhën).

Për të treguar peripecitë e rrugës së historinëve të ardhur me kuaj, i kërkova Mustafa Tolës që të shkruaj kujtimet e veta të asaj dite. Ja çfarë shkruan:

Ishte vjeshtë e vitit 1982. Bashkë me mësuesin e apasionuar Ali Hoxha, do të takonim ish drejtorin e Institutit të Historisë Prof. Stefanaq Pollo dhe Prof. Kristo Frashëri. Ata kishin ndjekur një sesion shkencor në Lurë. Atje ne duhet të shkonim me makinë për t'i marrë, por ish kryetari nuk na e dha makinën dhe ne qëndruam në fshatin Çidhën për t'i pritur te shtëpia e Adem Hoxhës, bashkë me të moshuarit (atëhere) Sadin Tola, Selim Xheçi, Hamit Cerri, Shaqir Tola, Osman Basha, Selman Basha dhe Dostan Cani. Pas katër orë rruge në këmbë erdhën nga Lura në Çidhën Stefanaqi dhe Kristo, të lodhur e të raskapitur. Kur i takuam, mezi na dhanë dorën.

Hymë në shtëpinë e Adem Hoxhës, ku qëndruam rreth dy orë, pimë kafe dhe bëmë muhabet. Si zakonisht në odat dibrane, mes të pranishmëve u ndez biseda dhe dhe u zhvillua një muhabet i këndshëm. Pas dy orëve dolëm nga shtëpia dhe jashtë në rrugë, Stefanaqi në prani të Kristos, më tha: "Dëgjo, djalë, unë do të kisha hequr dorë nga mendimi se Kastriotët janë nga krahina e Çidhnës, po të mos kisha takuar sot këta pleq. Ishin pleq me mend e të zgjuar". Pasi e dëgjova me vëmendje pohimin e tij, ia ktheva: Pse, ç'lidhje kanë pleqtë me Kastriotët?

Stefanaqi u përgjigj: *"Gjithë jetën time më ka munduar pyetja , se si mund të lindë një Hero Kombëtar në një vend bosh! Tani kam marrë përgjigjen dhe them se 'po'. Këtu mund të ketë lindur Gjergj Kastrioti – Skënderbeu. Zgjuarsia natyrale e këtyre njerëzve është e jashtëzakonshme"*. Me katër kuaj shkuam në Sinë vonë. Të gjithë mysafirët, përfshi edhe mua dhe Ali Hoxhën ndejtëm në shtëpinë bujare të Shefki Priftit, ku bisedat dhe debatet vazhduan deri në orën dy të natës.

Pasi më pyeti z.Pollo për shkollën, për punën për mësuesit, nxënësit e prindërit, për kushtet e punës etj, kaloi në temën kryesore, për gojëdhënat për Skënderbeun, për toponiminë e fshatrave, për literaturën etj. Gjithashtu më pyeti për muzeun që kishim ngritur me forcat tona, i tregova edhe për kolektivin e nivelin arsimor të tyre, duke i thënë se kishim zhvilluar dy sesione shkencore për Skënderbeun.

I tërhoqën vëmendje tri objekte arkeologjike, të gjetura në Sinnë të Poshtme, të cilat megjithë përpjekjet tona, nuk u bënë pjesë e pasurisë së Muzeut tonë, megjithë përpjekjet tona për t'i tërhequr në muzeun tonë. Dërguam disa herë mësues në Tiranë, por pa rezultat. Ato material ishin:

1. Një unazë floriri, me portretin e Skënderbeut, që kishte përfunduar në pronësi të Ahmet Zogut;

2. Një vulë e thatë me trup guri dhe pjesa më shkronja kishte stemë metalike. Pronari i saj u gjet, por sipas tij, i kishte humbur. Kjo vulë ka qënë gjetur rreth vitit 1967-1968, kur është hapur kanali vaditës, që del në anën e përtejme të Drinit.

3. Një pllakë metalike me stemë, e gjetur rreth vitit 1940, e cila, siç tregojnë, kur fërkohej, ndriçonte derisa të 'vriteshin' sytë deri në verbim.

Pasi i tregova për këto objekte, i fola për varrin e Ballaban Pashës në Sinë të Epërme, që kur gërmuam në shkamb, gjetëm copa qelqi shumë të holla, pjesë e një ene të thyer. Ndoshta të tjerë para nesh e kanë hapur dhe grabitur. Fola për kishat dhe si emërohen në ditët e sotme. U tregova se kur u shemb kisha në Kodër-Çardak, e cila ka qënë edhe shkolla më e madhe për priftërinj (sipas të dhënave nga banorët e hershëm).

I fola për 'kryqet në gur', ku sipas M.Barletit "... atje ku vdes një luftëtar apo njeri i shquar, gdhendej një kryq...". Si zakon i të parëve tanë, në Sinë të Poshtme ka tetë apo nëntë kryqe. Kjo tregon se ka pasë dhe kanë vdekur disa njerëz të shquar apo drejtues luftërash nga Kastriotët në këto vende.

Fola për Kllezin e Poshtëm, ku një përrua e ka zanafillën në Kllezin Epër dhe ky përrua njihet me emërtimin përroi i Qytetit. Fola për Trojën e Mzeze, ku ka shumë toponime e mikrotoponime me objekt pazaret dhe dyqanet. Në bisedë e sipër u ndez debati, kur u përmend Gardhi i Poshtëm e se ai ndodhet në Muhur dhe jo ashtu siç thonë disa se 'Gardhi i Poshtëm ka qënë Zgjerdhi.

Në debat hyri i pari Z.Frashëri, pastaj Haziz Ndreu dhe më pas Ali Hoxha. Unë kundërshtoja. Z.Pollo kërkoi që unë të paraqes të gjitha argumentat për Gardhin e Muhurit. Disi u lehtësova dhe u çlirova dhe vazhdova si më poshtë:

a. Në gjeografi kur thuhet 'i Poshtëm', ngjtas me ketë është 'i Epërmi', ose anasjelltas. Psh, dy sinat, dy Brestet, dy Dibrat, ashtu dhe Gardhi i Poshtëm e Gardhi i Epër (dy Gardhet).

b. Në Mesjetë çdo fshat ka kishën e vet. Kështu janë dy Sinët dhe Gardhi i Poshtëm ka kishën e Shën Premtes në Maslis. Gardhi i Epër nuk ka kishë, se nuk ka pasë banorë.

c. Çdo fshat ka ujin e vet të pijshëm. Gardhi i Poshtëm (I Muhurit) ka pasë kroin e vet, me emrin kroi i Gjerdhit (Gardhit).

d. Çdo vendbanim ka pasë e ka varret e veta. Gardhi i Poshtëm në Muhur i ka varret në Çukë të Epëra. Zgjerthi nuk ka.

e. Gardhi i Poshtëm në Muhur ka gjurmë banimi, të cilat janë dëmtuar gjatë kooperativës bujqësore e më vonë u vendos dhe një repart ushtarak, që e dëmtuan dhe më shumë. Zgjerdhi është rreth 1 km larg qendrës së Sinës Poshtme.

f. Çdo fshat ka pasë arat e veta, që mbilleshin me mel, thekër, grurë, elb, tërshërë dhe sidomos vreshta kishte me bollëk. Sot disa vendeve në shpatet e zabeleve u themi *vneshta*.

Të gjitha këto që thamë për Gardhin e Poshtëm të Muhurit, Zgjerdhi nuk i ka asnjërën. Fjala *Gardh,* është vend i banuar, kurse fjala Zgjerdh (vjen nga fjala 'zhgardhim') dhe ka të bëjë me toka që mbillen, kopshtije, por jo troje.

Zgjerdhi i Sinës Poshtme ka ujërat nëntokësore afër, prandaj i janë bërë kullime.

Megjithë argumentet e mia të paraqitura si mësipër, Kristo, Hazizi dhe Aliu qëndronin në të tyren, se ashtu e kishin shkruar e botuar asokohe. Përfundimisht argumentat e mia nuk fituan, se ata ishin tre dhe unë një. Pra, me vota fitoi Kristo. Lexuesit do të gjykojnë për argumentet e mia.

Diskutuam dhe për Kastriotin, si fshat dhe dy palët qemë të mendimit se Kastriotin e themeluan paraardhësit e Skënderbeut. Po ashtu u pajtuam edhe për betejën e parë të turqve kundër Skënderbeut, që ka hyrë në historinë si Beteja e Torviollit. Kjo betejë u zhvillua në fushën e Kastriotit, duke përfshirë në veri Shumatin dhe në jug Brezhdan.

Me këto biseda, ora kishte shkuar dy e natës dhe në këtë kohë e bëmë gjumë.

Të nesërmen në mëngjes, pamë disa vende në Sinë të Poshtme dhe vizituam muzeun e vogël që kishim ngritur në qendër të sektorit. Nuk po zgjatem për diskutimet që bëmë, pasi pak prej tyre i shënova në një fletë fletoreje, që e kisha me vete, esencën e tyre po e paraqes sipas shënimit që lanë ato, si më poshtë:

"Sinë, 12 shtator 1982.

Vizituam muzeun e vogël të fshatit Sinë, vendi i origjinës së Kastriotëve dhe Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut. Përshëndesim nismën e banorëve Sinës dhe atyre që e përkrahën ngritjen e këtij muzeu. Urojmë që ai (muzeu) të pasurohet sa më shumë e më shpejt dhe të kthehet në një objekt historik të vizitueshëm për edukimin e brezit të ri. Urojmë që së shpejti në Sinë të ngrihet muzeu kombëtar kushtuar familjes së Kastiotëve e bjëve e bijave që nxori kjo derë e shkqlqyer, veçanërisht heroin e pavdekshëm, Skënderbeun".

Kristo Frashëri, Hysen Lala, Stefanaq Pollo, Haziz Ndreu

Firmat

* * *

Historianët e nderuar Prof.Stefanaq Pollo dhe Prof.Kristo Frashëri, pas kësaj dite, i përcollëm nga Sina rreth orës 11, duke na lënë një porosi dhe një angazhim të tyre. Porosia ishte që ne të vazhdonim punën ashtu siç e kishim nisur dhe të bënim përpjekje për të gjetur literaturë që flet për Skënderbeun dhe Kastriotët. Ndërsa ata na premtuan se nuk do



të shkonin në Tiranë, pa takuar drejtuesit e rrethit të Dibrës, me qëllim që të marrin masat për të planifikuar dhe ngritur një ndërtesë për Muzeun e Kastriotëve.

Kjo ndërtesë, sipas tyre, do ishte me plan ndërtesë karakteristike, nga më të mirat në Mesjetë dhe mundësisht të ngrihet sa më shpejt. Ata thanë se 'ju sinjanët dhe ata të rrethit ta plotësoni me çka të mundeni me material që lidhen me Kastriotët. Ky do të jetë një muzeum interesant në një zonë të Dibrës Poshtme dhe do të varet nga Muzeu i Skënderbeut në Krujë. Vendin ku do të ngrihet muzeu e caktoni në bashkëpunin me shokët e komitetit Ekzekutiv dhe të Urbanistikës, se duhet zbatuar vija e verdhë e ndërtimit. Urojmë të jemi gjallë dhe ta përurojmë sa më shpejt ketë muze me titull "Vendorigjina e Kastriotëve".

Porosia e fundit për ju (për sinjanët) është që të na njoftoni për gjetjet e reja interesante.

ETAPA E TRETË

Historianët bënë punën e tyre, mbetën detyrat për pushtetarët. Profesorët Stefanaq Pollo dhe Kristo Frashëri u larguan nga Sina më 12 shtator 1982, duke lënë detyra dhe duke marrë për vete disa angazhime. Afër dy javë pasi u larguan këta studiues, më 24 shtator erdhën në Sinë një grup i madh njerëzish, drejtues nga rrethi i Dibrës, me në krye të ndeuarin Skënder Dema, kryetar i Komitetit Ekzekutiv te rrethit. Në ketë grup ishin Avni Fida – sekretar i Kom. Ekzekutiv, Ramiz Sela – përgjegjës i Seksionit të Arsimit e Kulturës, Hysen Lala – drejtor i Muzeut të rrethit, Shahin Kamberi – përgjegjës i Qendrës Ekonomike të Arsimit, Mirdash Alliu – inxhinier që do bënte projektin dhe do ndiqte punimet, Surja Stafa etj.

Pasi panë rretheqark Sinën e Poshtme, vendosën që Muzeu të ngrihet atje ku ndodhet sot, pasi kishte një pozicion shumë të mirë, afër baçes së gjithë katundit, ku kishte disa trungje gështenjash dhe një man shumëshekullor. Duhet thënë se për ardhjen e këtij grupi njerëzish nga Peshkopia, unë u njoftova para ardhjes tyre nga zonja Dylbere Hoxha, punonjëse e Zyrës Kuadrit, tamam një zonjë grua.

Pas caktimit të vendit për ngritjen e Muzeut, me kënaqësi të jashtëzakonshme i ftova për një kafe dhe dërgova në shtëpinë e zakonshme të mikpritjes të Sefedin Priftit. Fati i keq se aty nuk gjetëm asnjë burrë, por të zotin e shtëpisë e zëvendësoi në mënyrë të shkëqlqyer nëna e Sefedinit, Dija.

Duke pi kafe e duke biseduar për Skënderbeun, për gojëdhëna e toponime, i nderuari Skënder Dema, i kërkoi leje nënës së Sefedinit. Ajo si burrëneshë i kërkoi të falur, pasi nuk ishin burrat në shtëpi dhe ndoshta u ka munguar muhabeti, se siç tha ajo, 'me ba muhabet si burri me burra'. Kryetari iu përgjegj se 'mirë do ishte të ishin, por nuk na mungoi gjë', duke e falenderuar gruan burrëneshë.

Pastaj e mora fjalën unë, duke i u drejtuar kryetarit të Kom.Ekzekutiv. i thashe se përpara se të merrnin leje, duhet të shkruani në këtë fletore (dhe nxora nga çanta fletoren), vendimin që morët për ngritjen e Muzeut. Dua ta kem kujtim të shkruar me dorën tuaj dhe firmat, anipse nuk ka vulë. Atëhere, kryetari tha: "Jam shumë i gëzuar që sot, unë Skënder Dema do të firmos për Muzeun e Skënderbeut". Fletoren e mori dikush nga shoqëruesit she ai shënoi fjalët e kryetarit. Për interesat e mia kam kopjuar tekstin si më poshtë:

Sinë, 24 shtator 1982. Sot erdhëm në Sinë, në truallin e Kastriotëve, ku lindi Heroi Kimbëtar, Gjerg Katrioti – Skënderbeu. E ndjejmë veten krenar që na jepet rasti të caktojmë vendin ku do të fillojë të ndërtohet Muzeu simbolik kushtuar origjinës së Kastriotëve dhe Skënderbeut.

Gërmimet arkeologjike në këto troje me rrethinat e saj, si dhe mbledhja e të gjitha toponimeve, gojëdhënave, legjendave etj, për Kastriotët do të hedhin dritë më të plotë për një konceptim të gjerë e më të argumentuar rreth të vërtetës mbi Kastriotët, për ngritjen në të ardhmen të një vepre monumentale.

Avni Fida; Beqir Shehu; Ramiz Lela; Hysen Lala; Skënder Dema.

Firmat

* * *

Pasi pimë kafen dhe unë mora fletoren, dolëm duke pa nëpër rrafshen e Sinës së Poshtme. Shokëve të Seksionit të Arsimit dhe të Qendrës Ekonomike të Arsimit iu dha detyrë që muzeu duhet të dorëzohet më 20 nëntor, në kuadrin e festave të Nëntorit të bëhet përurimi. Z.Shahin Kamberi premtoi se më 19 nëntor muzeu do ishte gati. Ndërsa për pajisjet e brendshme sikur u vu në dyshim arritja e objektivit.

Grupi i qeveritarëve që mbeti, bashkë me mua, shkuam për drekë te Masllam Tafa, një familje bujare. Edhe këtu z.Skënder zhvilloi bisedë me të zotin e shtëpisë për toponimet, gojëdhënat dhe legjendat që lidhen me Skënderbeun. "Unë bashkë me të tjerë, - tha Skënderi, - muzeun do ta bëjmë, por besoj se do vijë koha që Sina do shpallet fshat - muze dhe shtëpijat tuaja do marrin tjetër pamje. Pas këtyre fjalëve, kërkoi leje për të dalë nga shtëpia.

ETAPA E KATËRT

Brenda dy-tre ditësh brigade e specialistëve të ndërtimit të Arsimit dhe brigade e specialistëve e kooperativës bujqësore, të drejtuar nga Vesel Loka, mbështetur dhe nga kryetari i Këshillit Popullor të Sinës Epërme, Ramazan Kadiu, filluan punën. Fillimisht mblodhën dhe specialistët e ndërtimit të vendit, kryesisht nga Sina e Epërme dhe filluan rrafshimin e vendit, grumbullimin e materialeve të ndërtimit si gur, rërë, çimento dhe zhavor.

Të gjitha këto bënë që më 14 tetor 1982 të hapen themelat dhe brenda dy ditësh u rrafshuan themelet. Vesel Loka nuk pranoi që fasadën (faqen e parë) ta bëjë me gurë ashtu siç është sot, por kërkesa ime ishte këmbëngulëse. Falë kuadrove si Mustafa Tola që dhuroi gurët e gdhendur të shtëpisë së tij dhe falë punës përkushtuese të Shefki Priftit, që ishte përgjegjës sektori në kooperativën e Çidhnës, puna filloi me gurë të gdhendur.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Kontributi i Rakip Sinanit rreth betejave të Skënderbeut

Nga **Mevud BUCI**



Libri na jep bilancin e ushtrisë shqiptare dhe mbyllet me studimin "Skënderbeu dhe dibranët" (f.103-107), duke na dhënë më pas tregimet dhe gojëdhënat për Skënderbeun si dhe dëshmitë e kronistëve e historianëve për luftën e Skënderbeut 1443-1467.

Madhështia dhe vlerat e një libri qëndrojnë në faktin sesi shkruhet, çfarë përmban, sa realisht dhe mirëtistikisht është realizuar. Fatmirësisht libra të tillë ka, botohen dhe promovohen. Jo sepse jemi në Vitin e Skënderbeut, po gjithnjë librat për kryeheroin, botuar në çdo gjini, do të mbeten testament dhe dëshmi e qëndresës.

Libri"Beteja të Skënderbeut" na shfaq luftrat heroike të heroit, unitetin, besnikërinë e luftëtarëve, vitalitetin e një epoke të ndritur. Autori Sinani e hap librin me thënien e Marin Barletit: "Skënderbeu e filloi mbretërimin e tij më 28 nëntor 1443" (f. 3). Ky libër historik e studimor, mbart vlera sepse përshkruan me saktësi e vërtetësi betejat legjendare të Heroit Kombëtar, jep fakte, episode, ngjarje, dëshmi që vijnë nga fushëbetejat po edhe të kohëve midis tyre, në periudha më të qeta. Në tetor të vitit 2018 ky libër mjaft i çmuar, mbushi 21 vite të botimit të tij. Me thjeshtësi e çiltërsi autori Rakip Sinani pohon:

"Në këtë studim flitet për betejat e zhvilluara nën udhëheqjen e Skënderbeut në trevën e Dibrës, duke qëmtuar shumë fakte e dokumente, gojëdhëna e këngë të popullit që i përkasin kësaj periudhe" (f.5). Puna e përkushtuar me drejtim të mirëpërcaktuar hulumtues e studiuesit Sinani është sa e thjeshtë e prekëse, e lodhshme , por tejet e vlerfshme për kohën kur u botua, po me theks aktual edhe për ditët e sotme e veçanërisht në këtë përvjetor.

Siç është vërtetuar nga historianët, Skënderbeu nga 24 beteja 18 i zhvilloi në Dibër. Kjo tregon se dibranëve të Arbërisë u ra për pjesë kjo gjë, të qëndrojnë mburojë në sheshbeteja të përgjakshme kundër perandorisë osmanë. Studimi "Princi Gjon Kastrioti" hapet me këtë paragraf:

"Gjon Kastrioti lindi në fshatin Sinë të Dibrës së Poshtme. Në zonën e Çidhnës, Gjon Kastrioti ndërtoi në fshatin Kastriot një kullë e cila mori emrin "Kulla e Gjonit".

Argumente, fakte, përshkrime, shifra, referenca plotësojnë gjithë kuadratin e prozës shtjelluese të Rakip Sinanit. Libri i tij mbetet një dritare nga mund të shihen vlerat e kësaj epoke me dimensione tronditëse, një pasuri për studentët, studiuesit e rinj për të qartësuar saktësisht dhe pa ndonjë dilemë të mundshme figurën e Skënderbeut.

Shkrimin"Skënderbeu prijës dhe strateg ushtarak"(f11-20), Sinani e shtrin në qartësimin e ngjarjeve dhe rrethanave, kryengritjeve dhe betejave dhe, mbi të gjitha, në guximin e tij për të marrë vendimet në kohë e për të përpunuar strategjitë e nevojshme. Ai jep të dhëna për Stemën e Kastriotëve, Vulën e Skënderbeut, Kryengritjen e armatosur të Dibrës 14 nëntor 1443, vendet historike të Dibrës 1443-1467, Beteja e Torviollit, beteja në Grykën e Radikës, 10 tetor 1445, po këto të dhëna i ndërfut aq bukur në hapësirën e një përshkrimi korrekt. Kur përshkruan sulmin e Skënderbeut në kështjellën e Kruhjës citon vargjet e poetit amerikan Henri Longfellou, përkthyer nga Fan Noli: Nga kështjella shpejt ka rënë / Flamuri me gjysmëhënë, / Edhe populli shikon / Që në vend të tij valon / Flamur i Skënderbeut në erë /Shkab e zezë mëe dy krerë…

Ja se si e përshkruan autori "Betejën e Torviollit" më 29 qershor 1444: "Në mëngjesin e 29 qershorit, në fushën e Torviollit, luginën e Bulqizës, u vunë në gadishmëri forcat turke të Ali pashës dhe luftëtarët e Skënderbeut" (f.29) Realizmi në përshkrimin historik të ngjarjes është domethënës dhe kuptimplotë e mbi të gjitha tregohet eposi i qëndresës që e jep edhe kënga popullore: Hajde, hajde, Moisi dibrani / Ta njeh hujin ty sulltani,/ Krahi u lumtë dibranëve të tu / Rreptas turkun e kanë sulmu / n` fush të Dushajve e kanë rrethu.

Mirë pasqyrohet në libër edhe beteja e Skënderbeut në Grykë të Radikës (10 tetor 1445), beteja e Otonetës (27 shtator 1446), beteja në Oranik (14 gusht 1448), prita në Mirosh, Rovik (16 maj 1449), rrethimi i Sfetigradit (14 maj 31 korrik 1449), luftimet për marrjen e Sfetigradit (25 shtator-14 tetor 1449), vendet e kampimit të ushtrisë së Skënderbeut në Dibër, beteja e Modriçit (21 korrik 1452), beteja dytë e Oranikut (20 maj 1456), mbledhja e Këshillit të Luftës në Dibër (korrik 1457), beteja në Mokër të Dibrës (27 gusht 1462), beteja në Vajkal, beteja e dytë në Meçad (qershor 1465), beteja në fushën e Sfetigradit (korrik1465) beteja e dytë në Vajkal (gusht 1465), vlerësimet për këtë betejë, masakra e Çidhnës (gusht 1466), rimarrja e kështjellës së Çidhnës, të dhëna për ushtrinë e Skënderbeut, armët e zjarrit që u përdorën, punishtet e barutit në Dibër, rrugët që u shfrytëzuan nga ushtria e Skënderbeut; këto e plot të tjera pasqyrojnë një epope qëndrese.

Libri na jep bilancin e ushtrisë shqiptare dhe mbyllet me studimin "Skënderbeu dhe dibranët" (f.103-107), duke na dhënë më pas tregimet dhe gojëdhënat për Skënderbeun si dhe dëshmitë e kronistëve e historianëve për luftën e Skënderbeut 1443-1467.

Të dhëna jepen në aspektin ushtarak dhe historik të epokës skënderbegane, mbi kështjellat dhe betejat e shumta.

Në vitin e Skënderbeut, studiuesi Rakip Sinani, ndonëse nuk jeton më, meriton edhe ai një nderim për këtë kontribut të çmuar.


Rruga e Arbërit nr. 150

botime

Shënime rreth librit "Kalaja e Dodës - Vështrim enciklopedik" të autorëve Beqir Shehu dhe Ermira Shehu Toca

KALAJA E DODËS - VËSHTRIM ENCIKLOPEDIK

Nga prof. dr. **Hajri SHEHU**



Dheu i Kalasë së Dodës (emërtimi *dhé* është i autorëve; përdorimi është gjithëpopullor në truallin, për të cilin është shkruar libri) ka kufij natyrorë e historikë Veleshicën e Ujët e Lapave. Është një dhé me kroje e me kopshte. Me ara e me livadhe. Me kullota e me bjeshkë. Me ujëra e me ujëvara. Me nëntokë të pasur. Me shtëpi të pastra e me sofra bujare. Me një të folme melodioze e me një folklor magjepsës. Këto thënie e këto cilësime mund të vërtetësohen duke lexuar librin.

Autorët janë studiues dhe mësues shumë të vlerësuar. Libri është përgatitur për shtyp dhe është botuar nga *Botimet M&B* sipas të gjithë parametrave modernë.

Qëkur e kemi emërtimin "Kala e Dodës"? Që nga viti 1864, - thonë autorët. Ku ndodhej ajo që u quajt Kala e që i dha emërtimin krahinës? Tabja e Nizamëve[1], në lartësinë 1224 m mbi nivelin e detit, - konkludojnë ata. Arsyetimet lidhen me udhëtimin e shënimet e udhëtimit nëpër viset e Drinit të konsullit austriak, Johan F. von Hahn. Krahina, - thonë autorët, - ka qenë pjesë e sanxhakut të Dukagjinit (shek. XVI). Më tej, autorët përshkruajnë pozitën gjeografike në të gjitha detajet e njësitë e saj fiziko-gjeografike (Korabi, Sarakoli, Suka / Mali i Sukës, lugina e Çajës, lugina e Veleshicës dhe e Drinit të Zi etj.). Njësitë vendore (etnologjike ose administrative), Katundet e Epra dhe Malësia – Kalisi e Vila, jepen me lagje, fise e vëllazëri. Një krye më vete janë emërvendet. Për emërvendet do të ndalemi pak më tej. Në libër, jepen me detaje fizike e historike rrugët e krahinës.

Bashkë me këtë dhé na vijnë edhe dhetarët – banorët e tij historikë dhe aktualë. Dhe ky Dhé njëjtësohet (identifikohet) me ta. Me një kulturë të madhe familjare e shoqërore. Me ngjarje të mëdha. Me atdhetarizëm të flaktë. Me përkushtim për punën. Me shumë dije për veten dhe për të tjerët.

Nëse duam të dimë a të mësojmë për kulturën e tyre **familjare**, le të shohim sjelljen e burrave me gratë dhe me vajzat. Njeriu më i madh i të gjitha vendeve dhe i të gjitha kohëve, Profeti Muhamed (Në parantezë: Kështu e përcakton amerikani Maikëll Hart /Michael Hart/ në librin e tij "100 Personalitetet më me Influencë në Botë", Tiranë, 1998) thotë: "*Gratë janë binjaket e burrave*". Vlerësim më të madh për femrat nuk mund të ketë. Këtë binjakësi të grave me burrat e gjen në Kala të Dodës. Madje, na duket se gratë janë më shumë se binjake të burrave në Kala. Shihni veshjet dhe punët e tyre. Edhe veshjet, edhe punët e tyre janë elegante. Kujtoni nuset. Kujtoni vetëm një moment. Nusja çohet në të pamë. Aq dinjitare. Në kalë me sixhade (tani, edhe me makinë). Një djalë i rritur a burrë - përpara kalit. Dhe pastaj, pritja atje ku shkon. Më shumë se princeshë. Shihni nusen e dasmës, përcjellësit, zbritjen e saj te shtëpia e re. Shihni në libër e në jetë tërë dasmën, qëkur fillon e derisa mbaron. Të gjithë për nusen. Gjithçka për nusen. Një moment tjetër: Nusja favorizohej me blerje rrobash të bukura para vajzave të shtëpisë e kunatave më të mëdha. Dhe askush nuk zilepsej. Sepse ishte nusja. Kunatat e kishin përjetuar këtë favorizim. Vajzat do ta përjetonin. Nëse duam të dimë më shumë për kulturën familjare, të shohim traditën e bashkëbisedimit në familje. Ajo ruhet edhe sot, - thonë autorët, - si pjesë e rëndësishme e edukimit familjar për të rinjtë e për të rejat. Edhe dy shembuj të tjerë nga libri për kulturën familjare: Oda e burrave. Aq funksionale e aq hijemadhe. Me shtrojën e saj – qilimat e postiqet e bardha si bora në Korab, me takëmin e kafes, me dërrasën me gdhendje zbukurimore tej e tej murit, ku vareshin ferexhet e burrave e pushkët me grykë poshtë. Me një kulturë të lartë shërbimi. Dhe në këtë odën e burrave edhe në verë, në vatër (të oxhakut) ose në sobë viheshin një krah dru, ashklat dhe fitili i pishës, veç për ta ndezur. Sepse mysafiri vjen në derë pakujtuar. E mysafiri do zjarr. Zjarri është pritja e dytë pas mirëseardhjes e mirësegjetjes. Shembull tjetër? Petkat e shtratit. Ato vijnë në odën e burrave aq të pastra e aq erëndshme. Është tubja e maravës së tharë në palët e tyre. Dhe nuk ka aromatizues modern që e konkurron atë. Atë nuk e konkurrojnë dot as trëndafilat e Holandës dhe të Arabisë Saudite.[2] Ka edhe shembuj të tjerë për kulturën familjare. Nuk po i japim për të mos i dalë përpara kureshtjes së lexuesit.

Në duam të dimë a të mësojmë për kulturën e madhe **shoqërore** në Kala të Dodës, le të shohim mënyrën e organizimit të katundit, të stanit, të ruajtjes së pyllit, të dasmave. Edhe të mortave. Le të shohim kuvendet dhe itifaket. Dhe rreptësinë e itifakeve. Te kuvendet e tek itifaket dhe te historia e kuvendeve dhe e itifakeve në Kala shihet mjaft qartë e mjaft bindshëm mençuria e peshimi i fjalës nga dhetarët, thellësia e gjykimit dhe vendosmëria për t'i çuar deri në fund vendimet.

Organizimi i jetës shoqërore zë në libër një pjesë bukur të madhe. Lexuesi mund të mësojë shumë për këtë. Autorët e quajnë vetëqeverisje. Vetëqeverisje në familje – vëllazëri – fis – mëhallë – katund - dhé (krahinë). Një koncept i madh qytetarie: Vetëqeverisja është formë e vetëdijes shoqërore. Dhe një filozofi popullore vendore. Një filozofi morali. Dhe moral. Vetëqeverisja ka qenë vetëruajtje e edhe vetëmbrojtje e bashkësisë, por edhe e familjes a e individit. Me forcën detyruese të vendit. Pa forcën detyruese të shtetit. Prandaj nuk ka pasur anarki. S'ka pasur amoralitet. Prandaj ka pasur rregull në marrëdhëniet shoqërore. Ka pasur nder. Ka pasur dinjitet. Organizmat drejtues të dheut, - thonë autorët, - ishin tre: 1. Kuvendi i dheut (ku bënin pjesë krerët e katundeve dhe të bajraqeve); 2. Pleqësia e besës; 3. Kreu i dheut a reizi.[3] Vini re: Pleqësia e besës. Pleqtë e besës. Kreu i pleqve të besës. Çojeni mendjen pastaj për një moment ç'do të thotë për një katund, bajrak, plak a reiz të mbetej jashtë besës. Në tërë këtë besëlidhje përshfaqet personaliteti i kaladodasit. Dhe ky personalitet mbështetet themelisht në dy kategori psikike-morale, thënë ndryshe – virtyte: burrëria dhe nderi. Prandaj te kuvendet e tek itifaket e Kalasë kishte (e ka) besë e rreptësi. Nga libri sjellim shembullin e itifakut për Urën e Reçit e për ruajtjen e malit (pyllit) në Radomirë. Shembulli tjetër është për spitalin e ruajtjen e spitalit në vitin e kobshëm 1997. Ka shumë shembuj mbushamendës në jetën e kaladodasve, që përcillen në këtë libër për t'i marrë si model edukate dhe kulture shoqërore. Pse, a nuk është model edukate shoqërore dhe kulture shoqërore ndihma që jepet kur bashkëlagjasi a bashkëkatundari ndërton shtëpi të re? Ndihmëtarët vijnë pa i thirrur njeri. Po ndihma e cucave dhe e nuseve tek endja e qilimit? Shihni edhe shembullin tjetër: Nëse ndodhte që për arsye sëmundjeje (metil etj.) ose moti, i dëmtoheshin shumë dhentë dikujt, të tjerët do t'i dhuronin dele e qengja e ai nuk do të kthehej me shkop në dorë nga shtegtimi. Një solidarësí shembullore.

Në Kala të Dodës nuk e lënë jashtë të huajin, jabanxhiun. Shihni në libër fjalët e konsullit austriak, Hahn për mikpritjen dhe vlerësimet e tij aq dashamirëse. Më shumë se kaq, në Kala të Dodës nuk e lënë varrjashtë jabanxhiun. Kujtoni emërvendin Vorri i Sejmenit. Kujtoni çfarë thuhet te kënga "Motra me nanë vllazën" *(Jan vra do të ri, ishin jabanxhi / Për sevap katuni në dhé i ka shti)*. Është folklor, por folklori është formë e ndërgjegjes shoqërore.

Në Kala të Dodës nuk e lënë jashtë të huajin, jabanxhiun. Shihni në libër fjalët e konsullit austriak, Hahn për mikpritjen dhe vlerësimet e tij aq dashamirëse. Më shumë se kaq, në Kala të Dodës nuk e lënë varrjashtë jabanxhiun. Kujtoni emërvendin *Vorri i Sejmenit*. Kujtoni çfarë thuhet te kënga "Motra me nanë vllazën" *(Jan vra do të ri, ishin jabanxhi / Për sevap katuni në dhé i ka shti)*. Është folklor, por folklori është formë e ndërgjegjes shoqërore. Kujtoni, në kohë të vona varrimin e të rënëve të tjerë jovendës. Në Kala të Dodës nuk u bihet lodrave afër varrezave, xhamisë, teqesë e tyrbes. Sepse aty ka heshtje. Në Kala të Dodës, kaçakët lejoheshin të takonin të fejuarat. Shumë kuptimplote. Shumë e njerëzishme. Shumë familjare. Por edhe shumë shoqërore. Në Kala të Dodës ruhet përbërja fisnore e mëhallës a e katundit. Por janë mirëpritur lëvizjet nga fshati në fshat, sidomos nga Vila e nga Kalisi. Dhe i kanë bërë vëllezër trojesh. Dhe *vëlla trojesh* është koncept i madh shoqëror. Shih edhe konceptin tjetër të madh shoqëror – familje e mbështetur, që autorët e shpjegojnë bukur, madje, e konkretizojnë me emra e me mbiemra. Kjo është psikologjia e tyre e jetës dhe e marrëdhënieve të tyre me të tjerët. Dhe më në fund, në Kala nuk ka pasur e nuk ka gjakmarrje.

Në libër na vjen si në ekran kultura **materiale** në Kala të Dodës – banesa, shtroja, veshja, kuzhina e magjja, stani etj. Buka e thekrës është më shumë se një franxhollë qyteti. Flia e petullat e mishi i zier në tambël kanë vend veçantë. Laknori zëvendëson berrin edhe për pashanë.

Në punë të kulturës materiale duam të përveçojmë veshjen. Ajo është pasqyruar hollësisht në libër. Si në një ekspozitë etnografike. Si në një botim mirëfilli etnografik. Veshja e meshkujve është burrërore: Qisja e bardhë rrafshatake, koparania e zezë, mitani, xhamadani (me gajtanë të zinj a me ngjyrë floriri, që mbahej zakonisht i hapur, sidomos ai me skepa), këmisha e linjtë e bardhë, me jakë të ngushtë, qëndisur me tegela me penj të bardhë e mëngët e gjera, tirqit e bardhë me gajtanë të zinj, brezi i bardhë a bardhë e zi, me thekë në dy fundet, qosteku i sahatit prej sermi, që përfundonte te pala e brezit në mes nga përpara, çorapet me mediskambe e opingat me lëkurë lope, lidhur me ndorta të bardha si bora në Korab. (Në parantezë: Asnjë djalë nuk bëhej dhëndër pa çorape me mediskambe). Po gëzofi? Po ferexhja e çobanit a e udhëtarit? Kjo ishte veshja. Ky ishte portreti fizik i burrit të Kalasë. Për ta ekspozuar në muzetë etnografikë më prestigjiozë të Europës.

Veshja e femrave, sidomos e nuseve – pasunore, aristokratike: mëndafsh, birinxhik, krem, atllas, basmë. Basma – me lule trëndafilash. Dimiat, kur s'ishin të mëndafshta, do të kishin vijë mëndafshi. Mëndafsh ishte edhe riza (shamia e kresë). Ojnat, teminat, gajtanët, qëndismat e dukatët plotësonin artin e artistiken te veshja. Në cilin konkurs veshjesh a bukurie mund t'u dilej para nuseve të Kalasë: Shamia e mëndafshtë, zbukuruar me ojna, rruaza e vizllima, lidhur nën gushë. Vargu i dukatëve. Vargu i rruazave. Anteria, libadja e atllasit a trikoja. Dimiat e mëndafshit. Poshterka, e endur me pulla a me katrorë. Shto këtu edhe jelekun me fije ari, shallin e mesit e çorapet me breza.

Në Kala të Dodës ka një kulturë të lartë **artistike**. Sixhadet, qilimat, trikot e çorapet e Kalasë së Dodës, - thonë autorët e librit, - fituan emër deri tek dyert e Stambollit. Po. Sepse ornametrika e tyre është aq e pasur. Dhe kjo ornametrikë është e kultivuar, e trashëguar, kolektive. Në Kala është shkolla e endjes në vegjë dhe e thurjes me kërrabëza. Në Kala pikturohet me shije të hollë artistike. Penel është fija e ngjyrosur e perit. Ndoshta përdorëm metafora e krahasime. Por, besojmë e meritojnë vendin e tyre. Në këto metafora e krahasime do të plotësojmë diçka. Psikologjikisht, jo të gjithë njerëzit – pra, edhe jo të gjitha femrat e kanë aftësinë për perceptime të holla ngjyrash. Një ndër arsyet është se fizikisht, te ngjyrat e sidomos te nuancat që janë fqinje me njëra-tjetrën në të dyja anët ka vetëm një ndryshim (e dallim) të vogël perceptor (krahaso *i molltë / i molltë i kuq / i molltë i mëshelë / si i molltë* etj.). Këtë intuitë dhe këtë dallim perceptor vajza e Kalasë e ka shumë të zhvilluar, sepse, siç u tha më lart, ka një oramentikë të kultivuar brez pas brezi, që vjen nga një shkollë, gjithashtu brez pas brezi. Kjo vërtetësohet edhe gjuhësisht me emërtimet e ngjyrave të harxheve e të nuancave të tyre – në rastin tonë, shembulli me *të molltë*.

Kultura artistike shkon edhe më tej. Te kali i nuses në rrugëtim (sepse nuk mund të kishte nuse pa kalë): sixhadja a hirami, i endur me thekë si sixhade e dujqit (hejbet). Edhe dujqit ishin me vizatime si sixhade. Shtroja e kalit ishte pjesë e pajës. Le të bëjmë tani dallimin me ndonjë rast tjetër, diku tjetër, kur në pajë ishte tërkuza e gjethës.

E bukura shkon edhe më tej. Qethja e deleve në gusht-shtator, - thuhet në libër, - bëhej me bukë feste. Ishte një festë e vërtetë prodhimi. Dhe qethja bëhej edhe me zbukurime. Por edhe vrangulla e boshtit të furkës bëhej me zbukurime. Edhe kërliku i shkopit të çobanit ishte me zbukurime. Edhe anxhiku (caliku) i çobanit bëhej me qemerë te gryka. Një qytetërim, vërtet i spikatur.

(vijon në numrin e ardhshëm)

---

[1] *Tabe* (turqisht *tabje)* fortifikatë e vogël; llogore.

[2] Në Arabinë Saudite, në Taif, 70 km tej Mekës rritet një lari (varietet) trëndafili erëndshëm, që nuk e ka asnjë vend tjetër i botës. Çdo vit aty bëhet panairi botëror i trëndafilave.

[3] Kreu a reizi i dheut zgjidhej nga kuvendi. Ndërrohej nga kuvendi. Nuk mund të zgjidhej më shumë se dy herë. Demokraci krejt e kulluar.

Tematika e poezive të Ahmet Prençit është e gjerë dhe e larmishme; ka brenda, flirtin, idilin, moskuptimin, pritjen, ikjen, "kthimin në fëmijëri"...

Psikologji dhe **traditë** të shkrira bashkë në vëllimin poetik **"Udhë në pasqyrë"**

Nga **Dr.Fejzulla GJABRI**

Si rastësisht u ndodha në promovimin e këtij vëllimi poetik. Pashë poetë, aktorë, politikanë e përgjithësisht njerëz të dijes. Isha në shoqëri me Zabit Lleshin, që më prezantoi me autorin. Veprimtaria filloi me urimin "Urime" dhe mbaroi po me këtë urim. Librin e morën dikush nën sqetull e dikush e vendosi në makinë, sipas gradës ekonomike. Një paraqitje libri mjaft dinjitoz nga Botimet M&B. Unë e mbaja në dorë.

Pa arritur të ulesha diku, shfletova disa poezi në autobus. Në fakt, edhe pse u thanë fjalë të mira në promovim, (se zakonisht të tilla fjalë thuhen në këto raste), meqë nuk kisha asnjë njohje personale me autorin, (edhe pse është person publik), vargjet nuk më 'lëshuan', aq sa kisha kaluar një stacion autobusi më tepër nga ku duhej të zbritja. Ndjeva se poeti Ahmet Prençi ishte afër meje, tashmë jo si mbrojtës i ligjeve shtetërore, por si mburojës e shpalosës i ndjenjave njerëzore. Dhe këtë e ndjen poeti dhe shkencërisht e jep psikologu, se poezia vjen para psikologjisë.

Në poezinë e tij sikur shkrihen të dyja: Poeti me psikologun, bazuar në traditën tonë popullore. Aty tradita shihet në kohët e sotme, së brendshmi, me trokun e melodive të një shpirti të pasur, të mbushur me ndjesi, përjetime, mbresa, emocione, gjendje ballafaquese. "Ne ikëm në qytet./ Mbyllëm shpi e katandi, / Llambat e vajgurit s'janë për qytetet! /Po nëna e mori, e ruajti të shtrenjtë/ Aty pran dritares, ...(Llamba e vajgurit). Udhë në kohë jo shumë të largët, paraqitur me llampën dhe nënën., si "për të ndezur mallin në gji".

Duket sikur në vargjet, strofat dhe poezitë e tij pikturon me ngjyra të forta kumte dhe ndjesi e mall, gjendje shpirtërore që dalin nga mesazhet, duke na dehur me temporitmin e vrullshëm të aktit poetik, në tentativën për të na ofruar te malli me dimensionet e një ëndrre, tek e cila na josh të besojmë dhe ne lexuesit e tij: "... E anuar kulla. / I dhëmbin ijet. / Kurrizi i dalë, / Rematizma i ka mpirë këmbët...". Eh, sa prej atyre që ishin në atë promovim, kanë lënë kullat diku, që vazhdojnë të anohen! Ndoshta nuk ka nevojë ta çojmë deri në fund, se poeti na ka 'sqaruar'se: "E shkreta vatra e udha pa njerëz / vdes edhe Planeti po s'pati njeri! (Kulla).

Poezitë e tij kanë impresione burimore, të nxitura nga tradita e krahinës, por jo vetëm. Poeti rikrijon struktura poetike me mjete moderne, duke e tejkaluar objektin e tradicionalizmit me nëntekste të reja. "Ne

Duket sikur në vargjet, strofat dhe poezitë e tij pikturon me ngjyra të forta kumte dhe ndjesi e mall, gjendje shpirtërore që dalin nga mesazhet, duke na dehur me temporitmin e vrullshëm të aktit poetik, në tentativën për të na ofruar te malli me dimensionet e një ëndrre, tek e cila na josh të besojmë dhe ne lexuesit e tij

Në poezinë e tij sikur shkrihen të dyja: Poeti me psikologun, bazuar në traditën tonë popullore. Aty tradita shihet në kohët e sotme, së brendshmi, me trokun e melodive të një shpirti të pasur, të mbushur me ndjesi, përjetime, mbresa, emocione, gjendje ballafaquese.



mblidhnim xixëllonja në grushtat e dritës/I fusnim në magje që të shtohej mielli,/Në mbrëmje kur Drini puthej me brigjet/ e në buzë laureshe këndonte fyelli...". (Për vete). Kemi të bëjmë me një poezi dinamike, që rrok hapësira jete në lëvizje, nga një besim pagan, po aq edhe fëmijëror, pasuar nga dy vargje që përndizen në vatrat e përflakura të metaforës në 'buzë laureshe me fyell'. Aty është e dukshmja dhe e padukshmja, e thëna dhe e nënkuptuara, tradita dhe psikologjia. Fundja të gjithë mosha madhore mbajnë mend se mblidhnim xixëllonja e i hidhnim në magje të miellit. Poeti e ka ngritur në art këtë yshje, duke shprehur një botë ideo-emocionale, siç është vetë jeta njerëzore.

Poeti shkon më tej, në botën e perëndive. "Perënditë në Olimp i kanë shtëpitë/ në Korab bëmat, intrigat dashuritë" (Korabi). Si njohës i mirë i mitologjisë, i miteve ballkanike, na jep se "..përtej reve, përtej qiellit, përtej ëndrrës...", ka verbe dhe pasione deri nga më të ligat. Ballkani me majat e tij më të larta, një ndër të cilat është Korabi, kanë pësuar nga ato bëma dhe intriga të kurdisura në Olimp apo edhe më sipër, në Karpate. Të paktën kështu e kuptoj unë. Nuk e shtyn më, por më tej thotë: "...në urrejtje jam prap naiv, / s'di të urrej, ose urrej shumë pak" (Harku i Ylberit). Të ecësh në udhën e poezisë, nuk do të thotë se je naiv, por do të thotë të jesh i pushtuar nga magjia e fjalës, (se atë ka poeti).

Bota e paraqitur në poezitë e Ahmet Prençit mbart gëzime, hidhërime, dashuri, iluzione, duke flakur çdo çast të keqen nga vetja dhe nga të tjerët, në emër të një sistemi vlerash, tek të cilat beson. Përsa i përket Olimpit dhe Korabit, beson dashuritë e urren intrigat. Gjithkund e gjen në këtë vëllim këtë dukuri. Poeti, ndërkohë që i ngre kult bukurisë njerëzore dhe, mbi të gjitha, të shpirtit njerëzor, mirësisë, dashurisë, fisnikërisë. Poeti "luan" me gjërat, në dukje, të imëta e të vogla, por që në fakt, përbëjnë raportet e tij me vetveten, me unin dhe jashtëunin, si: 'Me nazet si Shotë, me hiret si Zanë"; me ata që e rrethojnë, duke na sjellë kështu hapësira të ndjesive dhe përjetimeve, "...I mekur pa fjalë nga hijeshia/ fustanellë me pala malesh,/ mbi supe Labëria", në të cilat gjen trajtat dhe modelet e procedimit modern të aktit të shkrimit të poezisë.

Poezia e Prençit është një poezi në rrugëtim të natyrshëm drejt vetvetes, si njohës i mirë i psikologjisë njerëzore. Duket se jeta e ka përplasur me të mirën dhe të keqen, bazuar dhe në punën e tij profesionale. Diku stigmatizon dukuritë negative të individit dhe shoqërisë, ironizon dhe demaskon veset, cenet dhe maskat e kohës dhe të bashkëkohësve. "I admiron, të tallin/ i përkrah, të përdorin,/ i ndjek, të gënjejnë,/ i harron, të urrejnë, i përçmon, të vrasin (Qasje). Këto antiteza dalin aty-këtu së bashku me të bukurën, ndërsa poeti nuk di të ofendojë, edhe pse ndoshta është ndeshur me të ligën.

E shëmtuara, virtyti dhe vesi: "Çudi me njerëzit kërmij/ të vegjël, të mbrojtur me guacka,/ E gjuajnë çastin e bunacës,/ të sulen pas lëmshit në gracka", vihen në antitezë me fisnikërinë, të bukurën: "Por unë jam përtej tyre / Jashtë pellgut jashtë bunacës...", duke na përcjellë mesazhin e luftës së njeriut modern në shoqërinë globale për t'u vetëpërsosur në shkollën e madhe të bukurisë dhe të pasionit për vepra të drejta humane.

Vendlindja në mesin e luginës Drinit të Zi, duket që në fëmijëri e ka ndihmuar të shkruajë poezi, pasi kjo luginë (edhe vetë Drini) ka mjaft legjenda e gojëdhëna. Me këto gojëdhëna dhe legjenda merret 'personazhi' në disa poezi të vëllimit "Udhë në pasqyrë", së bashku me enumeracionin e vendbanimeve ku kalon. Duket se poetit i kalon pranë kullës së tij: "Kulla ime shelg përkulet,/ Udha ime në pasqyrë, Mbyllet qielli si qepalla,/ Si qepalla që fsheh synë". Ja mu këtu te kulla e vet, merr shkas për t'u vënë titullin poezive, vëllimit poetik. "Për mua jelek dhënduri,/ për motrën vello ari, /... Derdhesh, shkrihesh si sheqeri,/ nëpër male e nëpër fusha, me shtatë ngjyra si ylberi." Diku është "djep kreshnikësh', diku vjen si 'shtopjzavalle',/ me valët si ninullë, ../duke kaluar 'Zall-Sopot, Murrë e Mallë, / Bicaj Luma e Veleshicë,/ zbresin si qingjat manar, n'gjunj ulen e pinë sisë" (Kalëron Drini i Zi). Zgjodha këto toponime të të lumit 'tel sharkie', sa për të prekur sadopak shijen artistike të autorit, me mallin e vendlindjes, që së bashku me kullën, të parët e bashkëkohësit në ... "Dibër t'Madhe, Luzni e Muhur, Fushë-Alie, Reç e Dadhë..", janë "Luftëtarë e mendjeartë".

Tematika e poezive të Ahmet Prençit është e gjerë dhe e larmishme; ka brenda, flirtin, idilin, moskuptimin, pritjen, ikjen, "kthimin në fëmijëri", ku "Sqepi i trumcakut thyhet pas xhamit", si te balada e Nanë Vllazne, ku zogu (laraska) jep lajme. Në folklor poeti popullor ka thurur vargjet: -Moj laraska me penin e zi, a i ke pa nanë vllaznit e mi? Poeti e njeh këtë baladë, njeh folklorin dhe nëpërmjet kësaj

Bota e paraqitur në poezitë e Ahmet Prençit mbart gëzime, hidhërime, dashuri, iluzione, duke flakur çdo çast të keqen nga vetja dhe nga të tjerët, në emër të një sistemi vlerash, tek të cilat beson.

pasurie të madhe të krijimtarisë popullore, të figuarave të tilla, jep artin bashkëkohor. Njeh heronjtë tanë, njeh Mahmut Dac Kalisin me "Shtatin në Veleshicë, kryet në Gjallicë...", njeh heroizmat e Jasharëve, që "Në luginën e Prekazit bie shi,/...Pastaj përmes shiu,/ rrebesh me plumba zjarri,/Rrufetë si Zeusi/ i prêt Adem Jashari!

Temat janë nga më të ndryshmet, nga ato të Drinit me këngët e tij, të Kosovës, të Labërisë, ato të 'hershmet' me "Faraonë e skllevër", me "Migjenin që më sfidoi mbrëme" e shumë e shumë të tjera. Ato sjellin jehonën nga e kaluara e afërt apo e largët, sjellin Prekazin, etj. Poeti "flirton" me ëndrrat, iluzionet, vjeshtën me kulumbritë, "motive në shi", "Zjarrmia" pa kthim, "Guri i Shqipes", me enigmat e tij të mbetura në hije etj, etj.

Me këtë vëllim poetik Ahmet Prençi përvijon individualitetin e tij si njohës i mirë i psikologjisë, traditave të lëna nga të parët, që di të bëjë art me to. Diku me rimë e diku jo, vargjet tingëllojnë ëmbël e të ngrohtë, të fuqishëm e mesazhdhënëse. Dikush në promovim tha se 'ka shkruar e botuar poezi në shtypin e kohës para viteve 1990. Ndoshta aty janë fillesat, por nuk jam i bindur se ato poezi mund të jenë model për një poet tjetër. Koha e ka pjekur Ahmetin jo vetëm si shtetar të mirë, por edhe si poet e ndoshta më pas edhe si prozator. Sigurisht e them ketë duke lexuar poezitë e vëllimit "Udhë në pasqyrë", ku afresku i gjendjeve, imazheve, mbresave, përjetimeve, kujtesave të sjella në art, në artin e shkrimit poetik, sjell prirje dhe tendenca të poetikës bashkëkohore mbarëshqiptare. Kjo duket te zhbirimet e holla psikologjike, etike, filozofike të shumë poezive të tij, që tregojnë shkallë të lartë mprehtësie dhe inteligjence natyrale, për të na dhënë peizazhe të thyera të jetës së gjallë dhe të shpirtit njerëzor.

Autori shkruan poezi, në disa prej të cilave tradicionalizmi si mënyrë jetese, tashmë jepet artistikisht me risitë e modernitetit të poezisë. Lexuesi ndjek vargun me rimë, asonanca dhe ritme të matura, që janë poezi të traditës sonë letrare, por në asnjë rast nuk bie në thjeshtëzime të tepruara, se "magazinier nuk bëhet poeti". Ja, me elegancën e vargut, freskinë dhe modernitetin e figurës, ndonjëherë edhe spontanisht vargu del natyrshëm, me gjetje të veten, si pjesëtar i një shoqërie në liri, ndihet një misionar i lirisë, me hallet dhe problemet edhe të kulturës sonë. Sigurisht që ndihesh i afërt me njerëzit kur flet përmes ndjenjave.

Së fundi, të kesh redaktor Besnik Mustafajn, është privilegj, do të thotë se poezia ka vlera të shumta, ndryshe kalibri i shkrimtarëve të këtij rangu nuk merret me krijime të dosidoshme. "..një suprizë e bukur... - vlerëson Mustafaj. Por nuk do e kisha marrë marrë dot me mend se ai kishte gjithashtu aftësi t'i shprehte me poezi marrëdhëniet e tij të brendshme me botën që e rrethon".

Rruga e Arbërit nr. 150
veprimtari

Bashkia Bulqizë dhe "Bashkësia Dibrane" nderojnë ish-drejtorin e Kiniklubit "Minatori", Hysen Dervishi

Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave

Nga Halil RAMA*

Dy vjet më parë, Hysen Dervishi botoi librin "KRENARIA" i cili jo vetëm që u promovua bujshëm, por edhe u mirëprit nga lexuesi. Me krenari të ligjshme për vendlindjen, në 75-vjetorin e ditëlindjes, dhurata e tij më e çmuar për ne është libri – encikopedi "DIBRA ZEMRA E KOMBIT". Pikërisht në ditën e promovimit të këtij libri, në praninë e qindra intelektualëve, jo vetëm nga Dibra, por edhe nga Tirana, Mati, Durrësi, Kukësi e Elbasani, Këshilli i Bashkisë Bulqizë i dha titullin "Qytetar Nderi" ish-drejtorit të Konoklubit "Minatori" (prej më shumë se dy dekada), Hysen Dervishi, ndërkohë qe Prof.Dr.Bujar Kapexhiu – Kryetar i Shoqatës "Bashkësia Dibrane", e nderoi atë me nje "Mirënjohje" në emër të kësaj shoqate.


Gjithsesi në epiqendër të kasaj veprimtarie promovuese në sallën e madhe të Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, ishte libri prej 745 faqesh "Dibra, zemra e kombit", të cilin unë pata fatin ta kisha që në dorëshkrim, dhe pasi ma besoi autori edhe ta redaktoja me përgjegjësi.

U befasova që në leximin e parë për qasjen e Hysen Dervishit, që e konsideron Dibrën si zemrën e kombit, jo vetëm për vendin që ajo zë në hapësirën gjeopolitike shqiptare, por parasëgjithash për historinë e saj të lavdishme, për personalitetet e shquara që zënë vend parësor në elitën e kombit shqiptar.

Libri i Hysen Dervishit "Dibra, zemra e kombit" që u promovua më 27 tetor 2018 në sallën e madhe të Muzeut Historik Kombëtar në praninë e qindra intelektualëve dibranë (dhe ku autorit iu dha titulli "Qytetar Nderi i Bulqizës", nga Këshilli Bashkiak i qytetit minator), është një mal historie, është kryqëzimi i ngjarjeve dhe fakteve. Është lapidari i personazheve që kanë ecur përmes epokave në rrjedhjen e vazhdimësisë, është pasqyrimi i vërtetësisë historike të vjetër dhe të re, është simboli i një rrjedhshmërie ku renditen me art dhe vërtetësi figura të mëdha dibrane, të cilët ishin dhe mbeten gurët vendimtarë të themeleve të odave-shtet dhe në vazhdim të shtetit shqiptar.

Në libër ka dendësi ngjarjesh e faktesh që pasqyrojnë në nivelet e larta individë, fise, fshatra dhe epoka, me të cilët Dibra e kombit tonë ka formuluar në trashëgiminë e Nëntë Maleve trimërinë, dinjitetin, bujarinë dhe zgjuarsinë e saj, duke u bërë e veçanta e Shqipërisë.

Në libër renditen mjeshtërisht ngjarje e fakte që flasin për luftëra e individë, për figura politike e patriotike që kanë bërë historinë përmes mendjes dhe pushkës, për burra e heronj që vunë mbi gjithçka atdheun e kombin shqiptar. Në të gjitha ngjarjet e rëndësishme duke përfshirë shekuj e epoka e deri në Luftën e Dytë Botërore renditen figura historike që iu ndizej shpirti për vatanin e pushtuar, ku Dibra e dibranët mbeten malet e mëdhenj dhe lapidarët e yjeve të pashuar të historisë së vjetër e të re...



Libri i Hysen Dervishit "Dibra, zemra e kombit" që u promovua më 27 tetor 2018 në sallën e madhe të Muzeut Historik Kombëtar në praninë e qindra intelektualëve dibranë (dhe ku autorit iu dha titulli "Qytetar Nderi i Bulqizës", nga Këshilli Bashkiak i qytetit minator), është një mal historie, është kryqëzimi i ngjarjeve dhe fakteve.

AUTORI, NJË STUDIUES I ZOTI DHE NJOHËS I MIRË I NGJARJEVE DHE FAKTEVE

Pa pretenduar aspak monopolin e së vërtetës, autori me ndjenjën e përgjegjësisë së tij si një studiues i zoti dhe njohës i mirë i ngjarjeve dhe fakteve, duke depërtuar përmes kulturave dhe zakoneve të Dibrës, i rendit rrjedhshëm, pastër e me vërtetësi individët, figurat qendrore, të parët e Dibrës, komandantët, gjeneralët, veteranët, mësuesit, agronomët, artistët, shkencëtarët, heronjtë, ministrat, deputetët, njerëzit e thjeshtë, duke krijuar një tabllo të saktë e reale të Dibrës, e cila gjithnjë nxorri burra me virtyte të mëdha, heronj e mendimtarë që i dhanë kombit besën dhe dëshirën për të jetuar me nder.

Në libër parakalojnë figura të rëndësishme historike të parisë së Dibrës, të atyre burrave që sot ka apo s'ka një në njëmijë, ecën koha e socializmit e përshkruar me vërtetësi si dhe epoka pluraliste. Me një gjuhë të bukur me retrospektiva e art, me një skalitje artistike të figurave të shumta të brezave, pasqyrohet vër-



Kryetari i Bashkisë së Bulqizës z.Melaim Damzi, duke i dhënë titullin "Qytetar Nderi i Bulqizës" z.Hysen Dervishi.

tetësia dhe dashuria, urrejtja dhe përçmimi, solidariteti dhe heroizmi në luftë dhe në paqe. Përmes këtij libri me shumë vlera për të tanishmen dhe të ardhmen, vijnë tek lexuesi personazhe të reja e të vjetra nga të gjitha fushat e jetës, duke formuar një tabllo të plotë e reale të Dibrës, e cila në shekuj ka qenë e mbetet balli i historisë kombëtare. E veçanta dhe bukuria e librit është se përmes tregimit, përshkrimit, portretit, pasqyron të shkuarën, të tanishmen, dhe të ardhmen dhe bën vërejtje, thirrje, kritika, aludime, duke zgjuar tek njerëzit mendime të reja dhe të gjitha këto përshkruhen përmes një arti të hollë, i cili të bën përshtypje për botëkuptimin dhe zemërgjerësinë e autorit me përvojë e dinjitet, i cili bën thirrje për një aleancë me moralin e ri, për tolerancë, falje, mirëkuptim, më qëllim që shoqëria e tanishme të mbjellë farën e ringjalljes dhe të korrë frytet e epokës së re...

Në libër trajtohen portrete heronjsh, artistësh, kooperativistësh, mësuesish e mjekësh, trajtohen figura të veçanta të sistemeve e klasave, bazuar tek e drejta e autorit, sepse libri është i tij, veçanërisht tani në epokën e pluralizmit, e cila është koha e respektimit të mendimeve të njëri-tjetrit. Në këtë libër të përshkruar fund e krye përmes artit e kulturës, autori i thur hymne Dibrës, kësaj nëne të madhe e fisnike, e cila ka skalitur në daltën e kohëve personazhe me emër e lavdi të madhe, duke ia rritur famën e prestigjin nënës së saj, e cila lindi dhe mëkoi trima, mendimtarë, bestarë.

Në libër përshkruhet saktë jeta e gjallë me të mirat dhe dobësitë e saj, njeriu, individi që bën historinë, populli, klasat, rrymat, fiset, paria e Dibrës, ushtarët e gjeneralët... Mbi të gjitha në libër është spikatur dashuria, mirënjohja, fisnikëria, tradita për njerëzit, të cilët kanë bërë e bëjnë historinë.

Përmes këtij libri të shkruar me shumë ndjenja dhe kompetencë, del në pah roli i autorit si publicist e historian, duke sugjeruar data, vite, ngjarje, personazhe të cilët do të jenë burim shumë i pasur referencash për të ardhmen.

Përmes librave të tij, përmbledhje poezish, radiodramave, skenareve, studimeve, autori evidentohet një prej figurave të rëndësishme të letërsisë dhe artit dibran përkrah shkrimtarëve dhe artistëve të tjerë të cilët me punën e tyre të dinjitetshme kanë rritur vlerat e veta dhe të Dibrës prej së cilës vijnë.

Përdorimi i një metodologjie moderne në kapërcimin e paragjykimeve, ilustrimi i figurave historike të djeshme dhe të sotme dhe gjykimi për kohën e tyre tregon se autori e njeh historinë duke qenë edhe një hulumtues i burimeve arkivore me një qëndrueshmëri të ekuilibruar fort mirë nisur nga ideja se "askush nuk e ka monopolin e vërtetësisë absolute". Inteligjenca, transparenca dhe ekuilibri përshkon fillin e mendimit dhe i jep lexuesit një vepër dinjitoze në përshkrim të ngjarjeve, datave, fakteve, emrave duke vënë në ballin e veprës së tij faktorin njeri.

Në këtë libër-enciklopedi shkëlqen si një fill i kuq gjaku, atdhedashuria, dashuria për vendlindjen, për Shqipërinë, për shqiptarët kudo që janë.

Pa asnjë mëdyshje, jeta dhe vepra e 163 personaliteteve dibrane, që nga ajo e Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Qemal Ataturkut, Ahmet Zogut, Elez Isufit, Iljaz Pashë Dibrës, Dine Hoxhës, Sheh Bulqizës,Tafë Kaziut, Haki Stërmillit, Haxhi Lleshit, Ahmet Camit e deri tek dhjetra akademikët, mjekët, gazetarët e shquar dibranë, si: Prof.Dr.Luan Hajdaraga, Prof.Dr.Bujar Kapexhiu, Prof.Dr.Fehmi Abdiu, Prof.Dr.Shaban Sinani, Prof.Dr.Qemal Disha, Prof.Dr.Petrit Bara, Prof.Dr.Myqerem Tafaj, Bashkim Dedja, Safet Zhulali, Lulzim Basha, Jashar Menzelxhiu, Xhelil Gjoni, Monika Kryemadhi, Ismail Lleshi, Naim Plaku, Defrim Methasani, Sakip Cami,Fatos Daci, Shemsi Prençi, artistët dibranë Hazis Ndreu, Agim Krajka, Skënder Cala, Edmond Zhulali, Perparim Tomçini, Arif Vladi, Liri Rasha, Vera Laçi e Avni Ndreu, sipërmarrësit e mirënjohur, mbështetës të artit, kulturës, librit e sportit: Faik Bruçi, Latif Miha, Musa Riçku e dhjetra të tjerë, të profilizuar aq bukur në këtë libër, shërben që t'u themi më të rinjve se ka edhe vlera të mira ky vend, kjo krahinë, që duhen njohur, që duhen ndjekur, pa folur dhe për Panteonin e vlerave që ka dhe duhet të ketë një komb, pavarësisht se sa popull ka ai në sipërfaqen që mbulon flamuri i tij.

LIBËR RACIONAL, EMOCIONAL, DOKUMENTAR, ARKIVOR

Miku ynë i nderuar Hysen Dervishi sjell kështu për lexuesin një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor – burim frymëzimi për brezin e sotëm e për brezat që do vijnë.

Një libër që na sjell një shpirt të madh, gati parajsor të personaliteve dibrane me kontribute madhore për kombin, ku spikat pjesa e portretizimit të tij.

Në këtë libër mësojmë për ngjarje historike, shesh beteja dhe dashuri përmes tyre; data dhe vende, fusha dhe male, rrugë e kodrina me plot dashuri mbuluar, emra njerëzish, të njohur dhe më pak të njohur, heronj të së shkuarës dhe të ditës me mirënjohje dhe dashuri mbështjellë; shpresë për të ardhmen dhe përsëri dashuri përmes saj.

Në këtë rrugëtim të gjatë prej më shumë se pesë dekada në vendlindje, në Peshkopi, Bulqizë, Mat e Tiranë, Hysen Dervishi ka progresuar duke mbajtur në konsideratë kërkesat e kohës, duke konfirmuar marrëdhëniet e tij ndaj vlerave shpirtërore të njeriut. Si i tillë ai nderohet e respektohet në këtë 75-vjetor të ditëlindjes së tij.

Në këtë libër-enciklopedi veç të tjerash shton emra të spikatur në panetonin e vlerave. Duke sendërtuar vlerat shpirtërore, duke qenë gjithnjë, ashtu si dhe në familje afër ngadhnjimit të së mirës ndaj të keqes, dritës ndaj ërrësirës, të vërtetës ndaj të pavërtetës.

Nuk është zor të ndjesh se dashuria është ai motiv që ka rrokullisur njëra pas tjetrës faqe të tëra të këtij libri që frymëzojnë cilindo që atdhedashurinë e ka lajtmotiv të jetës së vet.

Si përfundim, do të thoja se libri i Hysen Devishit "Dibra-zemra e kombit", është një vlerë e shtuar në letërsinë tonë dokumentare dhe si i tillë ia vlen të jetë në bibliotekat tona.

Edhe njëherë: Urimet më të mira Hysen, për këtë vepër dinjitoze!

**Redaktor i librit*

Intervista me kampionin
e BadyBilding, Arbër Xhemalin

Dibrani që nuk ngopet me tituj Kampionësh!

Nga **Samet ZAGRADI**



Arbër, nëse dikush të sheh kuptohet qartë nga format e trupit që je pjesë e sportit të bodybuilding. Pra, ti je një kampion! Na fol pak më shumë për veten tënde?

Unë kam lindur në fshatin Kurbek të Maqëllarës në vitin 1986. Atje kam kaluar fëmijërinë time. Shkollën e mbarova në Maqëllarë dhe çdo gjë kujtoj nga ajo kohë ka qenë e bukur. Fëmijëria e kohës time ndryshon shumë me atë të sotmen, dhe mendoj që ka qenë shumë herë më e bukur, më e qeshur dhe më e shëndetshme. Si çdo shqiptar, edhe unë, nga kushtet ekonomike u detyrova të emigroj në Itali, ku punova si gjithë të tjerët. Përveç punës, fillova të merresha me sportin e muskujve.

Si e ke nisur ti këtë sport? Sa vite ke që merresh me të?

Me sportin e bodybuilding ka rreth shtate vite që unë merrem dhe e ushtroj. Kam qenë 27 vjeç kur kam nisur të merrem me këtë sport në Itali. Duke parë njerëz me muskuj në filma, fillova të stërvitem dhe prej kaq vitesh jeta ime është nga palestra në gara. Është një sport që me të vërtetë kërkon shumë përkushtim, stërvitje dhe kujdes të madh me ushqimet. Për mua është një sport shumë i bukur dhe do e luaj deri kur unë të kem mundësi.

A ka një moshë në fillimin apo mbarimin e këtij sporti?

Mosha optimale për të filluar këtë sport varion nga 20 deri 22 vjeç më pas nuk një moshë limit për lënjen e këtij sporti. Nga çdo moshë ndryshon kategoria e cila është e ndryshme nga njëra-tjetra. Sporti i bodybuilding është një sport që jo vetëm për meshkuj. Ka shumë femra të cilat janë kampione në këtë disiplinë. Në Shqipëri ka federate dhe shumë sportistë që garojnë por fitimet dhe mbështetja nga kjo federatë mungojnë totalisht.

Na fol pak për arritjet dhe titujt e fituar nga garimet në këtë sport?

Unë, siç të thashë, këtë sport e kam nisur rreth tetë vite më parë në Itali. Unë kam garuar në vitin 2013 në kampionatin "ATENAS" ku prej kohësh udhëhiqesha dhe stërvitesha nga trajneri Alberto Clementi një bodybuilder kampion i Italisë dhe fitues i titullit botëror në garat WABBA dhe tani si profesionist i FBB. Në vitin 2016 kam garuar në Shqipëri duke zënë vendin e parë në kategorinë -90 kg. Një vit më vonë në vitin 2017 garova sërish në Tiranë ku mora sërish vendin e parë por kësaj radhe në kategorinë -100 KG. Në tetor të vitit 2017 mora pjesë në garova pikërisht aty ku e kisha nisur, në Itali, në kategorinë -90 Kg ku u shpalla kampioni i Italisë për këtë kategori, dhe disa ditë më vonë garova sërish në Itali në një garë të quajtur "2Tori". Në këtë garë kam qenë më i vogli dhe aty zura vendin e tretë.

Nëse do të kisha mundësi unë do të rikthehesha përgjithmonë atje, por andej nga ai vend i bekuar nuk po bëhet asnjë investim që të na japë një mundësi për të jetuar atje. Unë në Maqëllarë kam një pjesë të familjes dhe sa herë që vij çmallem me atë ajër. Dibra gjithmonë ka qenë në zemrën time.

Sa kohë ju duhet për tu përkushtuar stërvitjes për të qenë formë?

Minimumi dy orë patjetër që duhet të jem në palestër. Prej kohësh unë zotëroj një Palestër në Tiranë të quajtur "Gessa Fitnes" ku jam instruktor me kohë të plotë. Kjo sigurisht që nuk do të thotë se unë lë pas dore kampionatet dhe evenimentet

Çfarë ***mendojnë njerëzit dhe si reagojnë kur shohin trupin tënd?***

Eh çfarë pyetje!(qesh). Në fakt ka shumë njerëz që më shikojnë të habitur. Nga meshkujt sidomos në plazh marr shumë komplimenta dhe më kërkojnë informacion se si kam arritur të jem në këtë fazë, ndërsa vajzat shpesh herë kanë frikë. Realisht duhet shumë punë për të mbajtur në formë trupin.

Na the që nuk është e lehtë të mbash në formë trupin. Çfarë ***ushqimesh përdor për të pasur trupin në këtë gjendje?***

Përgatitja fillon me masën muskulore. Duhet të konsumojmë shumë ushqime që kanë shumë proteina. Pastaj kur kalojmë në definim ulim sasinë e proteinave dhe karbohitrateve. Sigurisht, që marr edhe suplemente. Ato janë pak të shtrenjta dhe të gjitha këta para i nxjerrim nga xhepi.

Si ndihesh kur hipën në skenë për të performuar bodybuilding, ke emocione?

Normalisht që emocionet janë gjithmonë të pranishme, por kur unë dal në skenë të performoj, harroj çdo gjë dhe përqendrohem vetëm tek gara dhe trupi im. Nëse fokusohesh tek emocionet harron çdo gjë dhe 5 muaj stërvitje të shkojnë dëm.

A ka një federatë që ju përkrah ju sportistët dhe kampionatin?

Po, ekziston një federatë e këtij sporti por mendoj që askush nuk e vendos ujin në zjarr për të kontribuar në këtë sport. Normalisht si pothuajse në të gjithë sportet që janë në Shqipëri

Le të kthehemi tek vendlindja juaj. I ruan akoma lidhjet me Dibrën?

E si të mos i ruaj. Guri i rëndë peshon më shumë në vendin e tij. Nëse do të kisha mundësi unë do të rikthehesha përgjithmonë atje, por andej nga ai vend i bekuar nuk po bëhet asnjë investim që të na japë një mundësi për të jetuar atje. Unë në Maqëllarë kam një pjesë të familjes dhe sa herë që vij çmallem me atë ajër. Dibra gjithmonë ka qenë në zemrën time.

Arbri, si është një ditë e jotja?

Një ditë e imja është pothuajse normale dhe e zënë si të gjithë. Siç thash më parë, unë pjesën më të madhe e kaloj në palestër. Më pas familja zë një vend shumë të rëndësishëm për mua dhe mundohem ti përkushtoj kohë sa të kem mundësi. Është dhe një sipërmarrje tjetër e imja në Tiranë që i përkushtoj një pjesë tjetër të kohës.

Si i sheh të rinjtë e sotëm?

Sot të rinjtë kanë mundësi shumë më të mëdha se në kohën time apo më parë. Tani mund të lëvizësh i lirë kudo që dëshiron të shkosh dhe të jesh ai që ke ëndërruar të jesh. Ata asnjëherë nuk duhet të demotivohen nga një gjë e vogël, dhe nuk duhet të ndalojnë në pengesën e parë që do tu bëhet. Duhet patjetër të punojnë fort për të qenë dikush në jetë.

Bëj pajtimin tënd me PayPal

përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun:
https://tinyurl.com/lcc3e2f

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i gjellin në redaksi para datës 20 të muajit. Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

Rruga e Arbërit nr. 150

kujtesë

Dëshmori Hamdi Lleshi, *tankisti i parë shqiptar, që ra për çlirimin e Dibrës së Madhe*

Nga **Sakip CAMI**

Hamdi Lleshi ka lindur në Zogje të Dibrës në vitin 1924.

Ai është i biri i Pëllumb Lleshit dhe nipi i Tush Lleshit, djali i xhaxhait të Haxhi Lleshit. Kur ke thënë këto emra ke thënë gjithë historinë e fisit të shquar Lleshi të Dibrës dhe të Shqipërisë. Gjyshi i tij, Tush Lleshi, arriti të krijonte një çetë me luftëtarë nga fshatrat e Zogje, Gjuras, Shtushaj, Mazhicë, Bllacë, Topojan dhe Kovashicë dhe e vuri në shërbim të çështjes kombëtare. Ai ka qenë anëtar i Xhelisit (Kuvendit) të Dibrës. Ka dhënë kontribut gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Luftës së Dahoshishtit më 1882 dhe luftës kundër Kadri Pashës më 1881. Tushi ka marrë pjesë në Kuvendin e V të Qernanicës në Dibër të Madhe në shkurt të vitit 1899, kuvend që njihet si "Besëlidhja e Dibrës" ose "Itifaku i Madh" për luftë kundër turqve. (M. Murra, Dibra nga antikiteti në monarki, 2017 faqe 640).

Rrugën atdhetare të Tushit e vazhduan djemtë e tij, Haliti, Aqifi, Pëllumbi dhe më pas gjatë luftës antifashiste Haxhiu, Ymeri, Luti, Abdurrahimi, Hamdiu dhe shumë të tjerë.

Hamdiu ishte nip tek Çup Cami në Viçisht, një luftëtar i shquar për liri dhe pavarësi. Ishte i martuar me të motrën e Dali Ndreut (Dali Sufë Xhelilit). Pra ishte bërë dhëndër në një fis të madh atdhetarësh, tek Elez Isuf Ndreu.

I rritur dhe i burrëruar në këtë mjedis atdhetar, Hamdi Lleshi u aktivizua në luftën antifashiste qysh në prill të vitit 1941, ku mbeti i vrarë kushuriri i tij Abdurrahimi.

Në ditët e para të prillit italjanët shtrinë forcat e Divizionit "Firence" në vijën Maqellarë–Shupenzë-Miresh-Klenjë e deri në Librazhd. Në brezin e dytë që fillonte nga Smolliku në Strikçan-Zerqan-Fushë-Bulqizë-Mali i Bllacës-Katër Grykët qe vendosur Divizioni Alpin "Brenero".

Atdhetarët dibranë bënë planin për t'u nisur në dy drejtime, në krahun Sebetovë, Tërbaç, Çerenec, Viçisht dhe në krahun Bllatë, Reshan e Maqellarë. Më 6 prill filluan veprimet luftarake dhe në befasi të plotë u morën postat kufitare të Ostrenit, Mireshit e Viçishtit dhe erdhën deri në kodrat e Gjoricës. Forcat e komanduara nga Aqif Lleshi morën postën e Bllatës. Gjatë luftës u bashkuan shumë fshatarë me luftëtarët kundër pushtuesve. Armiku la shumë të vrarë e të plagosur, u zunë shumë armë, municione, veshmbathje, e ushqime që ju shpërndanë luftëtarëve. Ranë dëshmorët e parë Abdurahim Lleshi e Vebi Jashari në Zonën e Maqellarës. Në kodrat e Çerenecit u vra mësuesi patriot Fasli Cami. Në Miresh italjanët vranë Musa Camin, Ejup Camin e Mexhit Lezin.

Italia fashiste dërgoi forca të mëdha. Filluan raprezaljet, internimet e masat e tjera shtypëse kundër luftëtarëve që përgjakën ushtritë pushtuese më 6 prill. Në këto kushte u bë e vështirë lëvizja e 300 luftëtarëve, prandaj ato u shpërndanë pranë familjeve me qëllim që të



Në Dibër të Madhe dhe përqark kishte rreth 600 luftëtarë të UNÇSH (forca të Grupit të Dibrës), 1 batalion i Brigadës II Sulmuese me luftëtarë të batalionit të Çermenikës dhe një numër vullnetarësh të çetave territoriale të krahinës.

vazhdonin veprimtarinë antifashiste në forma të ndryshme , të gatshëm në kohën e rioganizimit, të kujdesshëm edhe ndaj mashtrimeve. Fashistët burgosën Ahmet Camin, vetë i njëzeti nga fisi i tij, Murat Bashën, Sali Llanin, Jashar Lelën, etj. "Ndërsa Pëllumb Lleshin, Lutfi Lleshin, Shaqir Skukën, Nuz Majtarën i zbuluan dhe i internuan në Peqin, Kavajë e gjer në Itali"(Haxhi Lleshi ,Vite, Njerëz, Ngjarje Tiranë,1996 fq 43).

Kjo lëvizje në fillim ishte lëvizje e mirëfilltë antifashiste, më pas u shëndrua në lëvizje antifashiste nacional çlirimtare e drejtuar nga komandanti i Çetës së Dibrës, komandanti i Batalionit të Dibrës dhe anëtari i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional Çlirimtare Haxhi Lleshi, kushuriri i Hamdiut.

Hamdiu u aktivizua me Çetën partizane të Gollobordës së bashku me vëllezërit e tij , Ymerin dhe Lutin, sepse në këtë çetë ishin dajat e tij rreth 20 luftëtarë të Fisit Cami. Me formimin e Batalionit të Dibrës ju besua detyra e Zv Komandantit të Çetës së Gollobordës. Komandant ishte Ahmet Cami, oficer me akademi ushtarake. Pas vrasjes së Ahmetit në tetor 1943, detyra e komandantit të çetës ju besua Hamdiut. Çeta e Gollobordës mori emrin e komandantit të saj dëshmor, emrin e Ahmet Camit.

Në nëntor 1943 në luftën për çlirimin e Dibrës së Madhe, Hamdiut ju ngarkua një mision luftarak shumë i vështirë, misioni i tankistit dhe i luftimit me tank në prapavijën e armikut dhe në zbulim. Dolën tre vullnetarë. Ata ishin Hamdi Lleshi nga Zogje, Mete Duka nga Shtushaj dhe italiani Salvatore që kishte qenë shofer autoblinde.

-Të kishim patur kësi lloj makinash të blinduara, s'do ta kishim lanë armikun në faqe të dheut tonë, mendonte Hamdiu. (Yje të pashuar vëllimi I, faqe 290)

Caktoi detyrat dhe autoblinda u nis. Ajo rrëshqiti plot zhurmë në rrugët e qytetit të Dibrës së Madhe dhe pasi bëri një kontroll të plotë, ju drejtua bashkisë së qytetit. Afër varrezave të qytetit ishin vendosur shumë gjermanë në pozicion luftimi. Ata hapën zjarr të dendur kundër autoblindës, por plumbat nuk e depërtonin dot autoblindën. Hamdiu qëllonte me mitroloz nga brenda autoblindës në drejtim të gjermanëve. Autoblinda përparonte me shpejtësi dhe nuk ndalej. Gjermanët zinin transhetë e ndërtuara posaçërisht dhe qëllonin pa pushim në drejtim të autoblindës. Ata përdorën edhe artileri kundër autoblindës. Plagoset Metja, por nuk e jep vehten. Plagoset dhe më pas vdes italiani Salvatore, që drejtonte autoblindën. Autoblinda ndalet. Lufta vazhdonte, por nga pozicioni statik. Tani vështirësia e përballimit të sulmit gjerman të shtuar me mitroloza dhe artileri u shtua. Një predhë e artilerisë goditi edhe Hamdiun. Mitrolozi heshti. Hamdiu mbeti i mbërthyer tek dorezat e mitrolozit "shars" .Ishte data 16 nëntor 1943. Ishte dita e pavdekësisë për dëshmorin Hamdi Lleshi, që do të hynte në historinë e ushtrisë nacional çlirimtare dhe të ushtrisë shqiptare si tankisti i parë shqiptar.

Poeti shkroi:

Ti nuk ishe tankist
As oficer me akademi
Ti ishte komandant
Sulmove me autoblindë

Metja u plagos
Ti nuk u ligështove
Bashkë me Salvatoren
Tankun e drejtove

Tankun e drejtove
Drejt mizorisë
Zemra ish timoni
Drejt rrugës së lirisë

Me gjakun e derdhur
Në tankun partizan
Nënshkrove historinë
O tankisti i parë...

(Ujëvara të përgjakura, poezi, 2000)



Harta e veprimeve luftarake kundër fashistëve italianë me 6 prill 1941

LUFTA E II E DIBRËS SË MADHE

Në Dibër të Madhe dhe përqark kishte rreth 600 luftëtarë të UNÇSH (forca të Grupit të Dibrës), 1 batalion i Brigadës II Sulmuese me luftëtarë të batalionit të Çermenikës dhe një numër vullnetarësh të çetave territoriale të krahinës. Rreth 200 vullnetarë e partizanë të tjerë ndodheshin në Peshkopi dhe në Zerqan.

Shtabi i Përgjithshëm, mbështetur në analizë realiste të gjendjes në urdhrin që i dërgonte komandës së Grupit të Dibrës, më 9 nëntor 1943, ndër të tjera jepte edhe idenë e veprimeve luftarake të ardhshme të forcave partizane të qarkut. Komanda e Grupit të Dibrës, e informuar për fillimin e mësymjes armike, vuri në gatishmëri forcat partizane e vullnetarë dhe mori masa për mbrojtjen e qytetit të Dibrës së Madhe duke vlerësuar se ky ishte edhe objektivi kryesor i sulmit të trupave gjermane dhe forcave reaksionare.

Veprimet luftarake të forcave partizane në qytete do të kishin për objektiv jo ta mbanin atë me çdo kusht, por t'i shkaktonin armikut humbje sa më të shumta në njerëz dhe në mjete luftarake.

Mbrojtja e qytetit të Dibrës së Madhe u organizua rrethore, duke zënë pikat sunduese dhe në to u vendosën mitraloza, mortaja dhe topa.

Për të penguar armikun gjatë afrimit u shkatërruan pjesë rrugësh që çonin në qytet dhe u hodh në erë ura e Spilesë mbi Drin.

Armiqtë e filluan mësymjen e tyre më 16 nëntor 1943, rreth orës 10.30. Artileria armike godiste me breshëri zjarri të pandërprerë jo vetëm objektiva që mendohej se mund të ishin zënë nga forcat partizane, por edhe shtëpitë e qytetit të Dibrës së Madhe, shumë prej të cilave u shkatërruan dhe u dogjën plotësisht.

Këmbësorët nazistë u penguan mjaft nga prishja e urës së Spilesë dhe nga shkatërrimet e tjera gjatë rrugëve, por megjithatë, ata mundën ta kalonin Drinin dhe pengesat e tjera, sido që dhe me humbje.

Epërsia numerike, artileria e fuqishme dhe forcat e mjetet e shumta xheniere u dhanë atyre dorë t'i kapërcenin këto pengesa dhe t'i afroheshin qytetit të Dibrës së Madhe duke e sulmuar nga lindja e nga jugu.

Tanket, që vinin nga Struga, nuk e kaluan lumin Drin ditën e parë, për shkak të urës së prishur.

Në fillim komanda e forcave partizane mendoi të organizonte një kundërmësymje. Por kur pa se armiqtë ishin 10 herë më shumë në forca, hoqën dorë nga kjo ide. U vendos që derisa të binte nata, të mbaheshin me këmbëngulje pikat sunduese që kishin në zotërim partizanët. Komanda dha gjithashtu porosi që nga pozicionet të dëmtohej sa më shumë forca e gjallë e armikut dhe të mos lejohej që armiku të futej brenda në qytet, por të luftohej për ta rrethuar nga perëndimi e nga veriu, për të qëndruar të lira rrugët e tërheqjes.

Luftimet vazhduan afër 10 orë pa pushim. Luftëtarët e UNÇSH thyen disa sulme të nazistëve gjermanë duke mos i lejuar që të pushtonin qytetin as ta rrethonin atë plotësisht. Forcat reaksionare ishin përqendruar në veri dhe në verilindje të Dibrës së Madhe. Atyre u ishte caktuar si detyrë për të mbyllur rrugët e tërheqjes së partizanëve. Luftimet vazhduan deri në mbrëmje dhe qyteti vazhdonte gjithnjë të qëndronte në dorë të UNÇSH. Ushtria hitleriane kishte mundur të pushtonte vetëm disa shtëpi në anën jugore të tij.

Popullsia nuk u largua, megjithëse u vranë e u plagosën shumë veta nga qitjet e artilerisë së nazistëve gjermane. Burra, gra, të rinj dhe pionierë ndihmonin partizanët e vullnetarët me ushqime, shërbenin si korrierë, udhërrëfyes e zbulues, tërhiqnin dhe përkujdeseshin për të plagosurit. Ata që kishin armë luftuan krah për krah me partizanët.

Më 16 nëntor 1943 armiku filloi luftimet kundër qytetit të Dibrës. Repartet naziste gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre ishin të shumta, duke kaluar mbi 5.000 ushtarë. Në mëngjes artileria e armikut hapi zjarr të dendur mbi qytet, shkatërroi shtëpitë, vrau gra, pleq e fëmijë.

Rreth qytetit kishin zënë pozicione batalionet e Dibrës dhe Martaneshit, si dhe forca të tjera. Raporti i forcave ishte në favor të armiku. Me gjithë këtë, komanda partizane mori vendim që të luftohej për mbrojtjen e Dibrës. Hitlerianët ishin afër pjesëve të jashtme të qytetit kur partizanët hapën mbi ta zjarr të dendur.

Detashmentet hitleriane dhe reaksionare u gozhduan në vend, megjithëse shoqëroheshin me tanke e autoblinda, Në këto kushte qëndresa e gjatë ishte e pamundur dhe rrezikonte asgjësimin e batalioneve partizane. Nga mesnata komanda partizane dha urdhër që partizanët të tërhiqeshin dhe të kalonin në anën tjetër të Drinit, veprim ky që u bë në mënyrë të rregullt dhe të disiplinuar.

Në luftime e sipër, një grup prej disa partizanë mbetën të rrethuar afër qytetit. Pushtuesit dhe bashkëpunëtorët ju bënë thirrje partizanëve të dorëzoheshin, por luftëtarët ju përgjigjën me zjarr. Nazistët gjermanë sulmuan për të kapur lartësinë ku po mbroheshin partizanët, por çdo përpjekje e tyre ishte e kotë. Ata e goditën grupin e luftëtarëve me artileri e mortaja. Me inisiativën e tyre, luftëtarët trima me shpejtësi të rrufeshme, sulmuan përpara me bomba dore, çanë rrethimin dhe u bashkuan me forcat e tjera të luftëtarëve.

arkiv

Në Peshkopi u hap Shtëpia e Kulturës...

FAQEVE TË ZVERDHURA TË BLLOKUT TË GAZETARIT

Filmat janë një dashuri e jetës sime. Shumë, më se gjysmën, nuk i gjej në "kutitë e këpucëve"...

Deri tash kam skanuar dhe "ngrirë" në arkiv mbi 6000 negativë...

Shënimet në blloqe ditë pas dite, që nga viti 1974 kur fillova punën si gazetar profesionist në ATSH, zënë një raft të tërë biblioteke "burgosur" në kuti të zverdhura kartoni...

Skedat, shënime nga leximet e mia në Arkivin e Shtetit dhe në gazeta të vjetra me datëbotim që në fillim të jetës së Shqipërisë si Shtet i Pavarur, janë pjesë dhe mall i jetës sime larg vendlindjes...

Po nis shfletimin e tyre...

Kësaj radhe me disa kronika kulturore...

Athinë, 19 tetor 2018

* * *

NË PESHKOPI U HAP SHTËPIA E KULTURËS...

Gazeta "Bashkimi" 29 maj 1946

Me një ceremoni të thjeshtë ku merrnin pjesë mjaft të ftuar si dhe përfaqësonjës të pushtetit dhe të organizatave të ndryshme të Frontit u bë inaugurimi i Shtëpisë së Kulturës.

Foli përgjegjësi i kulturës Vasfi Prapaniku...

Është hera e parë që në Peshkopi hapet një shtëpi kulture e cila do të jetë një vatër për hapjen e kulturës së re.

Foli Haki Stërmilli, nënkryetar i Komitetit Ekzekutiv të Prefekturës...

NË QARKUN E PESHKOPISË ZHVILLOHET NJË AKTIVITET I GJERË

Gazeta "Bashkimi" 6 nëntor 1946

...Në këtë qark funksionojnë rregullisht dy grupe theatrale të cilët kanë mundur të zhvillojnë dhe të japin në populll një seri shfaqjesh të ndryshme.

...Nga grupi theatral i shtëpisë së kulturës janë dhënë deri tani pesë shfaqje të ndryshme theatrale në Peshkopi dhe në Dibër të Madhe.

...Nga grupi theatral i pionierëve të qytetit të Peshkopisë janë dhënë 9 shfaqje të ndryshme në Peshkopi dhe në Dibër të Madhe.

...Në qytetin e Peshkopisë funksionon një bibliotekë popullore, e cila frekuentohet mesatarisht prej 150 lexuesish në muaj...

U NGRIT KINEMAJA E PESHKOPISË

Gazeta "Bashkimi" 11 janar 1947

Me përkrahjen e pushtetit populli i Peshkopisë ngriti kinemanë...


EKSKURSION NË ALLAJBEGI

Gazeta "Bashkimi" 8 qershor 1948

Në fshatin Allajbegi të rrethit të Peshkopisë u bë një ekskursion masiv ku morën pjesë përmbi 1500 vetë nga populli i qytetit të Peshkopisë dhe Shupenzës.

Në këtë ekskursion merrnin pjesë edhe një grup të rinjsh nga Dibra e Madhe.

Gjatë kohës së ekskursionit qëndruan në fshatin Allajbegi grupi folkloristik i Peshkopisë që lojti një seri vallesh vençe dhe në mes skuadrave të futbollit të Peshkopisë dhe të Shupenzës u zhvillua një ndeshje



e cila përfundoi 3 me 0 në favor të skuadrës së Peshkopisë.

Shënim: Në këto kronika më tërhoqi vëmendjen bashkëpunimi mbarë dibran, kësaj ane dhe asaj ane të kufirit shqiptaro-shqiptar, bashkëpunimi me kryeqytetin e krahinës, Dibrën e Madhe...

Abdurahim Ashiku

Athinë, 29 tetor 2018

Kur vjen një përvjetor…

Nga **Mimoza Ramazan TOLA***

Kalendarët shpalosin fletët një e nga një, siç përcjell dita orët, minutat, sekondat…siç pret zemra përvjetorët. Ato vijnë dhe ikin të heshtur, ngarkuar me mall e mirënjohje të pakufi, për ata që dhanë jetën për vatan, në emër të një ideali e ëndrre të bukur, ëndrrës së lirisë.

Edhe për ne familjarët e familjes Tola tetori sjell një përvjetor dhe ky i sivjetshmi është 74 vjetori i rënies së dëshmorit Myslym Abdulla Tola, lindur në 1925 në fshatin Ostren i Madh të rrethit Dibër.

I lindur e i rritur në një familje me tradita, i edukuar me ndjenjat e patriotizmit dhe dashurisë për atdheun, i ati, Abdullai, i cili për një kohë të gjatë qëndroi pranë Aqif Pashë Elbasanit, do të përcillte te djemtë të njëjtën traditë dhe, me fillimin e LANC, do ta shndërronte shtëpinë e tij në një bazë të saj. Kështu, ndërsa Arifi, djali më i madh, do të punonte në Komandën e Vendit, duke bërë pasaporta për ilegalët, Myslymi, djaloshi 17 vjeçar, do të braktisë mistrinë e çekiçin, do të rrëmbejë armët e do të bashkohet me partizanët e Brigadës së lV S, duke luftuar përkrah qindra të tjerëve, me guximin e trimërinë që e karakterizonte e duke zbatuar të gjitha detyrat e ngarkuara nga komanda e kësaj brigade. Por…

…lufta është luftë dhe si e tillë nuk do të kursente edhe jetën e këtij djaloshi gollobordas.

22 tetor 1944. Brigade e lV S po përleshet dhëmbë për dhëmbë me nazistët e ballistët në Prezë të Tiranës. Krismat e mitralozit të tij bashkohen me ato të të tjerëve, për të cilët liria vlen më tepër se edhe vetë jeta e tyre e re.

Lufta vazhdon e rreptë, por ka heshtur mitrolozi i tij. Një plumb do të presë në mes një jetë, një ëndërr, dëshirën për ta parë Shqipërinë të lirë.

Në kujtimet që sjellin sot të afërmit e tij, në këtë përvjetor, ka mall, ka dhembje e krenari jo vetëm për të, por edhe për dy dëshmorë të tjerë të fisit Tola: Mexhit Tafil Tola partizan i Batalionit të Dibrës, rënë me 23 gusht 1943 në Sofraçan në moshën 23 vjeçare, e Tofik Adil Tola, partizan i Brigadës së IV S, rënë në luftimet për çlirimin e Tiranës me 16 nëntor 1944.

E vështirë rruga e luftës, por më e vështirë ajo e lirisë. Këta djem, si mijëra të tjerë, do t'ia falnin jetën lirisë, duke u ngjitur kështu në panteonin e lavdisë së kombit.

Në përvjetorët e tyre ne mblidhemi e i kujtojmë, sjellim mbresa e vendosim lule, përulemi me respekt e i nderojmë, ndërgjegjja e kombit i thërret në promemorie, sepse ndërgjegja e kombit nuk vdes kurrë.

** Autorja është mbesa e heroit. Shkruar sipas kujtimeve të vëllait të dëshmorit Myslym Tola, Ramazan Tola.*

LIBRI I RI

SHABAN SINANI

Antropologjia kulturore si dije paradigmatike

Libri më i ri i prof. Shaban Sinanit me titull *Antropologji e identitetit* është pjesa e parë e një serie prej pesë vëllimesh me studime të grupuara në disiplinat *Antropologji e identitetit, Antropologji e religjionit, antropologji etnojuridike dhe antropologji e kulturës dhe letërsisë, Antropologji e etnosit*. Lexuesi do të gjejë këtu studime për antropologjinë e besimit (duke përfshirë shtresimet parabiblike dhe historinë e Shkrimeve të Shenjta); për antropologjinë e *miteve* dhe *riteve e ritualeve* (kryesisht në vështrim krahasues me mitet e lashtësisë antike europiane, të kulturave imperiale e të atyre liturgjike, si dhe me traditat e popujve fqinjë); për antropologjinë e *etnosit* (duke përfshirë dukuritë etnodalluese të fiksuara nga histroria, çështje të *etnotipit, arkeotipeve* dhe *stereotipeve*; po aq sa dhe antropologjinë e *tjetrit brenda nesh*); për antropologjinë e identitetit (duke përfshirë faktorët homogjenizues dhe heterogjenizues të bashkësisë); për antropologjinë e së drejtës (me objekt themelor statutet dhe kanunet, rendet shoqërorë, por dhe *ius albanica e pax ottomana*); për antropologjinë e kulturës (duke përfshirë *antropogjuhësinë, antropoletërsinë* dhe *antropoflorën*).

Botimet ***Naimi***

ISBN: 978-9928-234-27-8 / Çmimi: 2000 lekë

SHABAN SINANI

Antropologji e identitetit



Rruga e Arbërit
Aty ku fjalët nuk i merr era!

KRYESORE | AKTUALITET | OPINION | INTERVISTA | KULTURE | ARKIVA NE PDF | PETICIONI | PAJTOHU / NDIHMO EDHE

Kerko...

ARTIKUJT E FUNDIT

- Qeveria Rama ka edhe pak kohë të dëshmojë se nuk po mashtron me Rrugën e Arbrit
- Rruga e Arbrit, premtim i pambajtur i qeverive në 20 vite
- Liqenet e Balgjajt, bukuria e heshtur
- Afrim Murrja, një shkollë për blektorët e rinj
- Muhurri, Vështrim ekonomik, historik dhe etnokulturor
- Gjeneralët e Skënderbeut Nikollë dhe Dhimitër Berisha
- "Margaritari i kurorës", dritë e shpirtit dhe e provave të besimit

Rrugën e Arbrit ia kërkojmë qeverisë shqiptare, jo inxhinierëve dhe shoqatave qytetare

Nga Gëzim Alpion Më datë 28 tetor 2016, nga një lajm i revistës Monitor1, dhe më pas nga disa media »

www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.